




УЧЕБНИК ЗА ВТОРА ГОДИНА
ГИМНАЗИСКО ОБРАЗОВАНИЕ

СОЦИОЛОГИЈА

д-р Ило Трајковски, Надица Таневска Јанева

A large orange graphic element in the top-left corner of the page, consisting of two overlapping triangles that form a larger triangular shape pointing towards the top-left.

**ILO TRAJKOVSKI
NADICA TANEVSKA JANEVA**

SOCIOLOGJIA

**TEKST SHKOLLOR PËR VITIN E DYTË
TË ARSIMIT GJIMNAZOR**



Botues:

© EDUKA MAK SH.P.K. Shkup 2026

www.edukamak.mk, e-mail: info@edukamak.mk

www.knizarnica.mk

Për botuesin: Svetllana Makazlieva

SOCIOLOGJIA – tekst shkollor për vitin e dytë të arsimit gjimnazor

Të drejtat e autorit © 2026, EDUKA MAK

Autorë: Prof. dr. Ilo Trajkovski dhe Nadica Tanevska Janeva

Redaktor: Mihajlo Makazliev

Bashkëpunëtore profesionale: Gordana Trajkova Kostovska

Recensentë:

Prof. dr. Konstantin Minovski – Fakulteti Filozofik – Instituti i Sociologjisë – Shkup, UKIM

Prof. dr. Gordana Stojanoska – Fakulteti Pedagogjik – Manastir

Dragan Popovski – SHMQSH „Koço Racini“ – Shkup

Përkthyer nga maqedonishtja: Mr. Solidar Sulejmani

Titulli origjinal: „Социологија – учебник за втора година гимназиско образование“

Redaktimi gjuhësor: Refail Sulejmani

Dizajnimi dhe përpunimi kompjuterik: EDUKA MAK SH.P.K. Shkup

Shtypi:

Shoqata për prodhim, qarkullim dhe shërbime GRAFOTREJD SH.P.K., import-eksport, Shkup

Tirazhi: 1.900 kopje

Ky tekst shkollor është miratuar për përdorim në arsimin gjimnazor, me Vendimin për miratimin dhe përdorimin e tekstit shkollor për lëndën mësimore Sociologjia për vitin II (të dytë) të arsimit gjimnazor nr. 26-749/1, të datës 19.6.2026, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PARATHËNIE

Të dashur nxënës,

Para jush është teksti shkollor të **Sociologjisë** për vitin e dytë të arsimit të mesëm. Me ndihmën e tij do të filloni të njiheni me një disiplinë shkencore interesante dhe të rëndësishme që mëson shoqërinë dhe jetën e njerëzve në të. Çdo ditë jeni pjesë e grupeve të ndryshme shoqërore – familjes, shkollës, grupeve të miqve, komunitetit lokal – dhe merrni pjesë vazhdimisht në marrëdhënie të ndryshme shoqërore. Sociologjia do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë saktësisht ato marrëdhënie, rregullat sipas të cilave funksionon shoqëria dhe ndryshimet që ndodhin në të.

Gjatë mësimit të kësaj lënde, do të njiheni me konceptet, idetë dhe teoritë themelore sociologjike. Do të mësoni se ç'është shoqëria, si është e organizuar dhe si zhvillohet. Do të zbuloni se si lindin dhe funksionojnë grupet dhe institucionet shoqërore, ç'do të thotë kultura për një popull, si socializohen njerëzit dhe si krijohen pabarazitë shoqërore. Gjithashtu do të diskutojmë proceset dhe sfidat shoqërore bashkëkohore me të cilat përballen shoqëritë bashkëkohore.

Qëllimi i këtij teksti shkollor nuk është vetëm t'ju ofrojë njohuri të reja, por edhe t'ju inkurajojë të mendoni në mënyrë kritike rreth dukurive shoqërore që ju rrethojnë dhe ju formojnë, ndërsa edhe ju i formoni ato. Do të keni mundësinë të analizoni shembuj nga jeta e përditshme, të bëni pyetje, të shprehni mendimet tuaja dhe të diskutoni TEMA të ndryshme shoqërore. Në këtë mënyrë do të zhvilloni aftësinë për të kuptuar më mirë njerëzit, marrëdhëniet midis tyre dhe proceset që formësojnë shoqërinë moderne.

Mësimet në teksti shkollor janë të organizuara në mënyrë të tillë që ato gradualisht do t'ju prezantojnë me të menduarit sociologjik. Në to do të gjeni shpjegime të koncepteve kryesore, shembuj nga jeta reale, pyetje për reflektim dhe detyra që do t'ju ndihmojnë të zotëroni më lehtë përmbajtjen mësimore. Këto aktivitete do t'ju inkurajojnë të merrni pjesë aktive në mësimet dhe të hulumtoni në mënyrë të pavarur dukuritë shoqërore.

Shpresojmë që mësimi i sociologjisë do t'ju ndihmojë të zhvilloni një pamje më të gjerë të shoqërisë dhe botës përreth jush. Të kuptuarit e proceseve shoqërore do t'ju ndihmojë të bëheni qytetarë më të informuar, të përgjegjshëm dhe aktivë që respektojnë diversitetin dhe kontribuojnë në zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe humane.

Ju urojmë një udhëtim të suksesshëm dhe interesant nëpër faqet e këtij teksti shkollor.

Nga autorët

PËRMBAJTJA

TEMA 1. SOCIOLOGJIA: KUR, SI, PSE?	6
1. Si dhe pse lindi sociologjia	6
Sociologjia si shkencë e shoqërisë moderne	7
Nga kthesat shoqërore deri te shkenca e re: „lindja e sociologjisë“	7
2. Themeluesit e sociologjisë	11
Herbert Spenseri: shoqëria si organizëm	13
Emil Dyrkemi: faktet shoqërore	13
3. MAKS VEBERI – KRIJUES I SOCIOLOGJISË INTERPRETUESE (KUPTIMORE)	16
Karl Marksi – teoricien i konflikteve	17
Ngjashmëritë dhe dallimet në mësimet e themelue ve të sociologjisë	18
4. Orientimet teorike në sociologji	20
Ç'janë orientimet teorike në sociologji?	20
Pse është e rëndësishme të njihen orientimet teorike në sociologji?	21
5. FAZAT, METODAT DHE TEKNIKAT NË KËRKIMET SOCIOLOGJIKE	24
Metodat dhe teknikat më të përdorura në kërkimet sociologjike	25
Laboratorët sociologjikë janë historia dhe ndryshimi i shoqërive	26
Hapat (fazat) e kërkimit sociologjik	28
TEMA 2. UDHËTIM NËPËR SHOQËRI DHE KULTURA	32
1. Shoqëria, dukuria shoqërore, procesi shoqëror	34
Ç'është shoqëria?	34
Pse shoqëria është komunitet i organizuar dhe i vetëmjaftueshëm?	34
Shoqëria në lëvizje ç'ndodh dhe pse?	35
Ç'është dukuria shoqërore dhe ç'është procesi shoqëror?	35
2. Shoqëritë nëpër kohë	38
Pse është e nevojshme të dimë se si ndryshojnë dhe zhvillohen shoqëritë me kalimin e kohës?	38
Klasifikimi i shoqërive sipas zhvillimit teknik dhe teknologjik	38
Klasifikimi i shoqërive sipas formimit të tyre shoqëro-ekonomik	40
Si zëvendësohet, sipas Marksit, një formacion nga një tjetër?	41
Klasifikimi i shoqërive sipas tipareve kulturore (shoqëritë tradicionale, moderne dhe postmoderne)	42
3. Si të arrihen ndryshimet shoqërore?	44
A janë ndryshimet gjithmonë pozitive?	44
Ndryshimet përmes revolucionit dhe evolucionit	45
4. Kultura si mënyrë jetese	47
Ç'është shoqëria, e ç'është kultura?	47
Kultura – koncepti dhe kuptimi	47
Elementet e kulturës	48
5. Ndarja e kulturës	52
Kultura dhe qytetërimi – dy anët e së njëjtës shoqëri	52
Si ndahen kulturat?	52
6. Identiteti kulturor	56
Ç'është identiteti kulturor dhe si krijohet ai?	56
Si krijohet identiteti personal?	56
Ngjashmëritë kulturore, ndryshimet kulturore dhe universalet kulturore	58

Ç'ndodh kur takohen kultura të shumëfishta? (enkulturimi, përshtatja, akulturimi, asimilimi).....	59
7. Llojet e sjelljes dhe qasja ndaj kulturës.....	63
Jeta midis kulturave – si sillemi dhe si përshtatem?	63
Etnocentrizmi.....	64
Relativizmi kulturor	64
Shovinizmi	65
Seksizmi	66
Homofobia.....	66
Racizmi	67
Kosmopolitizmi	67
Interkulturizmi	68
8. Kultura bashkëkohore përmes prizmit të kulturës rinore.....	70
Kultura bashkëkohore – mediatike	70
9. Rruga e njeriut përmes socializimit.....	74
10. Sociologjia e brezave dhe cikleve jetësore	78
Jeta jonë përmes periudhave	78
Jeta dikur dhe tani: kuptimi i dallimeve ndërbrezore	79
11. Individualizmi dhe kolektivizmi.....	82
Konformizmi dhe jo-konformizmi	84
12. Ndërveprimi social.....	86
Format e ndërveprimit social	86
13. Komunikimi.....	90
Ç'është komunikimi – koncepti dhe kuptimi	90
Llojet e komunikimit.....	90
Llojet e komunikimit sipas nivelit të komunikimit (numrit të personave)	91
Llojet e komunikimit sipas mjeteve që përdorim	91
14. Rolet shoqërore	94
Ç'është roli shoqëror?	94
Llojet e roleve shoqërore.....	95
Konflikti i roleve	95
15. Devijimi shoqëror – kur, pse dhe si?	98
Ç'është devijimi shoqëror?	98
Pse disa njerëz bëhen devijues?	99
Konformizmi dhe jokonformizmi si shkaqe të sjelljes devijuese.....	99
Sanksionet.....	100
16. Llojet e sjelljes devijuese	102
Krimi dhe llojet e krimit.....	103
Krimi shtetëror dhe krimi i organizuar	103
Korrupsioni	104
Delikuenca e të miturve	104
Mobingu	105
Nepotizmi dhe kronizmi	106
17. Varësitë	108

PËRMBAJTJA


Ç'do të thotë varësi/të?	108
Çfarë lloj varësish krijohen në shoqëritë e sotme?	108
Ç'është toksikomania dhe cilat janë pasojat e tij?	108
Alkoolizmi	109
Nikotinizmi	109
Varësia nga teknologjia	110
TEMA 3. ORGANIZATAT DHE INSTITUCIONET SHOQËRORE SI BAZË PËR FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË	111
1. Grupet shoqërore	113
Rëndësia dhe përcaktimi i grupeve	113
Llojet e grupeve	113
2. Organizatat	116
Koncepti i organizatës	116
Llojet e organizatave	117
Llojet e organizatave shoqërore	118
3. Institucionet	121
Koncepti i institucioneve	121
Familja	121
Koncepti dhe funksionet e familjes	121
Familja tradicionale dhe moderne	123
4. Martesa dhe llojet e martesave	126
Dhuna në familje	127
5. Ekonomia	130
Sektorët në ekonomi	130
Tregu	131
Puna dhe tregu i punës	132
6. Mënyrat bashkëkohore të prodhimit	134
Vendi i njeriut në prodhim në epokën digjitale	135
7. Sfidat e ekonomisë moderne	137
Sfidat tekniko-teknologjike dhe shoqërore të ekonomisë moderne	137
Presionet mbi punëtorët: papunësia, rikualifikimi, prekariati dhe forma të tjera të trajtimit të padrejtë të punës	138
Konfliktet ekonomike	139
8. Politika	142
Politika: koncepti	142
Fuqia dhe pushteti si mjete të politikës	142
9. Shteti	146
Zhvillimi i shtetit	146
Shteti në rolin e mbrojtësit të të drejtave dhe nevojave të qytetarëve	146
Si i rregullon shteti marrëdhëniet ndërmjet qytetar ve të tij	147
Si i zbaton shteti politikatat e tij	148

10. Demokracia	151
Demokracia dhe të drejtat e njeriut	151
Të drejta, por edhe detyrime!	152
Aktivizmi qytetar, qytetarët aktivë.....	153
Si ndikon politika te qytetarët?	155
11. Arsimi dhe shkenca.....	158
Cila është lidhja midis arsimit dhe shke cës?.....	159
Si e bëjnë shkencat jetën e njerëzve më të leh ë përmes arsimit.....	160
12. Shkenca dhe zhvillimi shoqëror.....	162
Përfitimet e shkencës dhe të arsimit për individin dhe shoqërinë	164
13. Etika dhe teknologjia në arsim dhe shkencë.....	167
14. Feja	170
Koncepti i fesë.....	170
Funksionet e fesë	171
Llojet e feve	172
15. Karakteristikat e feve botërore	174
16. Organizatat fetare	178
Paraqitja tabelare e karakteristikave të organizata e fetare	179
17. Sekularizimi	182
Konfliktet fetare	183
18. Arti dhe shoqëria	186
Arti i angazhuar shoqërisht	187
Teknologjia dhe arti (arti virtual)	188
Arti si trashëgimi kulturore	189
TEMA 4. BOTA QË NDRYSHON: SI DHE PSE?	192
1. Diferencimi dhe stratifikimi shoqëror	192
Sistemet më të njohura të stratifikimit.....	193
Diferencimi sipas bazave të ndryshme	195
2. Pozicioni shoqëror	199
Lëvizshmëria shoqërore.....	200
3. Sjellja kolektive	203
Lëvizjet shoqërore	205
Lëvizjet më të njohura shoqërore	206
4. Globalizimi	209
Llojet e globalizimit	210
Media dhe globalizimi.....	211
Pasojat e globalizimit – argumente pro ose kundër globalizimit	212
5. Migrimet globale.....	215
Neokolonializmi dhe neoliberalizmi	216
6. Organizatat ndërkombëtare.....	219
7. Literatura e përdorur	222

1. SI DHE PSE LINDI SOCIOLOGJIA

„Shoqëritë bashkëkohore i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme dhe sociologjia duhet t'i zbulojë këto transformime.“
– Entoni Gidens

Sociologjia është shkencë shoqërore. Ajo mori emrin nga kombinimi i fjalës latine *societas*, që do të thotë shoqatë, bashkësi ose shoqëri dhe fjalës greke *logos*, që do të thotë shkencë ose studim. Prandaj sociologjia është shkenca e shoqërisë në tërësi. Ajo mëson dukuritë dhe proceset në shoqëri, zbulon pse ndryshojnë shoqëritë, pse njerëzit jetojnë së bashku dhe si sillen ndaj njëri-tjetrit.



Sociologjia gjithashtu është shkencë praktike. Na ndihmon të kuptojmë rolin e familjes, miqve, shkollës dhe medias në jetën tonë. Ajo shpjegon pse mësojmë, krijojmë kulturë, art, fe, modë; pse jemi të interesuar për shkencën dhe politikën; pse është e rëndësishme të respektojmë rregullat, ligjet dhe institucionet e shtetit.

Sociologjia zbulon se si ndryshimet shoqërore formësojnë jetën tonë, pse grupohemi dhe veprojmë së bashku. Gjithashtu na ndihmon të

kuptojmë se si secili prej nesh ndërton identitetin tonë dhe pse njerëzit nuk janë gjithmonë të barabartë në pasuri, pushtet ose reputacion. Me qasjen e saj krahasuese, ajo i inkurajon të rinjtë të mendojnë në mënyrë kritike dhe ta kuptojnë shoqërinë në të cilën jetojnë për atë që është. I inkurajon ata të respektojnë diversitetin; të jenë të drejtë dhe të përgjegjshëm; të shmangin paragjykimet, dhunën, konfliktet dhe të marrin pjesë aktive në krijimin e një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë. Në këtë mënyrë ajo ofron udhëzime për një jetë dhe bashkëjetesë më të mirë.

E gjithë kjo çon në përfundimin se **lënda e sociologjisë është shoqëria në tërësi: struktura e saj, dukuritë dhe proceset shoqërore, institucionet, ligjet sipas të cilave ndodhin ndryshimet shoqërore, por edhe mënyrat e shoqërimit të njerëzve dhe marrëdhëniet e tyre reciproke.**

SOCIOLOGJIA SI SHKENCË E SHOQËRISË MODERNE

Para shfaqjes së sociologjisë njerëzit jetonin në shoqëri tradicionale dhe të qëndrueshme, por të pabarabarta. Njerëzit ishin të ndarë në kasta dhe klasa të mbyllura (fisnikë, priftërinj dhe fshatarë), ndërsa rolet shoqërore ishin të përcaktuara qartë dhe pothuajse të pandryshueshme. Derisa gratë kujdeseshin për shtëpinë dhe familjen, burrat punonin si fermerë ose zejtarë. Të moshuarit kishin prestigj dhe ndikim më të madh, ndërsa të rinjtë dëgjonin këshillat e tyre. Jeta në këto shoqëri ishte e organizuar sipas zakoneve dhe fesë. Kisha përcaktonte se si duhet të silleshin njerëzit. Besohej se rendi feudal përcaktohej nga Zoti. Prandaj shumica e pranonte atë si „natyror dhe të drejtë”. Në kushte të tilla, problemet sociale nuk i nënshtroheshin analizës shkencore. Shpjegimet ishin fetare ose filozofike. Vetëm me ndryshimet e mëdha shoqërore të shekullit XIX lindi nevoja për një shkencë të re, e cila do të interesonte shkencërisht shoqërinë dhe mënyrën se si organizohet jeta.

Si shkencë sociologjia ka një histori të shkurtër, por një parahistori të gjatë. Si shkencë e veçantë, ajo u shfaq në gjysmën e parë të shekullit XIX, por ideja që shoqëria duhet të studiohet shkencërisht ekzistonte shumë më herët. Edhe në qytetërimet e lashta, mendimtarë nga Greqia, India, Kina dhe Roma menduan se si funksionon shoqëria dhe si mund të përmirësohet ajo.


NGA KTHESAT SHOQËRORE DERI TE SHKENCA E RE: „LINDJA E SOCIOLOGJISË”

Lindja e sociologjisë si shkencë e veçantë është proces afatgjatë, por besohet se tre revolucione e përshpejtuan ndjeshëm këtë proces:

- revolucioni shkencor, i cili uli ndikimin e kishës dhe fesë;
- revolucioni politik, i cili konfirmoi se njeriu është i aftë të vendosë vetë për fatin e tij;
- revolucioni industrial, i cili krijoi një shoqëri të re kapitaliste, studimi i të cilit kërkonte një shkencë të veçantë.

Revolucioni shkencor, i cili u zhvillua midis shekujve XVI dhe XVII, kontribuoi që njerëzit ta kuptonin botën në mënyrë të ndryshme. Në vend që të besonin në tradita, mite dhe mësimë kishtarë, shkencëtarët filluan të mendonin dhe të hulumtonin. Ata pyesnin veten se shoqëria a kishte rregullat dhe ligjet e veta, të ngjashme me ato natyrore dhe a mund të studiohej duke përdorur metodat shkencore të përdorura nga shkencat natyrore (biologjia, fizika, kimia). Me përdorimin në rritje të vëzhgimit, eksperimentimit dhe të menduarit logjik në studimin e dukurive shoqërore, u krijua baza për shfaqjen e sociologjisë. Iluminizmi, i cili konsiderohet si revolucion intelektual, luajti një rol të madh në krijimin e sociologjisë. Gjatë kësaj periudhe njerëzit filluan të respektonin arsyen dhe shkencën. Besohej se njeriu, me ndihmën e arsyes, mund ta kuptonte më mirë botën përreth tij, kështu që lindi ideja se edhe shoqëria kishte ligjet e veta që mund të studioheshin.

FORCAT SHOQËRORE QË SHKAKTUAN SHFAQJEN E SOCIOLOGJISË



Revolucionet politike dhe kombëtare, që ndodhën në Evropë në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX, kontribuan ndjeshëm në shfaqjen dhe zhvillimin e sociologjisë. Revolucionet demokratike çuan në shembjen e perandorive të vjetra feudale dhe krijimin e shteteve kombëtare që donin të ndërtonin identitetin e tyre kombëtar, vetëdijen kombëtare, sovranitetin, të mësonin më shumë rreth lëvizjeve masive, luftës së klasave dhe nuk dinin si ta bënin këtë. Ata kishin nevojë për një shkencë që do të studionte të gjitha këto çështje. Më vonë këto çështje u bënë tema qendrore në sociologji.

Revolucioni Francez ka rëndësi të madhe sepse jo vetëm që përmbysi rendin e vjetër feudal, por solli edhe ide të reja rreth lirisë, barazisë dhe të drejtave civile. Ai tregoi

se shoqëria nuk është diçka që mbetet e njëjtë përgjithmonë, por se mund të ndryshojë me veprimin njerëzor. Revolucioni i nxiti njerëzit të bënin pyetje të rëndësishme: si funksionon shoqëria, pse ndodhin revolucionet dhe si mund të krijohet një shoqëri e qëndrueshme dhe e rregullt. Prandaj mendimtarët filluan të mësonin sistematikisht ndryshimin shoqëror, marrëdhëniet midis grupeve dhe klasave të ndryshme shoqërore, rolin e shtetit dhe ligjeve dhe sjelljen e njerëzve në kohë krize. E gjithë kjo kontribuoi në zhvillimin e sociologjisë si shkencë që synon të kuptojë dhe të shpjegojë shkencërisht funksionimin e shoqërisë.

Revolucioni Amerikan çoi në krijimin e shtetit të parë modern demokratik, bazuar në kushtetutë, ndarje të pushteteve dhe të drejta civile. Kështu, ai tregoi se shoqëria mund të organizohet në mënyrë të vetëdijshme dhe racionale në bazë të ligjeve dhe rregullave. Kjo stimuloi shumë mendimin sociologjik rreth shtetit, shoqërisë dhe jetës së përditshme të njerëzve në të.

Revolucioni Industrial ndodhi gjithashtu gjatë së njëjtës periudhë dhe pati një ndikim të madh në shoqëri. Ai çoi në zhvillimin e industrisë, migrimin masiv të njerëzve në qytete dhe shfaqjen e grupeve të reja shoqërore – borgjezisë dhe klasës punëtore. Në të njëjtën kohë dolën në pah probleme serioze shoqërore: shfrytëzimi i punëtorëve, varfëria, pabarazitë e mëdha dhe kushtet e këqija të jetesës dhe punës. Këto ndryshime i inkurajuan shkencëtarët të fillonin të mësonin sistematikisht problemet shoqërore dhe marrëdhëniet midis njerëzve, duke përshpejtuar kështu „lindjen e sociologjisë”. Qëllimi i saj do të ishte studimi shkencor i shoqërisë dhe ndihma për të krijuar një jetë shoqërore më të drejtë dhe të qëndrueshme.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Ndani shkencat në shkencat natyrore dhe shoqërore dhe jepni disa shembuj. Pastaj, ndiqni hapat për të përfunduar aktivitetin:
Mendoni dhe shpjegoni se si ndryshojnë shkencat natyrore dhe shoqërore sipas lëndës së studimit dhe metodave që përdorin. Cilat fenomene studiojnë shkencat natyrore dhe shoqërore? Tregoni disa shembuj!

AKTIVITETI 2. Krahasoni shkencat shoqërore dhe shpjegoni se si ndryshon sociologjia prej tyre!

AKTIVITETI 3. Lexoni me kujdes pyetjet dhe përcaktoni se cilën pyetje nga ato të ofruara do të bënte një ekonomist, historian, psikolog ose sociolog!

Pyetje:

1. A varet planifikimi i kohës së lirë nga gjinia, mosha dhe gjendja financiare e individit?
2. Si ndikojnë grupet e bashkëmoshatarëve në planifikimin e kohës së lirë?
3. Si e ka ndryshuar zhvillimi teknologjik mënyrën se si e kalojmë kohën e lirë?
4. Si ndikon koha e lirë në shëndetin mendor?
5. Sa para shpenzojnë të rinjtë për argëtim?
6. Çfarë përqindje të buxhetit familjar shpenzojnë të rinjtë për kohën e lirë?
7. Në ç'mënyra industria e argëtimit i shfrytëzon të rinjtë?
8. Si e kalonin të rinjtë kohën e lirë në të kaluarën?
9. A ndikon familja në zgjedhjen e aktiviteteve të kohës së lirë?
10. Cili është ndikimi i mediave sociale?
11. Cilat lloje argëtimi ishin të njohura në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar?



MBANI MEND

Kombinimi i revolucioneve politike, ekonomike dhe intelektuale krijoi ndryshime të thella shoqërore dhe nevojën për një studim shkencor të shoqërisë, gjë që çoi në shfaqjen e sociologjisë. Sociologjia ishte e nevojshme në shekullin XIX sepse shoqëria ndryshonte shumë shpejt, shfaqeshin probleme të reja shoqërore dhe shpjegimet e vjetra nuk ishin të mjaftueshme. Detyrat e saj ishin: të studionte shkencërisht shoqërinë, të shpjegonte shkaqet e pabarazive dhe konflikteve dhe të kontribuonte në vendosjen e rendit, stabilitetit dhe progresit. Supozohej të jepte përgjigje për pyetjet se si funksionon shoqëria dhe në cilat mënyra mund të përmirësohet jeta e njerëzve.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është sociologjia dhe ç'mëson ajo?
2. Kur u shfaqën idetë e para për krijimin e sociologjisë si shkencë?
3. Pse sociologjia u shfaq në shekullin XIX dhe jo më herët?
4. Cilat ndryshime shoqërore në Evropë kontribuan në shfaqjen e sociologjisë?
5. Pse lindi nevoja për të studiuar shoqërinë shkencërisht ?
6. Si duhej të ndihmonte sociologjia në kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve shoqërore?
7. A është sociologjia shkencë e rëndësishme dhe e nevojshme për shoqëritë e sotme? Jepni shembuj.

2. THEMELUESIT E SOCIOLOGJISË

„Sociologjia duhet ta vendosë njeriun në qendër të studimit shkencor të shoqërisë.”
– Ogyst Kont

Ogyst Konti lindi, u edukua dhe punoi në Francë. Prandaj shoqëria franceze, veçanërisht pas Revolucionit Francez, pati një ndikim të fortë në idetë dhe mësimet e tij. Ai konsiderohet „themeluesi i sociologjisë” për disa arsye:

- **i dha emrin e tij:** Ai ishte i pari që prezantoi sociologjinë si shkencë të veçantë dhe e përcaktoi atë si shkencë që mëson sistematikisht shoqërinë;
- **e përcaktoi qartë lëndën dhe metodat e studimit të sociologjisë:** Konti besonte se shoqëria duhet të studiohet shkencërisht, duke përdorur metodat e shkencave natyrore (vëzhgim, krahasim, analizë);
- **e zhvilloi doktrinën e quajtur pozitivizëm pozitivizëm,** e cila konsiderohet baza e kërkimit sociologjik: Sipas kësaj doktrine, njohuria e vërtetë e dukurive shoqërore duhet të bazohet në fakte dhe përvoja, e jo në supozime, besime ose reflektime filozofike pa prova;
- **e zhvilloi idenë e rendit dhe progresit shoqëror:** Ai besonte se shoqëria, ashtu si natyra, funksionon sipas ligjeve të caktuara dhe duhet të studiohet në mënyrë shkencore dhe objektive. Nëse shkenca zbulon këto ligje, atëherë njerëzit do të jenë në gjendje ta organizojnë më mirë shoqërinë;
- **e ndërtoi një shkallë në të cilën ai i klasifikoi (renditi) shkencat sipas kompleksitetit:** Ai e vendosi sociologjinë në pikën më të lartë në shkallë, si shkenca më komplekse, sepse mëson dukuritë më komplekse: shoqërinë dhe veprimin shoqëror njerëzor. Ai e quajti atë „mbretëreshë e shkencave” sepse përdor njohuritë e të gjitha shkencave të mëparshme.



Ogyst Kont – themelues i sociologjisë

Ogyst Konti jetoi në kohë kur një pjesë e madhe e shoqërive evropiane u tronditën nga revolucionet, luftërat e klasave, dhuna, varfëria, etj. Shkencëtarët e asaj kohe dhanë mendimet e tyre mbi kushtet, por Kont besonte se ato nuk ofronin zgjidhje reale për përmirësimin e tyre. Për këto arsye ai kundërshtoi shpjegimet fetare sipas të cilave gjërat ndodhin sepse Zoti e dëshiron. Ai i konsideronte pretendimet e përgjithshme filozofike si zgjidhje jopraktike, sepse ato nuk bazoheshin në fakte dhe prova. Për shkak të këtyre pikëpamjeve, ai konsiderohet pozitivist. Ai shpesh thoshte: „Nuk mjafton që diçka të tingëllojë e

mençur nëse nuk mund të provohet“. Kont e konsideronte shkencën vetëm atë që shpjegon, ndihmon dhe vendos rendin dhe përparimin në shoqëri. Ja një shembull përmes të cilit mund ta kuptoni më lehtë pozitivismin e Kontit:

Konti e kundërshtoi pohimin se njerëzit janë natyrshëm të dhunshëm. Ai e konsideroi të papranueshme dhe joshkencore për disa arsye: 1. nuk mund të testohet; 2. nuk dihet për cilët njerëz zbatohet (të gjithë ose grupe të caktuara); dhe 3. nuk dihet kur dhe pse njerëzit bëhen të dhunshëm. Pa përgjigje për këto pyetje, për shkak të mungesës së provave, Konti do të thoshte se ky është vetëm mendim, por jo një e vërtetë shkencore. Pozitivismi i Kontit do ta shpjegonte sjelljen e dhunshme të njerëzit në mënyrë tjetër. Ai do të donte të zbulonte përmes vëzhgimit kushtet shoqërore në të cilat njerëzit bëhen të dhunshëm, të përcaktonte se varfëria a i bën njerëzit të dhunshëm, çfarë roli luan arsimi në këtë dhe si funksionojnë institucionet dhe ligjet në shoqëri. Ai besonte se masat për të përmirësuar kushtet shoqërore mund të merren vetëm nëse ato provohen se shkaktojnë sjellje të dhunshme të njerëzit.

Në mësimet e Ogyst Kontit, ideja e ekzistencës së tri fazave në zhvillimin e shoqërisë zë një vend të rëndësishëm: **teologjik**, **metafizik** dhe **pozitiv**. Ai beson se zhvillimi i mendjes njerëzore, e kështu i shoqërisë, varet kryesisht nga zhvillimi i njohurive dhe mendimit njerëzor. Në **fazën teologjike** njerëzit i shpjegojnë dukuritë shoqërore nëpërmjet ndërmjetësimit të Zotit ose forcave mbinatyrore. Prandaj tërmetet ndodhin sepse Zotat janë të zemëruar, përmbytjet sepse Zoti i ndëshkon njerëzit për mëkatet e tyre, sëmundjet ndodhin sepse shpirtrat e këqij kanë hyrë te njerëzit, etj.

Në **fazën metafizike**, sipas Kontit, shoqëritë janë të paqëndrueshme. Feja/kisha humbet rolin e saj dominues. Njerëzit fillojnë të mendojnë ndryshe dhe të shpjegojnë dukuritë shoqërore në mënyrë abstrakte. Tërmetet konsiderohen si rezultat i një force natyrore, uria – nga një ekuilibër i shqetësuar në natyrë, luftërat shpjegohen si dëshirë/shtytje e lindur e njerëzve për pushtet ose dominim, etj. Në këtë fazë dukuritë shoqërore nuk janë ende të provuara dhe të verifikuara nga faktet. Shoqëritë janë të

paqëndrueshme sepse besimet e vjetra mbi të cilat bazohen shoqëritë tradicionale po shemben, ndërsa ato të rejtat mbi të cilat duhet të bazohet rendi i ri (shkencor) nuk janë ndërtuar ende plotësisht.

Në **fazën e tretë (pozitive)** dukuritë shoqërore shpjegohen me fakte dhe ligje shkencore: nëpërmjet vëzhgimit, analizës së kushteve reale, me prova. Njerëzit e kuptojnë se tërmetet janë rezultat i lëvizjes së pllakave tektonike, se uria ndodh për shkak të të korrave të dobëta, thatësive, varfërisë. Por ata gjithashtu përpiqen të gjejnë zgjidhje për të përmirësuar situatën (ata ndërtojnë banesa më të forta që do t'i rezistojnë tërmeteve, modernizojnë bujqësinë, etj.). Sipas Kontit, shoqëritë në fazën pozitive arrijnë fazën më të lartë




Themeluesit e sociologjisë:
Ogyst Kont, Herbert Spenser, Emil Dyrkem, Maks Veber,
Karl Marks, Georg Zimel, Vilfredo Pareto, Ferdinand Tënis,
Harriet Martino

të zhvillimit shoqëror, sepse dukuritë shpjegohen shkencërisht, industria dhe prodhimi zhvillohen, njerëzit specializohen në kryerjen e profesioneve të caktuara dhe në shoqëri vendoset rendi dhe progresi. Në këtë fazë sociologjia shfaqet si shkencë që ka rol misionar për të përmirësuar shoqëritë.

HERBERT SPENSERI: SHOQËRIA SI ORGANIZËM

Spenseri, ashtu si Konti, konsiderohet themeluesi i sociologjisë si shkencë. Edhe pse nuk pajtohej me Kontin në tërësi, ai i zhvilloi dhe i zgjeroi shumë idetë e tij veçanërisht idenë e studimit shkencor të shoqërisë.

Spenseri u ndikua fuqimisht nga mësimet e evolucionit. Ai e krahasoi shoqërinë me një organizëm të gjallë që zhvillohet evolucionar: nga i thjeshtë në kompleks, sipas ligjeve të evolucionit. Ai besonte se shoqëria, si çdo organizëm i gjallë, ka strukturën, funksionet e veta, zhvillohet, evoluon dhe mbijeton përmes ndërvarrësive së pjesëve të saj. Ashtu si zemra, mushkëritë dhe truri kanë funksione të ndryshme, ashtu edhe institucionet shoqërore kanë detyra të ndryshme.




Herbert Spenser

Ashtu si organizëm ka aftësinë të mbajë veten dhe të përshtatet me kushtet, ashtu edhe shoqëria mund të organizohet dhe të zhvillohet në mënyrë të pavarur. Nuk ka nevojë që shteti të ndërhyjë shumë, pasi kjo prish zhvillimin natyror të shoqërisë. Me këtë qëndrim Spenseri kundërshton drejtpërdrejt Kontin, i cili beson se shteti duhet të jetë i fortë dhe i fuqishëm për të siguruar rendin dhe për të udhëhequr shoqërinë drejt përparimit.

EMIL DYRKEMI: FAKTET SHOQËRORE

Për **Dyrkemin** sociologjia është shkenca e **fakteve shoqërore**. Edhe pse ato janë të padukshme, ato i detyrojnë individët të sillen në mënyrë të caktuar dhe duhet të studiohen në mënyrë objektive dhe shkencore. Ai i konsideron faktet shoqërore si: gjuhën, ligjet, zakonet, traditën, familjen, fenë, modën, arsimin, teknologjinë, shkencën, etj.

Dyrkemi e shpjegon arsimin si fakt social. Sipas tij, arsimi fitohet në shkolla dhe ka rregulla që nxënësit duhet t'i respektojnë: të ndjekin mësimet rregullisht, të dëgjojnë mësimdhënësin, të studiojnë sipas programit mësimor, të zgjidhin teste dhe të japin provime. Këto rregulla nuk krijohen nga nxënësit, ato tashmë ekzistojnë.



Emil Dyrkem

Në ç'mënyrë faktet shoqërore (arsimi) i detyrojnë? Nëse nxënësit nuk ndjekin mësimet, nuk mësojnë ose nuk i respektojnë rregullat, ka pasoja si për shembull: paralajmërime ose ndëshkime, nota të dobëta, përsëritje të një viti, etj. Kjo tregon se arsimi vendos rregulla me të cilat nxënësit duhet të

përshtaten. Edhe pse në shikim të parë duket se nxënësit janë të lirë të zgjedhin se ku dhe ç'do të studiojnë, në realitet ata duhet të ndjekin rregulla, të fitojnë njohuri të caktuara dhe të sillen në mënyrë të pranueshme. Për Dyrkemin shoqëria përmes edukimit u mëson të rinjve se ç'është sjellje e saktë, e disiplinuar dhe e pranueshme.

Edhe feja gjithashtu është një fakt shoqëror që detyron. Nuk është vetëm besimi personal i individit, por një sistem i përbashkët besimesh, rritesh dhe ritualesh fetare që zbatohen për të gjithë komunitetin. Feja vendos rregulla të qarta dhe përcakton se ç'lejohej dhe ç'është e ndaluar; ç'konsiderohet e shenjtë dhe ç'është e zakonshme (materiale). Për shkak të këtyre rregullave, besimtarët ndiejnë presion moral për të menduar dhe për t'u sjellë sipas rregullave të fesë, sepse vetëm atëherë nuk do të shpallen imoralë ose të përjashtuar nga bashkësia fetare.

Pra, një tipar i rëndësishëm i të gjitha fakteve shoqërore është se ato janë shtrënguese. Ato përmbajnë rregulla që udhëzojnë sjelljen e individëve. Roli i tyre kryesor është të krijojnë rend dhe stabilitet në shoqëri. Por kur këto rregulla dobësohen ose njerëzit ndalojnë së respektuari ato, rendi dhe stabiliteti mund të prishen. Dyrkemi e quan një gjendje të tillë të shoqërisë anomie, ndërsa shoqërinë **anomike**. Ai beson se anomia është e rrezikshme dhe është dëshmi se shoqëria nuk funksionon mirë. Dyrkemi ishte gjithashtu i interesuar për arsyen pse njerëzit jetojnë së bashku, të bashkuar në shoqëri. Ai argumentoi se arsyeja për këtë është **solidariteti** (mbështetja që njerëzit i japin njëri-tjetrit kur jetojnë në komunitet). Ai i lidh njerëzit për arsye të ndryshme dhe se çfarë lloj mbështetjeje do të jetë varet nga sa e zhvilluar është shoqëria. Në shoqëritë e vjetra (tradicionale) ekziston **solidaritet mekanik**. Njerëzit janë të ngjashëm me njëri-tjetrin, ata e kuptojnë lehtësisht njëri-tjetrin dhe ndihen si pjesë e komunitetit.

Megjithatë, në shoqëritë bashkëkohore (moderne), njerëzit bashkohen nga **solidariteti organik**. Njerëzit janë të ndryshëm dhe kanë interesa të ndryshme, por pikërisht për shkak të kësaj ata varen nga njëri-tjetri. Secili kontribuon me punën e tij dhe shoqëria funksionon si organizëm i vetëm. Me këtë mësim Dyrkemi vërtetoi se me zhvillimin e shoqërisë, ndryshon edhe mënyra e lidhjes midis njerëzve. Edhe pse njerëzit janë të ndryshëm, ata nuk largohen, por përkundrazi, krijojnë forma më të forta lidhjeje sepse kanë nevojë për njëri-tjetrin.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Analizoni shembullin e përshkruar më poshtë dhe më pas përgjigjuni pyetjeve. Përmes tij do të kontrolloni se a e keni kuptuar pozitivizmin e Kontit.

Në shkollën e mesme „Nadezh“ kohët e fundit ka pasur gjithnjë e më shumë probleme: mungesa të shpeshta në mësim, mungesë disipline në mësim, rezultate të dobëta dhe konflikte midis nxënësve. Drejtoria e shkollës merr tre propozime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve:

Propozimi A. Një grup mësimdhënësish beson se nxënësit janë „brez i keq“, pa edukim familjar dhe pa respekt për traditën dhe zakonet. Propozon më shumë ndëshkime dhe paralajmërime më të rrepta për nxënësit.

Propozimi B. Grupi i dytë i mësimdhënësve thotë se problemet janë për shkak të një „krize shpirtërore të të rinjve“. Ata nuk janë të sigurt se në ç’të besojnë sepse kanë humbur kuptimin, vlerat dhe drejtimit në jetë. Si zgjidhje, ata propozojnë më shumë orë mësimi për të diskutuar vlerat shpirtërore dhe morale me të rinjtë.

Propozimi C. Grupi i tretë i mësimdhënësve propozon të kryejë një anketë midis nxënësve, të analizojë arsyet e mungesave dhe performancës së dobët, të hetojë marrëdhënien midis mësimdhënësit dhe nxënësit dhe kushtet për të mësuar, e më pas të marrë masa specifike bazuar në rezultate.

1. Cili propozim korrespondon më shumë me pozitivizmin e Ogyst Kontit?
2. Shpjegoni pse ky propozim është pozitivist!
3. Cilat metoda përdoren në atë propozim?
4. Si mund të kontribuojë kjo qasje në rregull dhe përparim në shkollë?



MBANI MEND

Ogyst Konti, themeluesi i sociologjisë, e krijoi sociologjinë si shkencë të veçantë që mëson në mënyrë sistematike dukuritë shoqërore. Qasja e tij në studimin e dukurive shoqërore quhet pozitivizëm. Sipas tij, shoqëria duhet të studiohet në mënyrë shkencore, mbi bazën e fakteve, me qëllim që të shpjegohen ligjet që e rregullojnë atë dhe, në këtë mënyrë, të sigurohen rendi dhe përparimi. Herbert Spenseri e shihte shoqërinë si një organizëm me pjesë të ndërvarura, ndërsa Emil Dyrkemi theksonte se faktet shoqërore dhe solidariteti sigurojnë stabilitetin e shoqërisë. Sipas këtyre mendimtarëve, detyra e sociologjisë është të shpjegojë jetën shoqërore dhe të përmirësojë funksionimin e bashkësisë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cili sociolog i dha emrin sociologjisë dhe e konsideroi atë „mbretëreshën e shkencave“?
2. Shpjegoni pozitivizmin e Ogyst Kontit!
3. Cili sociolog u ndikua nga evolucionizmi dhe si e përcaktoi ai lëndën e studimit të sociologjisë?
4. Ç’duhet të studiojë sociologjia, sipas Emil Dyrkemit?

3. MAKS WEBERI – KRIJUES I SOCIOLOGJISË INTERPRETUESE (KUPTIMORE)

„Sociologjia nuk shpjegon vetëm atë që bëjnë njerëzit, por edhe pse veprojnë në mënyrë të caktuar.“ – Maks Weber



Maks Weber

Maks Weberi është sociolog gjerman. Mësimi i tij është i ndryshëm nga mësimi pozitivist i Kont. Ai nuk pajtohet që dukuritë shoqërore duhet të studiohen në të njëjtën mënyrë si dukuritë natyrore. Për të nuk mjafton të shpjegohet ajo që ndodh në shoqëri vetëm përmes provave, por është më e rëndësishme të kuptohet pse njerëzit veprojnë në mënyrë të caktuar, si mendojnë dhe cilat vlera respektojnë. Pra, për shembull, nëse dikush vrapon, për Weberin është më e rëndësishme të zbulojë se cili është kuptimi i vrapimit të tij: nëse kuptimi është në të luajturit sport, nëse ai ikën nga rreziku apo vrapon për të kapur autobusin. Për këto arsye ai konsiderohet themeluesi i **sociologjisë interpretuese**.

Weberi ishte i bindur se veprimi shoqëror i njerëzve dhe dukuritë dhe proceset shoqërore nuk ndodhin vetvetiu, por janë rezultat i veprimeve të qëllimshme njerëzore. Është sociologjia që duhet të kuptojë dhe të interpretojë pse njerëzit veprojnë në mënyrë të caktuar. Weberi donte të tregonte se dukuritë shoqërore nuk janë vetëm sisteme rregullash (si në pozitivizëm), por janë edhe rezultat i veprimeve kuptimplote njerëzore. Kuptimi varet nga ajo që mendojnë të tjerët dhe si i vlerësojnë veprimet.

Për Weberin, njerëzit veprojnë për arsye të ndryshme: disa për të arritur një qëllim, të tjerë sepse besojnë në vlera të caktuara, ndërsa të tjerë akoma nga zakoni ose emocioni. Për shembull, një nxënës mëson për një provim (vepron) jo vetëm për veten e tij por edhe për mësimdhënësin, i cili duhet ta vlerësojë atë, e gjithashtu për prindërit, të cilët gëzohen për suksesin e tij.

Sipas Weberit, ekzistojnë katër lloje veprimi shoqëror: **qëllimor-racional**, **vlerë-racional**, **tradicional** dhe **afektiv**.

Njerëzit veprojnë **qëllimor-racional** kur duan të arrijnë qëllim. Ata zgjedhin mjetet më efektive, edhe nëse duhet të shkelin një normë morale. Prandaj nxënësi që mëson të marrë një rezultat të lartë në test mëson në mënyrë selektive (përqendrohet në pyetjet që dështojnë më shpesh në test); harton një plan/strategji mësimi (llogarit se sa kohë dhe përpjekje duhet të investojë për atë qëllim); ndan kohën, heq dorë nga festat dhe shoqërimi me shokët, etj.

Njerëzit veprojnë në mënyrë **vlerore-racionale** kur udhëhiqen nga ajo që është e vlefshme, e mirë dhe jo nga interesi ose përfitimi. Ata veprojnë në përputhje me vlerat dhe normat morale, sepse për ta, qëllimi në vetvete është vlerë. Prandaj nxënësi që e njeh fuqinë e dijes mëson plotësisht dhe rregullisht, jo në mënyrë selektive. Ai ndan kohën sipas ndjenjës së tij të përgjegjësisë dhe disiplinës dhe heq dorë nga festat dhe

Katër llojet e veprimit shoqëror sipas Maks Veberit




shoqërimi; beson se përkushtimi dhe puna e palodhur janë vlerat e duhura, edhe pse nuk garantojnë notën më të lartë. Sipas tij, është më mirë të jesh i ndershëm sesa të marrësh një notë të lartë.

Veberi beson se **veprimi tradicional** është një nga zakoni, ai beson se është një nga zakoni, sepse kështu është bërë gjithmonë. Individët nuk mendojnë për qëllimin ose pasojat, por thjesht e përsërisin sjelljen. Nxënësi do të veprojë tradicionalisht nëse mëson për një provim dhe sillet në mënyrë me të cilën është mësuar, e jo sepse ka një qëllim të qartë ose arsye morale. Ai shkon në test dhe u përgjigjet pyetjeve në mënyrë rutinore. Pra, nxënësi vepron nga zakoni dhe tradita.

Veprimi afektiv shkaktohet më shpesh nga emocionet dhe ndjenjat. Njerëzit reagojnë spontanisht nga frika, gëzimi, zemërimi, etj. Nxënësi që mëson për një test në minutën e fundit dhe pa një plan vepron në mënyrë afektive sepse ndjen frikë nga një notë e keqe ose ndëshkim. I panikuar, nervoz dhe nën presion, ai reagon emocionalisht, sipas ndjenjës së çastit. Veprimet e tij udhëhiqen nga emocionet, jo nga arsyeja.

KARL MARKSI – TEORICIEN I KONFLIKTEVE

Karl Marksi, me mësimet e tij mbi klasat dhe analizën e shoqërisë kapitaliste, kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin e sociologjisë si shkencë. Për shkak të ideve të tij politike, ai shpesh u persekutua, kështu që e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Londër. Atje punoi si gazetar/hulumtues dhe studioi kushtet ekonomike dhe sociale të asaj kohe. Sipas tij, ndryshimet më të mëdha në shoqëri ndodhin për shkak të konflikteve midis klasave shoqërore. Njëra klasë zotëron mjetet e prodhimit, siç janë toka dhe fabrikat (kapitali), ndërsa tjetra nuk ka pronë dhe duhet të punojë për një pagë, domethënë për të mbijetuar. Kjo është ajo që pretendonte Karl Marksi se këto konflikte nuk janë gjithmonë të dhunshme, por gjithmonë rrjedhin nga pabarazia dhe padrejtësia. Kur



Karl Marks

padrejtësia bëhet e madhe, klasa e nënshtruar fillon të luftojë për një jetë më të mirë, ndërsa kjo mund të çojë në ndryshime të mëdha – revolucione. Sipas Marksit, mënyra se si njerëzit sigurojnë jetesën e tyre përcakton të gjitha marrëdhëniet e tjera shoqërore midis njerëzve. Ai besonte se në të ardhmen mund të krijohet një shoqëri pa klasa në të cilën të gjithë njerëzit do të ishin të barabartë dhe nuk do të kishte shfrytëzim ekonomik dhe forma të tjera të shfrytëzimit midis njerëzve.

Marksit studioi gjithashtu revolucionin industrial, veçanërisht punën në fabrika në Angli gjatë shekullit XIX. Ai analizoi kushtet e vështira të punëtorëve: orët e gjata të punës, pagat e ulëta, shfrytëzimin e punës së lirë të fëmijëve. Sipas tij, revolucioni industrial çoi në pabarazi dhe ndarje edhe më të madhe midis pronarëve të pasur dhe punëtorëve të varfër. Marksit nuk ishte sociolog, por idetë e tij përdoren ende sot në mësimin e kapitalizmit, ndryshimeve shoqërore dhe drejtësisë sociale.

Ndryshe nga Ogyst Konti, i cili mendonte se konfliktet shoqërore ishin një problem që duhej zgjidhur, Marksit besonte se konfliktet ishin një pjesë integrale e shoqërive të klasave.

NGJASHMËRITË DHE DALLIMET NË MËSIMET E THEMELUESVE TË SOCIOLOGJISË

Ngjashmëritë dhe dallimet në mësimet e themeluesve të sociologjisë mund të shihen më së miri përmes një shembulli. Ja se si secili prej tyre e shpjegon arsimin si segment shoqëror:

Për **Kontin** arsimi do të ishte një mjet për të vendosur rendin dhe përparimin në shoqëri. Ai mendonte se nëpërmjet arsimit të organizuar shkencërisht, shteti duhet të krijonte stabilitet moral dhe kohezion shoqëror. Spenserit e analizoi arsimin si pjesë të një „organizmi“ që zhvillohet natyrshëm sipas nevojave të shoqërisë industriale. Ai nuk mbështeti kontrollin e tepërt shtetëror, por theksoi zhvillimin evolucionar sipas parimit të përshtatjes. **Dyrkemi** e shihte arsimin si „fakt shoqëror“ që disiplinon dhe socializon individët, duke transmetuar norma, vlera dhe vetëdije kolektive të nevojshme për solidaritetin shoqëror. **Veberi** u përqendrua në kuptimin që nxënësit dhe mësimdhënësit i japin arsimin – pavarësisht nëse studiojnë për një karrierë (qëllimore-racionale), nga bindjet e vlerave, nga zakoni apo nga frika. **Marksit** e shihte sistemin arsimor si mekanizëm për riprodhimin e dallimeve dhe marrëdhënieve ekzistuese të klasave.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Duke përdorur një fenomen shoqëror sipas zgjedhjes suaj, analizoni mësimet e Kontit, Veberit, Dyrkemit dhe Spenserit!

AKTIVITETI 2. Analizoni situatën e përshkruar më poshtë dhe më pas përgjigjuni pyetjeve. Qëllimi është të përcaktohet se pohimi i Veberit se dukuritë shoqërore a mund të shkaktohen nga individët përmes veprimit të tyre shoqëror është i saktë. „Një vendim – fenomen shoqëror“

Një grup nxënësish të vitit të dytë vendosin të mos shkojnë në mësim dhe organizojnë protestë para shkollës. Nxënësit janë të pakënaqur me orarin e mësimet. Ata mendojnë se të kalosh tetë orë në ditë në shkollë është shumë, ndërsa janë të lodhur dhe të stresuar. Informacioni për protestën përhapet shpejt në mediat sociale. Të nesërmen një numër i madh nxënësish u bashkohen atyre. Mësimet pezullohen, mësimdhënësit janë të shqetësuar dhe drejtori cakton një takim me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për të diskutuar problemin.

1. Shpjegoni nëse protesta e nxënësve është veprim shoqëror sipas Veberit. A është e drejtuar ndaj njerëzve të tjerë?
2. Cili është kuptimi i protestës së nxënësve? Ç'duan të arrijnë ata?
3. Ç'i motivon nxënësit të marrin pjesë në protestë? A kanë të gjithë nxënësit të njëjtat motive?
4. Sipas Veberit, cilit nga katër llojet e veprimit shoqëror i përket protesta?
5. Cilit fenomen ose proces shoqëror i doli si rezultat i veprimit të tyre?
6. Pse është e rëndësishme që drejtori dhe mësimdhënësit të kuptojnë motivet e nxënësve për të protestuar?



MBANI MEND

Maks Veberi zhvilloi sociologjinë interpretuese, sipas së cilës shoqëria jo vetëm që duhet shpjeguar, por edhe kuptimi që njerëzit u japin veprimeve të tyre duhet të kuptohet. Ai dallon katër lloje të veprimit shoqëror: qëllimor-racional, vlerës-racional, tradicional dhe afektiv. Karl Marksi besonte se ndryshimi shoqëror lind nga lufta e klasave midis pronarëve të mjeteve të prodhimit dhe punëtorëve, duke e parë historinë si histori të konflikteve të klasave. Ogyst Konti, Herbert Spenseri dhe Emil Dyrkemi theksuan qasjen shkencore ndaj sociologjisë: Konti foli për rendin dhe progresin, Spenseri e krahasoi shoqërinë me një organizëm në zhvillim, ndërsa Dyrkemi theksoi faktet shoqërore dhe solidaritetin. Së bashku ata hodhën themelet e sociologjisë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Pse Maks Veberi quhet krijuesi i sociologjisë interpretuese?
2. Cili është ndryshimi midis mësimet të Maks Veberit dhe Ogyst Kontit?
3. Cili është kontributi i Karl Marksit në sociologji?
4. Pse, sipas Karl Marksit, ndodhin ndryshime në shoqëri? Ç'i shkakton ato?

4. ORIENTIMET TEORIKE NË SOCIOLOGJI

Ç'JANË ORIENTIMET TEORIKE NË SOCIOLOGJI?

Orientimet teorike në sociologji janë mësimet që studiojnë dhe shpjegojnë shoqërinë në mënyrë të ndryshme. Është karakteristike që secila prej tyre bën pyetje të ndryshme, përdor koncepte të ndryshme dhe ofron shpjegime të ndryshme për të njëjtin fenomen shoqëror. Ekziston një numër i madh orientimesh teorike në sociologji, por më të rëndësishmet janë: **pozitivizmi** (i përmendur tashmë), teoritë e **konfliktit**, **funksionalizmi**, **strukturalizmi**, **interaksionizmi simbolik**.

Përmes shembullit të varfërisë do të shihni se si këto mësimet ndryshojnë nga njëra-tjetra:

Varfëria është gjendje në të cilën individët ose grupet nuk kanë burime të mjaftueshme për të përmbushur **nevojat themelore të jetës** (ushqim, veshmbathje, strehim, kujdes shëndetësor, arsim) për shkak të të ardhurave të ulëta, papunësisë, etj.

Për **pozitivistët** varfëria është shenjë që tregon se rendi dhe rregullimi shoqëror është prishur. Shoqëria është e çorientuar sepse institucionet nuk e bëjnë punën e tyre siç duhet. Ata besojnë se varfëria mund të studiohet me fakte dhe ligje që do të ofrojnë zgjidhje për kapërcimin e saj. Konti, si pozitivist, do të thoshte: „Varfëria duhet të vëzhgohet, të matet dhe të krahasohet. Përmes analizave shkencore shkaqet e shfaqjes së saj mund të zbulohen, e përmes planifikimit dhe reformave ajo mund të zvogëlohet ose eliminohet“.

Përfaqësuesit e **teorisë së konfliktit (Karl Marksi dhe Friedrich Engelsi)** besojnë se varfëria ekziston për shkak të shfrytëzimit të klasave të ulëta nga ato më të larta, gjë që krijon pabarazi midis njerëzve. Kapitalistët zotërojnë fabrikat dhe tokën (kapitalin) dhe shfrytëzojnë punëtorët (të cilët nuk zotërojnë asgjë tjetër përveç fuqisë së tyre punëtore). Shfrytëzimi konsiston në pagimin e tyre më pak sesa meritojnë. Në këtë mënyrë të parët pasurohen në kurriz të të dyve, të cilët bëhen më të varfër. Pra, sipas teorisë marksiste të konfliktit, varfëria ekziston sepse ka një shpërndarje të padrejtë të pasurisë në shoqëri. Pasuria e disave krijohet përmes shfrytëzimit (përdorimit të punës) të të tjerëve. Shteti mbron interesat e të pasurve dhe për këtë arsye varfëria mund të zgjidhet vetëm nëse shoqëria e klasave zëvendësohet nga një shoqëri pa klasa.




Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë
shpesh është shkak i konfliktit

Si drejtim teorik varfëria është e preokupuar me **funksionet** e dukurive të ndryshme shoqërore. Nga kjo perspektivë varfëria konsiderohet pjesë e sistemit shoqëror. Ekzistenca e saj gjatë gjithë historisë së njerëzimit tregon se është e pashmangshme dhe se ka një lloj funksioni shoqëror. Prandaj një pyetje kyçe për funksionalistët është pse ekziston dhe si mbahet. Sipas tyre, varfëria ekziston për të siguruar punë për punët më pak të vlerësuara brenda kornizës së ndarjes shoqërore të punës. Ekzistenca e saj përdoret për të justifikuar pabarazitë shoqërore.

Strukturalizmi, si orientim/mësim sociologjik, është variant i funksionalizmit. Krijuesi i tij është antropologu francez **Klod Levi Stros**. Ide kyçe e strukturalistëve është se individët nuk mund të kuptohen nëse shoqëria nuk kuptohet, sepse shoqëria përmes strukturave të saj (familja, arsimi, ekonomia) formëson jetën e tyre. Për këto arsye strukturalistët nuk e konsiderojnë varfërinë si dështim personal të individëve, por si pasojë e joefikasitetit të strukturës ekonomike, sistemit arsimor dhe marrëdhënieve të klasave. Ato nuk u ofrojnë njerëzve qasje të barabartë në para, arsim, punë, pushtet, privilegje dhe një jetë të shëndetshme. Nëse ekonomia nuk u ofron njerëzve mundësi të barabarta punësimi, disa do të fitojnë para dhe të tjerët jo. Njerëzit që nuk kanë qasje në arsim cilësor kanë më pak shanse për të gjetur një punë të paguar mirë, etj. Papunësia, arsimi me cilësi të dobët dhe profesionet me paga të ulëta shkaktojnë varfëri. Pra, shoqëria është ajo që i bën njerëzit të varfër.

Ndërveprimi simbolik është doktrinë sociologjike që përqendrohet në marrëdhëniet e përditshme midis njerëzve dhe kuptimin e tyre. Përfaqësuesit e saj janë **Xhorxh Mid** dhe **Çarls Kuli**. Ata nuk e shohin shoqërinë vetëm si strukturë në të cilën ekziston një shtet, ekonomi, arsim, etj. Ata besojnë se shoqëria krijohet nga njerëzit përmes bisedave, pikëpamjeve, reagimeve dhe sjelljeve në jetën e përditshme. Njerëzit e përfytyrojnë veten bazuar në mënyrën se si i shohin të tjerët (teoria e vetvetes pasqyrë).

Kjo qasje vërehet edhe në mënyrën se si e shpjegojnë varfërinë. Për ta varfëria nuk është vetëm të mos kesh para për ushqim, veshmbathje ose shtëpi. Ajo që është më e rëndësishme është se si perceptohen njerëzit e varfër në shoqëri dhe si i trajtojnë të tjerët ata. Për shembull, nëse dikush vesh rroba të vjetra ose jeton në shtëpi modeste, kjo mund të bëhet një simbol përmes të cilit të tjerët arrijnë në përfundimin se është i varfër. Për shkak të kësaj individ mund të tallet, etiketohet ose refuzohet nga grupi. Reagime të tilla ndikojnë në mënyrën se si person e sheh veten. Nëse ai trajtohet vazhdimisht si më pak i vlefshëm, ai mund të fillojë të ndihet dhe të sillet në atë mënyrë vetë. Prandaj ndërveprimistët simbolikë argumentojnë se varfëria



Teoria e vetvetes si pasqyrë

nuk është vetëm gjendje ekonomike, por edhe përvojë shoqërore e mbushur me kuptime, etiketa dhe marrëdhënie midis njerëzve. Për të kuptuar shoqërinë, duhet të kuptojmë marrëdhëniet dhe simbolet e përditshme përmes të cilave njerëzit komunikojnë.

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË NJIHEN ORIENTIMET TEORIKE NË SOCIOLOGJI?

Orientimet teorike në sociologji janë mësim/teori që ofrojnë mënyra të ndryshme për të studiuar, shpjeguar dhe interpretuar dukuritë dhe proceset shoqërore. Ato janë një lloj „kornize mendimi“ përmes së cilës sociologët përcaktojnë lëndën e studimit, paraqesin pyetje kërkimore, zgjedhin metodat dhe

teknikat e kërkimit dhe interpretojnë dukuritë dhe proceset shoqërore. Orientimet sociologjike duhet të njihen për disa arsye:

- ato i paralajmërojnë hulumtuesit se një fenomen shoqëror mund të kuptohet dhe shpjegohet në më shumë se një mënyrë;
- ato ndërtojnë themelin shkencor të sociologjisë – pa teori nuk ka kërkim shkencor;
- ndihmojnë në analizimin e një fenomeni/problemi shoqëror nga aspekte të ndryshme në mënyrë që të merret një shpjegim më i thellë dhe më gjithëpërfshirës;
- zhvillojnë të menduarit kritik tek ata që hulumtojnë shoqërinë.

Edhe pse janë të ndryshme nga njëra-tjetra, këto studime kanë të njëjtin qëllim – t'u përgjigjen pyetjeve se çfarë lloj strukture kanë shoqëritë, si funksionojnë grupet dhe institucionet shoqërore, cila është marrëdhënia midis individëve dhe shoqërisë, si lindin dukuritë dhe proceset shoqërore, cilët faktorë shkaktajnë ndryshime shoqërore, etj. Orientimet teorike e ndihmojnë sociologjinë të kuptojë më mirë shoqërinë, të shpjegojë pse ndodh diçka, të lidhë faktet në tërësi të vetme mendimi dhe të parashikojë ndryshimet shoqërore. Pa teori sociologjia do të ishte thjesht regjistrim i të dhënave ose sociografi. Ato e bëjnë sociologjinë shkencë analitike dhe më pak përshkruese.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Studimi i rastit – Pse disa nxënës shpesh i lënë orët e mësimit?

Përshkrimi i problemit: Në klasën tuaj disa nxënës shpesh i lënë orët e mësimit. Ata nuk kanë gjithmonë arsye të justifikuara dhe mungesat e tyre ndikojnë në suksesin e tyre dhe suksesin e orës së mësimit.

Përshkrimi i problemit: Në klasën tuaj disa nxënës shpesh i lënë orët e mësimit. Ata nuk kanë gjithmonë arsye të justifikuara dhe mungesat e tyre ndikojnë në suksesin e tyre dhe suksesin e orës së mësimit.

Kur studioni problemin kini parasysh se funksionalizmi merret me mënyrën se si funksionon shkolla në tërësi (a e përmbush funksionin e saj); teoria e konfliktit merret me atë se kush ka pushtet, privilegje (sistemi a është i drejtë, rregullat a janë të njëjta për të gjithë); ndërveprimi simbolik merret me marrëdhëniet e përditshme dhe kuptimin e tyre (si ndihen nxënësit në orë).

1. Pse, sipas teorisë që keni zgjedhur, nxënësit i lënë orët e mësimit? Cilat janë arsyet?
2. Cilët individë ose grupe janë të rëndësishëm në këtë problem (nxënës, mësime, prindër, shkollë)?
3. Çfarë pasojash krijon mungesa në shkollë sipas teorisë (ç'u ndodh nxënësve dhe shkollës)?
4. Cila do të ishte një zgjidhje e mirë sipas kësaj teorie?

Krahasoni idetë dhe mendimet tuaja me ato të shokëve dhe shoqeve të klasës dhe nxirrni një përfundim: Pse është e dobishme të shikoni të njëjtin problem në më shumë se një mënyrë?



MBANI MEND

Orientimet teorike në sociologji janë „syze“ që u lejojnë sociologëve të vëzhgojnë dhe të interpretojnë dukuritë shoqërore ndryshe. Me ndihmën e tyre sociologët dinë si ta përcaktojnë problemin e kërkimit, si t'i interpretojnë rezultatet e kërkimit, të zgjedhin metodat dhe teknikat e duhura të kërkimit (anketë, intervistë, vëzhgim) dhe të shmangin mendimet subjektive. Teoritë u japin atyre drejtim dhe një kornizë për kërkimin e tyre, i ndihmojnë të mendojnë në mënyrë kritike, të kuptojnë se nuk ka vetëm një shpjegim „të saktë“ dhe të kuptojnë më mirë problemet në shoqëri.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'janë orientimet teorike në sociologji?
2. Pse sociologët nuk e analizojnë shoqërinë në të njëjtën mënyrë?
3. Pse është e rëndësishme të kemi orientime të ndryshme teorike?
4. Ç'do të ndodhte nëse do të përdornim vetëm një orientim teorik për të shpjeguar një problem shoqëror?
5. Cili orientim teorik e krahason shoqërinë me një organizëm njerëzor, mbijetesa e të cilit varet nga puna e organeve të tij?
6. Për cilin orientim teorik, ndarja klasore e njerëzve është shkaku i pabarazive dhe problemeve sociale?
7. Cili orientim teorik, sipas mendimit tuaj, ju ndihmon më shumë të kuptoni jetën e përditshme? Pse?

5. FAZAT, METODAT DHE TEKNIKAT NË KËRKIMET SOCIOLOGJIKE

„Hipoteza është ura lidhëse midis teorisë dhe të dhënave.“ – Robert Merton

Pavarësisht nëse objekti i studimit të sociologjisë është shoqëria në tërësi apo veprimi shoqëror i njerëzve, një nga detyrat më të rëndësishme të sociologjisë është **të zbulojë marrëdhënien midis të përgjithshmes (shoqërisë) dhe të veçantës (sjelljes së individëve ose grupeve)**. Kjo do të thotë se detyra e saj është të përcaktojë nëse njohuria në të cilën arrin përmes hulumtimit të një rasti individual (të veçantës) është e vlefshme edhe për të gjitha rastet e tjera të ngjashme në shoqëri (të përgjithshmes). Për shembull, një sociolog i cili, përmes një bisede me një nxënës, mësoi se arsyeja e performancës së tij të dobët në shkollë janë problemet në familje, do të dëshirojë të kryejë një anketë midis një numri më të madh nxënësish për të kontrolluar nëse performanca e tyre e dobët gjithashtu është pasojë e së njëjtës arsye. Në këtë mënyrë sociologjia lidh të veçantën (një nxënës) me të përgjithshmen (një grup ose një popullatë të tërë nxënësish). Domethënë, përmes rasteve individuale ajo zbulon rregulla dhe rregullsi që vlejné për të gjithë shoqërinë. Kjo e bën sociologjinë shkencë përgjithësuese/gjeneralizuese. Që të jetë në gjendje të realizojë këto detyra, sociologjia ka nevojë për metoda dhe teknika kërkimore.

Metodë (greqisht-*methodos*) do të thotë një qasje, një procedurë, një mënyrë se si bëhet diçka. Për shembull, kur mësoni, së pari lexoni mësimin, pastaj nënvizoni informacione dhe koncepte të rëndësishme, e më pas mbani shënime të shkurtra dhe përsëritni atë që keni mësuar përmendësh duke iu përgjigjur pyetjeve, etj. Kjo sekuencë hapash është metodë mësimi.

Teknikat e kërkimit janë vegla/mjete teknike që përdoren në faza të ndryshme të kërkimit. Disa përdoren për mbledhjen e të dhënave, të tjera për organizimin e tyre, të tretat për përpunimin dhe analizimin e tyre, ndërsa të tjera për prezantimin e tyre. Për shembull, mësimdhënësi në shkollën tuaj dëshiron të zbulojë se cilat janë sportet e preferuara të nxënësve në mënyrë që të mund të organizojë aktivitete sportive. Ai mund t'i marrë këto të dhëna duke përdorur disa teknika:

- anketë – i pyet ata me shkrim se cili sport është i preferuari i tyre;
- intervistë – bisedon me nxënësit se pse u pëlqen ai sport;
- vëzhgim – sheh/vëren se cilat sporte luajnë më shpesh nxënësit gjatë pushimeve të shkollës, në fushat sportive, etj.;
- organizim dhe analizë e të dhënave – analizon përgjigjet dhe nxjerr përfundime;
- prezantim i përfundimeve dhe gjetjeve.

Pra, **metoda është plan se si të bëhet diçka, ndërsa teknikat janë mënyrat specifike që përdorim në plan**. Pa metoda dhe teknika, asnjë shkencë nuk mund ta shpjegojë lëndën e hulumtimit, as të ofrojë njohuri shkencore

rreth tij. Por ato duhet të përshtaten edhe me lëndën e hulumtimit, sepse nëse nuk janë, rezultatet e marra nga hulumtimi do të jenë të pasakta dhe jo shkencore. Nuk është rastësi që Dyrkemi tha: „Metoda nuk është shtesë teknike e hulumtimit, por një kusht që përcakton lëndën e njohurive shkencore.“ Me këtë, Dyrkemi thekson qartë se zgjedhja e gabuar e metodës çon në keqkuptim të fenomenit shoqëror.

Për shembull, nëse ju jepet detyra të hulumtoni pse dhuna në shkollë rritet dhe vendosni të lexoni disa komente në mediat sociale, ose thjesht të pyesni disa miq se ç'mendojnë, atëherë metoda është e papërshtatshme. Mendimet personale dhe përshtypjet individuale nuk janë të mjaftueshme për të nxjerrë një përfundim shkencor. Një qasje e tillë mund të çojë në shpjegime të thjeshtuara dhe të pasakta. Në vend të kësaj, nevojitet mbledhja sistematike e të dhënave – përmes anketave me një numër më të madh nxënësish, intervistave me mësimdhënës dhe shërbime profesionale, analizës së raporteve shkollore dhe krahasimit të rezultateve.

METODAT DHE TEKNIKAT MË TË PËRDORURA NË KËRKIMET SOCIOLOGJIKE

Anketa është teknikë e mbledhjes së të dhënave. Sociologët e përdorin më shpesh atë për kërkime të shpejta, ekonomike dhe masive. I ndihmon ata të krijojnë pamje të përgjithshme të fenomenit që hulumtojnë, duke marrë kështu të dhëna të shpejta dhe të sakta në kohë të shkurtër. Anketa mund të përdoret për të zbuluar se çfarë mendimesh dhe qëndrimesh kanë të anketuarit mbi tema të caktuara. Ajo përmban pyetje të përgatitura paraprakisht që mund të jenë me përgjigje të sugjeruara nga të cilat i anketuari duhet të zgjedhë dhe të rrethojë një ose pyetje të cilave i anketuari duhet t'u përgjigjet tekstualisht – sipas mendimit të tij. Një nga parimet më të rëndësishme të një ankete është anonimat. Kjo do të thotë se të anketuarit duhet të mbeten anonimë dhe se të dhënat e marra do të përdoren vetëm për qëllime shkencore. Prandaj anketa është më e përshtatshme për të hulumtuar opinionin publik (qëndrimet e njerëzve në lidhje me politikën, arsimin, shëndetin, median, modën, stilin e jetës, etj.).

Intervista është anketë me gojë. Hulumtuesi zhvillon një bisedë me të anketuarin sipas pyetjeve të parapërgatitura dhe të menduara mirë. Intervista përdoret kur hulumtuesi dëshiron ta kuptojë në thelb fenomenin dhe të zbulojë arsyet më të thella të ndodhjes së tij. Përdoret më shpesh kur problemi që hulumtohet është i ndjeshëm, kur përvoja personale e të anketuarit dhe mendimet ose qëndrimet e tij janë të rëndësishme. Për shembull, përmes një interviste mund të zbulohen arsyet pse të rinjtë emigrojnë nga vendi, pse ndodhin konfliktet familjare, çfarë pasojash shkakton stresi afatgjatë në vendin e punës, etj.

Meqenëse ato plotësojnë njëra-tjetrën, anketa dhe intervista më shpesh kombinohen me vëzhgim. Atë që



Intervistë



Sociolog në „vendin e punës”, si vëzhgues

shok me kë), si i zgjidhin konfliktet, etj. Kur një sociolog-hulumtues vëzhgon, ai ka mundësinë të shohë personalisht se ç’po ndodh në të vërtetë.

Metoda eksperimentale përdoret për të përcaktuar **marrëdhënie shkak-pasojë** midis dukurive. Sociologu-hulumtues ndryshon qëllimisht një faktor (variabël i pavarur) dhe monitoron ndikimin e tij në faktor tjetër (variabël i varur). Për shembull, një sociolog-hulumtues dëshiron të hetojë se kohëzgjatja e të nxënësve ndikon në suksesin e nxënësve. Për këtë qëllim ai formon dy grupe nxënësish. Grupi i parë mëson për një orë dhe i dyti për tri orë. Koha e të nxënësve është variabli i pavarur, ndërsa rezultatet e të nxënësve janë variabli i varur. Pas një periudhe të caktuar kohore, nxënësit bëjnë test. Nëse grupi i dytë i nxënësve performon më mirë në test, sociologu-hulumtues mund të arrijë në përfundimin se kohëzgjatja e të nxënësve ndikon në suksesin e arritur nga nxënësit në test. Në sociologji eksperimenti përdoret më rrallë sesa në shkencat natyrore për disa arsye:

1. Eksperimenti kryhet më shpesh në mjedis të kontrolluar në të cilin kushtet ndryshohen dhe dukuritë provokohen qëllimisht. Eksperimenti është i pamundur për të studiuar shumë fenomene shoqërore. Sociologu-hulumtues nuk mund të shkaktojë luftë ose të varfërojë qëllimisht njerëzit, vetëm për të shpjeguar se si ndodh lufta dhe cilat janë shkaqet e varfërisë.
2. Nuk është etike e lejuar të kryhen eksperimente mbi njerëzit, veçanërisht nëse të drejtat dhe dinjiteti i tyre shkelen, nëse ata detyrohen të marrin pjesë, nëse privatësia e tyre shkelet, ose nëse ata janë të ekspozuar ndaj torturave psikologjike dhe fizike, etj. Për shembull, një mësimdhënës mund t’i fyejë dhe nënçmojë qëllimisht nxënësit për të përcaktuar se si stresi ndikon në sjelljen e tyre, ose të burgosurit mund të abuzohen mendërisht dhe fizikisht për të studiuar marrëdhëniet në burg.

Në sociologji **metoda statistikore** përdoret për të mbledhur, përpunuar dhe analizuar të dhëna numerike (numërore), më shpesh të marra përmes anketave, regjistrimeve të popullsisë ose analizave statistikore me

qëllim që të zbulohen rregullsitë shoqërore, trendet dhe marrëdhëniet midis dukurive shoqërore. Të tilla janë të dhënat demografike (numri i banorëve, gjinia, mosha, shkalla e lindjeve, vdekshmëria), të dhënat ekonomike (personat e punësuar, personat e papunë, niveli i pagave, standardi i jetesës), të dhënat arsimore (niveli i arsimit, numri i nxënësve, nxënësit, shkalla e shkrim-leximit), të dhënat shoqërore (gjendja familjare, madhësia e familjes, mbrojtja sociale), etj. Duke kombinuar këto të dhëna statistikore, sociologjia **mund të shpjegojë situata, të zbulojë probleme dhe të propozojë zgjidhje të përshtatshme.**

Sociometria është metodë e përdorur në sociologji për të studiuar marrëdhëniet midis njerëzve në grupe të vogla (në shkolla, grupe pune, ekupe sportive, etj.). Kjo metodë heton se kush është mik me kë, kush është i pranuar dhe kush është i izoluar nga grupi. Duke bërë pyetje të thjeshta si: me kë do të dëshironit të uleni/ bashkëpunoni?, sociologu-hulumtues, bazuar në përgjigjet, mund të zbulojë se kush janë udhëheqësit në grup, a ka nëngrupe apo konflikte të mundshme.

Analiza e përmbajtjes është metodë e përdorur për të studiuar materiale të shkruara, të folura ose vizuale (**gazeta**, revista, media televizive dhe interneti, reklama, dokumente historike, fjalime dhe deklarata publike, postime në mediat sociale). Ç’thuhet në to, sa shpesh dhe në çfarë mënyre, analizohet në mënyrë që të zbulohen qëndrime, vlera dhe mesazhe të rëndësishme për jetën shoqërore. Për shembull, një sociolog dëshiron të hetojë se si media i paraqet të rinjtë dhe çfarë mesazhi dërgojnë ata. Duke analizuar një numër të madh artikujsh nga portalet ose gazetat e internetit, ai përcakton se sa shpesh të rinjtë paraqiten në kontekst pozitiv dhe sa shpesh në kontekst negativ. Nëse, pas analizës, ai përcakton se të rinjve u atribuohen më shpesh karakteristika negative (dhunë, papërgjegjësi, përtaci, prirje ndaj veseve, varësi ndaj teknologjisë), kjo do të thotë se media krijon një imazh të caktuar të të rinjve që ndikon në opinionin publik.

Kur një sociolog-hulumtues dëshiron të bëjë krahasim midis dukurive shoqërore për të përcaktuar ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre, ai përdor **metodë krahasuese**. Përmes krahasimit ai i kupton më lehtë shkaqet e dukurive të caktuara dhe zhvillimin e tyre. Për shembull, me metodë krahasuese, një sociolog-hulumtues mund të zbulojë se cili ishte qëndrimi i të rinjve ndaj arsimit në të kaluarën dhe cili është sot ose cilat ishin marrëdhëniet në familje në të kaluarën dhe cilat janë tani. Përmes krahasimit përcaktohet se si dhe pse lindën ndryshimet.

Studimi i rastit (Case study) është metodë e përdorur për studim të thelluar të një rasti specifik (individual, familjar, grupor, institucion ose një ngjarje specifike). Qëllimi i kësaj metode është të kuptohet dhe të shpjegohet një fenomen i caktuar shoqëror dhe të ofrohet një zgjidhje e përshtatshme përmes një hulumtimi të plotë të një shembulli specifik (real). Për shembull, një sociolog-hulumtues mund të hetojë problemin e dhunës nga bashkëmoshatarët në shkollë përmes një studimi rasti (duke folur me nxënës, mësues dhe prindër, duke vëzhguar atmosferën dhe duke analizuar kushtet në shkollë) dhe përmes këtij rasti të nxjerrë përfundime që do të vlejnjë për të gjitha rastet e tjera të dhunës nga bashkëmoshatarët.

HAPAT (FAZAT) E KËRKIMIT SOCIOLOGJIK

Kërkimi shkencor është proces i planifikuar, sistematik dhe objektiv i mbledhjes, analizimit, interpretimit dhe prezantimit të të dhënave dhe njohurive me qëllim shpjegimin e një fenomeni dhe arritjen në njohuri dhe përfundime shkencore. Kërkimi shkencor nuk kryhet „verbërisht“, por sipas rregullave të përcaktuara qartë. Çdo kërkim shkencor, përfshirë edhe atë sociologjik, zhvillohet në disa hapa (faza):

1. Përzgjedhja dhe përkufizimi i problemit dhe pyetjes së kërkimit

Në këtë fazë hulumtuesi zgjedh problemin e kërkimit, përcakton pyetjen e kërkimit dhe shpjegon rëndësinë e problemit që hulumtohet (çfarë përfitimesh do të ketë shoqëria dhe shkenca prej tij). Konsiderohet se një problem i përcaktuar mirë është kërkim gjysmë i përfunduar sepse:

- përcakton drejtimin dhe fushëveprimin e kërkimit: Hulumtuesi e di saktësisht se ç'të hulumtojë, nuk merret me tema. Për shembull, nëse detyra është të hetojë dhunën midis të rinjve, duhet të jetë: Sa shpesh ndodhin incidente dhune midis nxënësve të vitit të dytë në periudhë prej një muaji? Një përkufizim kaq i qartë drejton punën kërkimore dhe u jep përgjigje pyetjeve: kush është subjekti (nxënësit e vitit të dytë), ç'po hulumtohet (incidente të dhunshme), cilët faktorë analizohen (situatat, motivet, roli i bashkëmoshatarëve dhe mësimdhënësve) dhe sa zgjat hulumtimi (një muaj);
- **ndihmon në zgjedhjen e një metodologjie të përshtatshme:** Më parë shpjeguar se të dhënat mbi dhunën te të rinjtë nuk mund të merren vetëm përmes anketave ose intervistave, por përmes vëzhgimit sistematik të sjelljes, analizës së raporteve shkollore, statistikave të incidenteve dhe intervistave me nxënës dhe mësimdhënës. Vetëm në këtë mënyrë hulumtimi do të ofrojë njohuri të sakta dhe të besueshme rreth fenomenit;
- **lehtëson mbledhjen dhe analizën e të dhënave:** Nëse pyetja kërkimore është „Pse dhuna te të rinjtë në shkolla është dukuri e shpeshtë?“ Të dhëna të rëndësishme që duhet të zbulohen janë: ku ndodhin incidentet, situatat në të cilat ndodhin dhe roli i bashkëmoshatarëve dhe mësimdhënësve në to. Të dhëna të padobishme do të ishin informacionet nëse ngacmuesi mban syze ose cila është lënda e tij e preferuar, sepse ato nuk e shpjegojnë problemin. Metoda e saktë ofron njohuri të sakta dhe kuptimplotë rreth fenomenit shoqëror.

2. Rishikimi i literaturës dhe korniza teorike

Në këtë fazë hulumtuesi:

- **analizon punimet dhe kërkimet shkencore ekzistuese:** Kryen rishikim të literaturës ekzistuese (a ka hulumtuar dikush para tij të njëjtin problem, në çfarë përfundimesh ka arritur dhe si mund të përdoren ato në hulumtimin e tij). Në këtë mënyrë shmanget dyfishimi i rezultateve tashmë të njohura;
- **përcakton konceptet dhe teoritë kryesore:** Nëse tema ka të bëjë me shkaqet e rritjes së dhunës midis të rinjve në shkolla konceptet kryesore do të ishin: dhuna (informacion në lidhje me atë se çfarë

sjelljeje konsiderohet e dhunshme, sa shpesh ndodh, me çfarë intensiteti), mjedisi shkollor (bashkëmoshatarët, mësimdhënësit, rregullat), presioni social, motivimi, konflikti dhe emocionet. Një përkufizim i qartë i këtyre koncepteve ndihmon që hulumtimi të jetë sistematik dhe objektiv, pasi dihet saktësisht se çfarë dhe si do të vëzhgohet, matet dhe analizohet.



Hulumtimi është më i suksesshëm kur secili anëtar i ekipit e di rolin e tij

3. Formulimi i qëllimeve, detyrave dhe hipotezave

Hulumtuesi në këtë fazë:

- **përcakton qëllimin e hulumtimit** (ç'duhet të zbulojë): Për shembull, qëllimi i hulumtimit tuaj mund të jetë përcaktimi i shkaqeve të dhunës së shpeshtë midis të rinjve në shkolla dhe faktorët që ndikojnë më shumë në këtë sjellje;
- **përcakton detyrat** (shpjegon se ç'do të bëjë për të arritur qëllimin): Për shembull, detyra juaj do të ishte të mblidhni të dhëna mbi incidentet e dhunës në shkolla, të intervistoni nxënës dhe mësimdhënësit, të regjistroni dhe krahasoni situatat dhe shkaqet, e më pas të analizoni rezultatet dhe të nxirrni përfundime rreth faktorëve që ndikojnë në sjelljen e dhunshme;
- **përcakton hipoteza kryesore dhe ndihmëse**, pra supozimet shkencore që do të testohen: Për shembull, hipoteza kryesore e hulumtimit tuaj do të ishte: Dhuna midis të rinjve rritet kur ka konflikte me bashkëmoshatarët ose mungesë kontrolli nga mësimdhënësit. Hipotezat mbështetëse mund të jenë: 1) Dhuna është më e zakonshme në klasat me dinamikë të fortë grupi; 2) Nxënësit e ekspozuar ndaj presionit të bashkëmoshatarëve kanë më shumë gjasa të reagojnë dhunshëm; 3) Prania e rregullave dhe rendit të rreptë zvogëlon numrin e incidenteve. Hipotezat duhet të jenë të qarta, të testueshme dhe të lidhura logjikisht me problemin.

4. Përzgjedhja e metodave, teknikave dhe instrumenteve

Në këtë fazë hulumtuesi vendos se cilat metoda, teknika dhe instrumente do të përdorë në hulumtim. Për hulumtimin tuaj këto do të ishin, për shembull: **vëzhgimi i rasteve të dhunës në shkolla, intervistat me nxënës dhe mësimdhënësit dhe analiza e raporteve dhe statistikave nga shkolla**. Këto metoda mundësojnë studim sistematik dhe objektiv të problemit.

5. Përzgjedhja e mostrës

Hulumtimi shkencor kryhet më shpesh në mostër të zgjedhur, në vend të të gjithë popullatës, sepse është më praktik, më ekonomik dhe më efikas. E gjithë popullata shpesh është shumë e madhe, e vështirë për t'u qasur ose e shtrenjtë për t'u hulumtuar plotësisht. Me një mostër të zgjedhur me kujdes dhe përfaqësuese, hulumtuesi mund të marrë rezultate të besueshme që vlejné për të gjithë popullatën. Në këtë mënyrë koha dhe burimet kursehen, ndërsa përfundimet shkencore mbeten relevante. Për shembull, nëse doni të hulumtoni se sa shpesh ndodhin incidente dhune midis nxënësve të vitit të dytë në shkollën tuaj, ndërsa ka dyqind nxënës në atë vit, madhësia e mostrës përfaqësuese do të varet nga niveli i dëshiruar i besimit në mostër. Për këtë qëllim përdoren formulat statistikore. Në këtë mënyrë mund të merrni gjetje relativisht të besueshme dhe domethënëse pa pasur nevojë të mbulonit të gjithë nxënësit.

6. Mbledhja e të dhënave

Kjo është faza në të cilën aplikohen metodat dhe teknikat e zgjedhura dhe mblidhen të dhënat.

7. Përpunimi dhe analiza e të dhënave

Në këtë fazë hulumtuesi organizon të dhënat e mbledhura, i analizon ato, i krahason ato dhe kërkon një shpjegim të asaj që ato tregojnë. Së fundmi hulumtuesi kontrollon se hipoteza (supozimi që bëri në fillim) a është e saktë apo jo. Me fjalë të tjera, këtu zbulohet nëse hulumtimi dha rezultatet e pritura.

8. Interpretimi dhe përfundimet

Në këtë fazë hulumtuesi lidh rezultatet e hulumtimit me teoritë shkencore. Ai shpjegon se çfarë domethënie kanë rezultatet dhe nxjerr përfundime shkencore. Ai njofton nëse hipoteza është

konfirmuar apo jo dhe ç'do të thotë kjo në praktikë. Shkurt ky është momenti kur zbulohen të dhënat e nxjerra falë hulumtimit dhe cilat janë përfitimet prej tij.



Rezultate të hulumtimit paraqitura me qëllim nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve

9. Prezantimi i rezultateve

Faza përfundimtare përfshin shkrimin e një punimi shkencor, raporti ose studimi, një prezantim të qartë dhe të arsyetuar të gjetjeve, duke cituar burimet dhe literaturën e përdorur.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Mundohuni të formuloni pyetje kërkimore nga temat e listuara, e më pas shpjegoni se me cilat metoda dhe teknika duhet të hetohet secila prej tyre.

Temat:

1. Përdorimi i telefonave celularë në shkollë
2. Mungesa e paarsyeshme nga mësimet
3. Puna e të rinjve dhe vullnetarëve

AKTIVITETI 2. Zgjidhni një nga pyetjet kërkimore që keni përcaktuar në aktivitetin e mëparshëm, e më pas bëni një skicë/plan të kërkimit. Shpjegoni fazat (hapat) sipas të cilave do të kryhet kërkimi dhe cilat aktivitete do të përmbajë secila fazë.

**MBANI MEND**

Për kërkimin shkencor, veçanërisht për kërkimin shoqëror, është shumë e rëndësishme që hulumtuesi të jetë në gjendje të formulojë qartë pyetjen kërkimore, sepse i gjithë rrjedha e kërkimit varet prej tij. Njohja e fazave të kërkimit e ndihmon hulumtuesin të dijë saktësisht se ç'të bëjë në secilën fazë dhe të mos anashkalojë hapa të rëndësishëm. Zgjedhja e saktë e metodave dhe teknikave i lejon atij të mbledhë të dhëna të sakta dhe të besueshme. Nëse sociologu-hulumtues nuk i di këto gjëra, hulumtimi mund të jetë i paqartë, të dhënat të pasakta dhe përfundimet të gabuara. Kjo zvogëlon vlerën shkencore të hulumtimit dhe zbatueshmërinë e tij në praktikë.

**KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA**

1. Pse është e rëndësishme që hulumtuesi të formulojë qartë pyetjen kërkimore?
2. Në cilat raste përdoret metoda sociometrike? Jepni shembuj.
3. Pse hulumtuesi duhet t'i dijë fazat e hulumtimit?
4. Ç'do të ndodhë nëse hulumtuesi zgjedh teknikat e gabuara të hulumtimit?

1. SHOQËRIA, DUKURIA SHOQËRORE, PROCESI SHOQËROR

Ç'ËSHTË SHOQËRIA?

Koncepti shoqëri është krijim sociologjik. Përdorimi i tij fillon me shfaqjen e sociologjisë si shkencë. Me ndihmën e saj realiteti shoqëror fillon të shpjegohet në mënyrë të re (pozitive) ose shkencore.

Koncepti shoqëri do të thotë bashkësi e organizuar njerëzish që lind në një territor të caktuar si rezultat i veprimit të tyre të ndërsjellë mbi natyrën (prodhimin), të lidhur nga marrëdhënie, norma, vlera, institucione dhe kultura të ndërsjella. Nga ky përkufizim mund të nxjerrim një përfundim se shoqëria ka disa karakteristika:

- se është grupi më i madh dhe i vetëmjaftueshëm i njerëzve;
- njerëzit janë të lidhur nga një territor i përbashkët;
- në të ka marrëdhënie ekonomike, politike, kulturore;
- njerëzit ndërtojnë ndjenjë përkatësie dhe bashkësie (më shpesh si komb);
- jeta në të rregullohet nga normat, vlerat, zakonet, kultura, institucionet.



Njerëz me role dhe aktivitete të ndryshme në shoqëri

PSE SHOQËRIA ËSHTË KOMUNITET I ORGANIZUAR DHE I VETËMJAFTUESHËM?

Të jesh i vetëmjaftueshëm do të thotë se je gati të bësh gjithçka vetë. E njëjta gjë vlen edhe për shoqërinë. Shoqëria është e vetëmjaftueshme sepse në territorin që mbulon, vetë komuniteti (grupi i njerëzve) krijon kushtet për mbijetesën dhe funksionimin e vet. Ajo krijon institucione dhe mekanizma për të përmbushur nevojat themelore: **familjen** (për riprodhim dhe socializim), **ekonominë** (për prodhimin dhe shkëmbimin e mallrave), **arsimin** (për transferimin e njohurive), **sistemin politik** (i cili siguron rendin dhe menaxhimin), etj. Ndjenja e komunitetit, nga ana tjetër ndërtohet përmes respektit për të gjithë banorët si qytetarë pavarësisht nga dallimet e tyre. Përmes edukimit, arsimit, festave, zakoneve dhe përvojave të përbashkëta, individët mësojnë se janë pjesë e një tërësie më të madhe, e cila inkurajon solidaritetin, besimin e ndërsjellë dhe përgjegjësinë ndaj komunitetit.

SHOQËRIA NË LËVIZJE – Ç'NDODH DHE PSE?

Shoqëritë ndryshojnë vazhdimisht nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm si: teknologjia, ekonomia, politika dhe kultura. Për shembull, automatizimi dhe robotika në fabrika zëvendësojnë pjesë të detyrave të punës njerëzore, që do të thotë se disa punëtorë mund të mbeten të papunë. Por, nga ana tjetër krijohen profesione të reja që kërkojnë aftësi teknike. Për këtë qëllim sistemi arsimor, përmes programeve mësimore moderne, duhet t'i përgatisë të rinjtë për këtë. Ndryshimet ekonomike, siç janë krizat ose migrimi për shkak të papunësisë, mund të kenë ndikim negativ në familje dhe struktura demografike, por në të njëjtën kohë hapin mundësi për vende të reja pune dhe zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomikë. Vendimet politike (për shembull, vendimi për të futur arsimin e mesëm të detyrueshëm), ndryshojnë kushtet e jetesës së të rinjve dhe familjeve, duke i mundësuar ata të fitojnë aftësi të reja dhe kushte më të mira për të ardhmen. Reforma të tilla përmirësojnë arsimin dhe forcojnë komunitetet. Ndikimet kulturore, siç janë filmat dhe mediat sociale, shpesh janë shkak i ndryshimeve në stilin e veshjes, shijet muzikore dhe mënyrën e të menduarit të të rinjtë, por mund të jenë edhe shkak i humbjes së vlerave tradicionale.

Kjo do të thotë se shoqëritë ndikohen vazhdimisht nga teknologjia, ekonomia, politika dhe kultura, të cilat shkaktojnë ndryshime që mund të jenë në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të saj, por edhe të jenë plot me sfida të paparashikuara. Prandaj shoqëritë duhet të rishqyrtojnë vazhdimisht ndryshimet dhe sfidat dhe të krijojnë ekuilibër midis formave të vjetra dhe të reja të jetës.

Ç'ËSHTË DUKURIA SHOQËRORE DHE Ç'ËSHTË PROCESI SHOQËROR?

Studimi sociologjik i funksionimit dhe ndryshimit të shoqërisë fillon me përgjigjen e dy pyetjeve kryesore: ç'është dukuria shoqërore dhe ç'është procesi shoqëror?

Dukuritë shoqërore janë ngjarje ose kushte specifike në jetën e përditshme. Ato janë të dukshme, ndikojnë te njerëzit dhe ne mund t'i vërejmë lehtësisht. Ndër dukuritë më të rëndësishme sociale të njohura në jetën e përditshme janë:

- institucionet shoqërore (familja, ekonomia, shteti, politika, kultura, arsimi, papunësia, varfëria, etj.);



Shoqëria moderne është si lëngjet – nuk mund të mbajë një formë konstante, është vazhdimisht në ndryshim (Zygmunt Bauman)

- normat dhe rregullat shoqërore (morale, ligjore, fetare, tradicionale, etj.);
- pozicionet dhe rolet shoqërore (nxënës, prind, mjek, polic, mik, etj.).

Nga një perspektivë sociologjike, **dukuritë shoqërore** janë të gjitha ngjarjet ose veprimet që përfshijnë marrëdhënie midis njerëzve, përsëriten, ndikojnë në një numër më të madh njerëzish dhe kanë rëndësi shoqërore. Ajo që kanë të përbashkët të gjitha dukuritë është se **ato ndodhin në komunitet, përsëriten, zgjasin për një kohë të gjatë dhe ndikojnë në sjelljen e njerëzve**. Për sociologjinë dhe sociologët gjëja më e rëndësishme është që ato të mund të studiohen shkencërisht.

Proceset shoqërore, nga ana tjetër na tregojnë se si dukuritë ndryshojnë gradualisht me kalimin e kohës dhe si ndryshon shoqëria përmes tyre. Për shembull, papunësia si dukuri shoqërore mund të monitorohet për një kohë të gjatë për të parë se a rritet apo zvogëlohet. Proceset shoqërore më të rëndësishme janë:



Të mësuarit është proces

- socializimi (proces përmes të cilit njerëzit mësojnë të jetojnë në shoqëri);
- modernizimi (futje graduale e teknologjive dhe mënyrave të reja të punës);
- globalizimi (proces i lidhjes së vendeve të ndryshme përmes tregtisë, komunikimit dhe kulturës);
- urbanizimi (proces i modernizimit të mënyrës së jetesës nga rurale në urbane);
- ndryshimet kulturore (ide, vlera ose trende të reja që ndikojnë te njerëzit);
- zhvillim ekonomik (ndryshime në ekonomi që krijojnë vende pune dhe industri të reja).

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni historinë për Anën dhe më pas identifikoni dukuritë dhe proceset shoqërore të përmendura në të. Mbështetni përgjigjet tuaja me shembuj nga teksti.

Ana dhe familja e saj u zhvendosën së fundmi nga një qytet i vogël në Shkup. Zhvendosja ndodhi për shkak të papunësisë së babait të saj, i cili nuk kishte mundur të gjente punë në qytetin e tij të lindjes për një kohë të gjatë. Kjo zhvendosje nënkuptonte ndryshim të madh për të gjithë familjen, e veçanërisht për Anën. Në shkollën e re Ana duhej të njihej përsëri me shoqe dhe shokë të rinj të klasës,

të mësonte rregulla dhe zakone të reja dhe të socializohet. Edhe pse u përpoq të krijonte komunikim të mirë, dialekti dhe mënyra e veshjes së saj bënë që disa nxënës ta tallnin. Pas njëfarë kohe Ana u bë viktimë e dhunës nga bashkëmoshatarët. Ajo shpesh merrte komente fyese dhe përjashtohej nga aktivitetet në grup. Disa nxënës e trajtonin ndryshe vetëm sepse ishte nxënëse e re, gjë që ishte një formë diskriminimi. Me mbështetjen e sociologes së shkollës Ana filloi gradualisht të integrohej dhe të përshtatej me kushtet e reja, të fitonte vetëbesim dhe të ndërtonte marrëdhënie më të mira me shokët e klasës.



MBANI MEND

Koncepti shoqëri është krijim sociologjik. Ai filloi të përdoret me zhvillimin e sociologjisë si shkencë. Me ndihmën e tij realiteti shoqëror filloi të shpjegohet në mënyrë të re, pozitive ose shkencore. Kur jeni në gjendje të dalloni midis një dukurie shoqërore dhe një procesi shoqëror, e kuptoni më mirë shoqërinë. Përmes dukurive ju vini re se diçka ndodh, ndërsa proceset ju tregojnë se si këto dukuri zhvillohen dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Shoqëria ndryshon sepse dukuritë ndryshojnë – vlerat, ekonomia, kultura, shkenca dhe teknologjia – por edhe për shkak të ndryshimeve në lidhjet, marrëdhëniet dhe veprimet e njerëzve. Kjo njohuri është e dobishme sepse na ndihmon të kuptojmë problemet me të cilat përballemi, të përshtatemi më lehtë me ndryshimet dhe të marrim pjesë më me përgjegjësi në jetën shoqërore.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Shpjegoni ndryshimin midis dukurisë shoqërore dhe procesit shoqëror. Jepni një shembull për secilin!
2. Shpjegoni një dukuri (situatë) që keni hasur dhe cilat procese shoqëroreshin me të.
3. Mendoni pse ndryshon shoqëria. Cilët faktorë në histori ndikuan në ndryshimet në jetën e Anës?
4. Shpjegoni me një shembull specifik pse njerëzit duhet të dinë dukuritë dhe proceset në shoqëri. Cili është përfitimi i tyre në jetën e përditshme?

Detyrë shtëpie: Hulumtoni një dukuri shoqërore që keni vërejtur në shkollë, në shtëpi ose në rrugë. Shpjegoni shkaqet dhe pasojat. Shikoni nëse ajo dukuri është zhvilluar në faza dhe cilët njerëz ose institucione kanë ndikuar në fazat.

2. SHOQËRITË NËPËR KOHË

„Shoqëritë rriten dhe ndryshojnë kur njerëzit ndryshojnë vetëdijen dhe veprimet e tyre.” – Lev N. Tolstoi

PSE ËSHTË E NEVOJSHME TË DIMË SE SI NDRYSHOJNË DHE ZHVILLOHEN SHOQËRITË ME KALIMIN E KOHËS?

Duke shqyrtuar shoqëritë me kalimin e kohës ne në fakt mësojmë se si komunitetet e vogla fisnore të gjuetarëve dhe fermerëve evoluuan në shoqëri moderne kombëtare. Ne kuptojmë se njerëzit, duke ndryshuar mënyrën e tyre të jetesës, punës, të menduarit dhe të vepruarit, ndryshojnë edhe shoqëritë.

Kujtohuni! Cilët sociologë besonin se zhvillimi i shoqërisë varet nga ndryshimet në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit?


Historia e njerëzimit tregon se mënyra e prodhimit material midis njerëzve ka ndryshuar. Ndryshimet u përcaktuan kryesisht nga dy faktorë kryesorë. I pari është faktori tekniko-teknologjik. Ai përfshin forcën punëtore (njohuritë dhe aftësitë), mjetet e punës (teknologjinë) dhe objektet e punës (tokë, minerale, ujë, energji, etj.). I dyti është faktori shoqëror. Ai përfshin marrëdhëniet që vendosen midis njerëzve në mënyrë që ata të mund të prodhojnë dhe shkëmbejnë. Elementi më i rëndësishëm i marrëdhënieve të prodhimit është lloji i pronësisë mbi forcat prodhuese.

KLASIFIKIMI I SHOQËRIVE SIPAS ZHVILLIMIT TEKNIK DHE TEKNOLOGJIK

Bazuar në karakteristikat teknike dhe teknologjike të mënyrës së prodhimit, shoqëritë mund të jenë: **shoqëri gjuetie dhe grumbullimi, agrare, industriale dhe postindustriale.**

1. Shoqëritë e gjuetisë dhe grumbullimit ishin forma mbizotëruese e organizimit deri në shfaqjen e Neolitit (Epoka e Gurit të Ri). Në këto shoqëri jeta e njerëzve varej nga natyra dhe zhvillohej në grupe të vogla (fise) në të cilat njerëzit ishin të lidhur përmes lidhjeve farefisnore. Ata ishin nomadë, sepse shpesh ndryshonin vendet e tyre të banimit në kërkim të ushqimit. Ata merreshin me gjueti, peshkim dhe mbledhje frutash. Ndarja e punës ishte e thjeshtë, nuk kishte produkte të tepërta dhe nuk kishte pronë private ose klasa. Vendimet merreshin kolektivisht. Nuk kishte shtet ose qeveri. Këtë rol e luanin anëtarët më të vjetër, më të respektuar dhe më me përvojë të komunitetit. Socializimi kryhej nëpërmjet familjes dhe grupit, nëpërmjet imitimit, nëpërmjet transmetimit gojor të njohurive dhe traditës. Komuniteti mbahej nëpërmjet besimeve, ritualeve dhe zakoneve. **Mënyra e jetesës ishte e njëjtë për shekuj me radhë dhe për këtë arsye shoqëritë ndryshuan ngadalë.**

2. Shoqëritë bujqësore (agrarë) dominuan deri në ardhjen e industrisë. Në to bujqësia ishte aktiviteti kryesor ekonomik dhe për këtë arsye jeta e njerëzve varej kryesisht nga kultivimi i tokës dhe kushtet natyrore. Të gjithë anëtarët e shoqërisë merrnin pjesë në prodhim. Ata prodhonin kryesisht për përdorimin e tyre. Deri atëherë toka ishte pasuria më e rëndësishme dhe ishte pronë e përbashkët (kolektive) e fisit ose bashkësisë së fshatit. Tani në këto shoqëri toka është në pronësi të një numri të vogël njerëzish (zotërinjve), ndërsa shumica e popullsisë janë fshatarë që punojnë në tokën e zotërinjve. Me zhvillimin e prodhimit dhe shfaqjen e një teprice ushqimi, fillon të shfaqet pronësia private e tokës, bagëti, veglave dhe shtëpive. Familja luan një rol qendror. Shpesh disa breza jetojnë së bashku dhe rolet ndahen sipas gjinisë dhe moshës. Pushteti politik mbahet nga ata që zotërojnë tokën. Feja dhe tradita kanë rëndësi të madhe dhe një ndikim të fortë në sjelljen e njerëzve. **Shoqëritë bujqësore janë të qëndrueshme, tradicionale dhe, ashtu si shoqëritë e gjuetisë, ndryshojnë ngadalë.**



Shoqëri bujqësore në të kaluarën

3. Shoqëritë industriale karakterizohen nga prodhimi i makinerive në fabrika dhe industria masive, e cila është arsyeja për krijimin e strukturave të reja shoqërore. Familja dhe komunitetet lokale nuk janë më bartëse të aktivitetit ekonomik, por dalin dy klasa kundërshtare: borgjezia, e cila zotëron kapitalin, dhe klasa punëtore, e cila shet punën. Këto dallime klasore, siç thekson Marks, janë forca lëvizëse e ndryshimeve shoqërore. Shoqëritë industriale janë të urbanizuara, racionale dhe promovojnë njohuritë shkencore dhe teknike. Në to ndikimi i fesë është më i vogël. Familjet janë bërthamore (prindërit dhe fëmijët). Njerëzit fitojnë status dhe role përmes profesioneve, jo përmes origjinës. Në këto shoqëri shteti modern, demokracia dhe të drejtat civile janë në zhvillim. Ekzistojnë institucione shtetërore që organizojnë jetën politike dhe shoqërore, por ka edhe pabarazi të mëdha shoqërore.



Industrializim i shoqërisë

Shoqëritë industriale janë shoqëri të ndryshimeve dhe përparimit të shpejtë. Inovacionet teknologjike, zbulimet shkencore dhe zhvillimi ekonomik ndryshojnë vazhdimisht mënyrën e prodhimit dhe të jetës.

4. Shoqëritë post-industriale (informative) janë faza më e zhvilluar e shoqërive moderne. Ato lindën si rezultat i ndryshimeve të thella shkencore dhe teknologjike, ekonomike dhe kulturore. Ndryshe nga shoqëritë industriale që bazohen në prodhimin në fabrika, shoqëritë e informacionit ekzistojnë nëpërmjet krijimit, përpunimit dhe kontrollit të informacionit dhe njohurive. Për to informacioni është burim kyç shoqëror (pasuri), ndërsa teknologjitë digjitale formësojnë realitetin e përditshëm të individit dhe shoqërisë. Struktura ekonomike e këtyre shoqërive shpjegohet më së miri në studimet e sociologut Daniel Bel. Ai beson se „boshti qendror

i shoqërisë post-industriale është njohuria teorike“, e jo puna fizike ose lëndët e para. Prodhimi industrial zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga shërbimet, kërkimi, arsimi dhe teknologjitë e informacionit. Dituria bëhet burimi kryesor i pushtetit, ndërsa ekspertët dhe teknokratët (inxhinierë, shkencëtarë kompjuterësh dhe specialistë të IT-së, shkencëtarë, hulumtues, menaxherë, etj.), nëpërmjet kontrollit të njohurive fitojnë rol udhëheqës në shoqëri. Në këtë mënyrë sipas Bell, krijohen forma të reja të pabarazisë midis atyre që kanë shumë njohuri dhe atyre që janë më pak të informuar dhe kanë nivel më të ulët arsimimi.

Shoqëritë e informacionit karakterizohen nga dinamizëm, fleksibilitet dhe paqëndrueshmëri e lartë. Ato quhen edhe „shoqëri rreziku“ sepse e ardhmja e njerëzve është e pasigurt dhe e paparashikueshme. Asgjë nuk konsiderohet e përhershme dhe plotësisht e vërtetë. Dituria, rregullat dhe informacioni ndryshojnë vazhdimisht. Kjo konfirmohet nga analiza e sociologut Entoni Gidens, i cili e përshkruan modernitetin si gjendje „ndryshimi të vazhdueshëm dhe reflektiviteti“. Sipas tij, tradita që dikur u jepte njerëzve drejtime të qarta jetësore në këto shoqëri humbet fuqinë e saj dhe njerëzit detyrohen të ndërtojnë identitetin e tyre (të vendosin se ç’do të jenë, ku do të punojnë, cilat vlera do të respektojnë). Komunikimi midis njerëzve zhvillohet përmes rrjeteve virtuale, ndërsa ato krijojnë identitete digjitale që i çorientojnë gjithnjë e më shumë dhe rrisin ndjenjën e tyre të tjetërsimit.



Shoqëri moderne e informacionit (digjital)

KLASIFIKIMI I SHOQËRIVE SIPAS FORMIMIT TË TYRE SHOQËRORO-EKONOMIK

Formimi shoqëroro-ekonomik është koncept bazë i përdorur për të shpjeguar teorinë sociologjike të ndryshimit shoqëror. Ai rrjedh nga Teoria e shoqërisë e Marksit. Ky koncept lidh ndryshimet në forcat prodhuese me ndryshimet në marrëdhëniet e prodhimit, por edhe në të gjithë strukturën e shoqërisë. Koncepti i formimit shoqëroro-ekonomik bazohet në supozimin se ekonomia (mënyra e prodhimit dhe veçanërisht lloji i pronësisë së mjeteve të prodhimit) është baza e shoqërisë. Mbi atë bazë ndodhet e ashtuquajtura **superstrukturë e shoqërisë** (politika, ligji, feja dhe kultura).



Shoqëri primitive

Marksit ishte i pari që klasifikoi llojet historike të shoqërive sipas formacioneve të tyre shoqëroro-ekonomike. Ai dallon pesë lloje të formacioneve: **shoqëria primitive, shoqëria skllavopronare, shoqëria feudale, shoqëria kapitaliste dhe shoqëria komuniste.** Secila prej tyre (me përjashtim të së parës) lind, zhvillohet

dhe zhduket përmes luftës së klasave. Sipas mësimit të tij, zhvillimi shoqëror nuk është i rastësishëm, por zhvillohet përmes pesë formacioneve të përshkruara më sipër. Çdo formacion karakterizohet nga:

- forcat prodhuese (metoda e prodhimit, makinat, mjetet, teknologjia, puna) dhe
- marrëdhëniet e prodhimit (kush zotëron mjetet e prodhimit, kush punon dhe kush menaxhon).

Në shoqërinë primitive nuk ka pronë private dhe ndarje klasash. Me zhvillimin e prodhimit dhe shfaqjen e produkteve të tepërta dhe pronës private, shfaqet shoqëria skllavopronare. Në këtë formacion shoqëro-ekonomik konflikti themelor shoqëror është midis skllavopronarëve dhe skllavëve. Pastaj vjen feudalizmi, i shënuar nga marrëdhënia midis feudalëve dhe bujkrobërve. Kapitalizmi bazohet në pronësinë private të mjeteve të prodhimit nga njëra anë, dhe pronësinë private të punës (punës) nga ana tjetër. Pronarët e mjeteve të punës (borgjezia) shfrytëzojnë punën e punëtorëve.

Në çdo formacion shoqëro-ekonomik lindin kontradikta të brendshme, të cilat më shpesh shprehen përmes luftës së klasave. Prandaj Marksit thekson se „historia e të gjitha shoqërive ekzistuese deri më tani është historia e luftërave të klasave“.

SI ZËVENDËSOHET, SIPAS MARKSIT, NJË FORMACION NGA NJË TJETËR?


Kur marrëdhëniet e prodhimit (shfrytëzuesit – të shfrytëzuarit) bëhen pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese, ndodhin ndryshime dhe revolucione të thella shoqërore. Në këtë mënyrë një formacion zëvendësohet nga një tjetër. Sipas Marksit, ky proces çon në komunizëm. Në komunizëm pronësia private e mjeteve të prodhimit hiqet dhe krijohen kushtet për jetë pa shfrytëzim dhe ndarje klasash. Formacioni komunist në konceptin e tij është shoqëri pa klasa dhe pa shtet, me barazi të plotë dhe prodhim sipas nevojave të secilit individ. Nga një perspektivë sociologjike, këto formacione shoqëro-ekonomike nuk janë vetëm kategori historike, por edhe instrumente sociologjike



Shoqëri feudale



Shoqëri kapitaliste



Piramidë e sistemit kapitalist

përmes të cilave mund të kuptohet se si ekonomia (prodhimi) formëson jetën dhe kulturën e njerëzve dhe cilat janë shkaqet e ndryshimeve dhe konflikteve shoqërore në epoka të ndryshme historike.

KLASIFIKIMI I SHOQËRIVE SIPAS TIPAREVE KULTURORE (SHOQËRITË TRADICIONALE, MODERNE DHE POSTMODERNE)

Dy klasifikimet e shoqërive të shpjeguara më sipër janë klasifikimet më të përdorura në sociologji. Megjithatë, ekziston një klasifikim tjetër i shoqërive, i bërë sipas specifikave të kulturave dhe modeleve kulturore të sjelljes së njerëzve. Sipas këtij klasifikimi, shoqëritë ndahen në **shoqëri tradicionale, moderne** dhe **postmoderne**.

Shoqëritë tradicionale ekzistojnë në të kaluarën, por mund të gjenden ende në disa pjesë të botës sot. Në to zakonet, tradita dhe feja luajnë rolin më të rëndësishëm. Respekti për të rriturit, ndarje e rreptë e roleve mashkullore dhe femërore, respekti për rregullat fetare dhe martesat e rregulluara janë vetëm disa nga karakteristikat e këtyre shoqërive. Në shoqëri të tilla gjëja më e rëndësishme ishte ruajtja e traditës dhe rendit, ndërsa ndryshimet ndodhën ngadalë dhe me kujdes.

Shoqëritë bashkëkohore u zhvilluan me revolucionin industrial. Në vend të bujqësisë, fabrikat, industria dhe zhvillimi i qyteteve morën rolin kryesor. Njerëzit filluan të lëviznin masivisht nga fshatrat në qytete. Shkenca, teknologjia dhe arsimi u zhvilluan në shoqërinë moderne. U shfaqën vende të reja pune dhe njerëzit kishin më shumë zgjedhje. Ligjet dhe shteti u bënë shumë të rëndësishëm, ndërsa tradita kishte më pak ndikim se më parë.



Shoqëri moderne

Shoqëritë postmoderne janë shoqëritë bashkëkohore në të cilat jeton shumica e popullsisë sot. Vlerat kryesore në to konsiderohen të jenë njohuria, teknologjia dhe liria e zgjedhjes. Këto shoqëri karakterizohen nga teknologjia e zhvilluar e informacionit, globalizimi dhe dominimi i medias dhe kulturës së konsumatorit. Si rezultat, identitetet e njerëzve bëhen fleksibël dhe ndryshimet shoqërore janë të shpejta dhe të vazhdueshme.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni shembullin, pastaj përgjigjuni pyetjeve.

„Në një shoqëri shumica e popullsisë punon në fabrika, njerëzit lëvizin masivisht në qytete dhe prodhimi i makinerive është dominues“.

– Për çfarë lloj shoqërie bëhet fjalë?

– Tregoni dy karakteristika që e identifikojnë atë.

AKTIVITETI 2. Hulumtoni rolin e traditës në shoqërinë tradicionale dhe çfarë roli luan në shoqërinë moderne dhe bashkëkohore. Tregoni shembuj.

AKTIVITETI 3. Lidhni fenomenin shoqëror me llojin e duhur të shoqërisë:

a) dominimi i fesë;

b) prodhimi masiv i fabrikave;

c) kontrolli i dijes.

**MBANI MEND**

Është e rëndësishme të dimë se si janë zhvilluar dhe ndryshuar shoqëritë me kalimin e kohës sepse në këtë mënyrë mund ta kuptojmë më mirë të tashmen në të cilën jetojmë. Historia e shoqërive na tregon se si u krijuan vlera, institucione dhe mënyra të caktuara të jetës, ndërsa tregon se cilat gabime duhet të shmangim. Duke vepruar kështu mësojmë se ndryshimet shoqërore nuk janë aksidentale, por janë rezultat i veprimtimit njerëzor. Kjo na ndihmon ta ndërtojmë të ardhmen më me ndërgjegje.

**KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA**

Hulumtoni se cili fenomen shoqëror u lejon njerëzve të komunikojnë, të mësojnë, të punojnë dhe të marrin informacion në distancë çdo ditë. Shpjegoni se për cilën shoqëri është karakteristikë ky fenomen dhe përshkruani se si është jeta e njerëzve.

3. SI TË ARRIHEN NDRYSHIMET SHOQËRORE?

„Filozofët vetëm sa e kanë shpjeguar botën, por çështja është ta ndryshojmë atë.“ – Karl Marks

Në të kaluarën njerëzit lëviznin kryesisht me kuaj ose në këmbë, ndërsa udhëtimi ishte i ngadaltë dhe i kufizuar. Me ardhjen e makinave dhe transportit publik, ndodhën ndryshime të mëdha. Falë tyre, sot njerëzit mund të udhëtojnë më shpejt nëpër botë, të njihen me kultura të reja, të arsimohen, të jetojnë në një vend dhe të punojnë në tjetër vend, të tregtojnë dhe të lëvizin më shpesh. Ky shembull tregon se **ndryshimet teknologjike përmirësojnë rehatinë dhe cilësinë e jetës së përditshme, krijojnë mundësi të reja dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore**. Kalimi nga leximi i librave në biblioteka në internet dhe burime elektronike gjithashtu është një ndryshim për të mirë, sepse njerëzit mund të marrin informacion më shpejt, të mësojnë shkathtësi të reja, të komunikojnë me njerëz nga pjesë të ndryshme të botës, ndërsa mësimi dhe puna mund të jenë më efikase. Me zhvillimin e mjekësisë dhe zbulimin e vaksinave vdekshmëria nga sëmundjet infektive është ulur, shëndeti është përmirësuar dhe jetëgjatësia e njerëzve është rritur.

Ky është ndryshim pozitiv që u lejon njerëzve të kenë jetë më të mirë dhe më aktive. Lufta afatgjatë për të drejtat e njeriut ka mundësuar ndryshimin politik, pra krijimin e një shoqërie demokratike, karakteristikat kryesore të së cilës janë respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut (e drejta e votës, liria e fjalës, barazia para ligjit). Këto dhe shumë shembuj të tjerë tregojnë se ndryshimet në shoqëri nuk janë vetëm teknike, por përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e njerëzve dhe krijojnë mundësi të reja.

Çdo ndryshim ose përshtatje në jetë, punë dhe marrëdhënie midis njerëzve quhet ndryshim shoqëror. Ndryshimet arrihen në disa mënyra:

- 1. nëpërmjet zhvillimit teknologjik** me zbatimin e teknologjive të reja (kompjuterë dhe internet), ndryshohen mënyrat e punës, prodhimit dhe stilit të jetesës;
- 2. nëpërmjet lëvizjeve dhe luftërave shoqërore**, për shembull, nëpërmjet luftës për të drejtat e njeriut, njerëzit kanë mbrojtur dinjitetin e tyre dhe kanë përmirësuar cilësinë e jetës;
- 3. nëpërmjet reformave ligjore dhe ndryshimeve institucionale**, futja e të cilave ndryshon organizimin e shoqërisë. Për shembull, me miratimin e Ligjit për Arsimin Fillor të Detyrueshëm, rritet shkrim-leximi, krijohen mundësi të barabarta dhe zhvillohet e gjithë shoqëria;
- 4. nëpërmjet faktorëve natyrorë ose ekonomikë**, siç janë krizat, fatkeqësitë ose ndryshimet ekonomike, të cilat i detyrojnë njerëzit të përshtaten me kushtet e reja.

A JANË NDRYSHIMET GJITHMONË POZITIVE?

Ndryshimet shoqërore sjellin ndryshime, por ato nuk janë gjithmonë pozitive. Ndryshimet ndonjëherë shkaktojnë



Ndryshimet ndikojnë në të gjitha brezat

pasoja të këqija, veçanërisht në fillim. Për shembull, telefonat celularë dhe interneti e bëjnë komunikimin dhe të mësuarit më të lehtë. Megjithatë, nëse përdoren shumë shpesh, ato mund të çojnë në varësi, më pak socializim dhe probleme me përqendrimin. Hapja e fabrikave të reja krijon vende të reja pune, gjë që zvogëlon papunësinë. Megjithatë, ky ndryshim mund të shkaktojë ndotje të ajrit dhe ujit, gjë që ka një efekt të keq në shëndetin e njerëzve.

Kur ndodhin ndryshime të shpejta në shoqëri, disa njerëz përshtaten më lehtë, por të tjerët mund të ndihen të pasigurt dhe të hutuar. Kur mësimdhënia në shkolla filloi të kryhej në internet dhe përdoren platformat digjitale, disa nxënës e gjetën shpejt rrugën e tyre sepse kompjuterët dhe interneti ishin të njohur për ta. Megjithatë, nxënës të tjerë ndiheshin të pasigurt dhe të hutuar, për shkak të njohurive të pamjaftueshme teknike ose mungesës së një kompjuteri në shtëpi. Kjo është dëshmi se ndryshimet e shpejta nuk i prekin të gjithë në të njëjtën mënyrë dhe se disa njerëz kanë nevojë për më shumë kohë dhe mbështetje për t'u përshtatur. Është e rëndësishme të planifikohen dhe të vlerësohen ndryshimet në mënyrë që ato të sjellin më shumë përfitime sesa dëm. Ndryshimet duhet të kuptohen si pjesë e jetës dhe të pranohen me përgjegjësi.

NDRYSHIMET PËRMES REVOLUCIONIT DHE EVOLUCIONIT

Revolucionet shpesh shkaktojnë ndryshime të shpejta dhe të thella në shoqëri, sepse mënyra e vjetër e qeverisjes shembet në periudhë të shkurtër kohore dhe një e re futet shpejt. Për shembull, falë Revolucionit të Tetorit, qeveria e vjetër, ligjet dhe marrëdhëniet shoqërore ndryshuan papritur, gjë që shkaktoi edhe ndryshime në mënyrën e jetesës, rregullat, normat dhe vlerat. Për shkak të këtyre ndryshimeve njerëzve u duhej kohë për t'u përshtatur. Është gabim të kuptohet se vetëm rregullimet shoqërore ndryshojnë përmes revolucionit. Në jetën e përditshme moderne ka shumë shembuj të ndryshimeve të shpejta, pothuajse revolucionare. Për shembull, sot makinat elektrike dhe autobusët vetë-drejtues futen në shumë qytete. Ky është ndryshim i shpejtë në transport: njerëzit duhet të mësojnë se si të përdorin automjete të reja, të përshtaten me rregullat e reja dhe një infrastrukturë të re rrugore. Teknologjia revolucionarizon trafikun, por gjithashtu krijon pasiguri dhe sfida të reja për shoferët dhe këmbësorët. Një shembull tjetër është puna nga shtëpia. Ka ndryshuar shumë jetën e përditshme të njerëzve. Shumë kompani e kanë futur këtë mënyrë pune në periudhë shumë të shkurtër kohore, veçanërisht gjatë pandemisë Kovid. Për disa, ky ndryshim përfaqëson një mundësi për fleksibilitet në punë, ndërsa për të tjerët përjetohet si izolim dhe tjetërsim.

Ndryshe nga një revolucion që shkakton ndryshim të shpejtë, **evolucioni** është ndryshim i ngadaltë dhe gradual. Ai ndodh hap pas hapi, përmes përmirësimeve dhe rregullimeve të vogla që nuk shkaktojnë konfuzion dhe stres të njerëzit sepse ata kanë më shumë kohë për t'u mësuar me ndryshimin. Ja disa shembuj:

Kur në arsim futen programe mësimore të reja, tekste shkollore digjitale ose metoda të reja vlerësimi, kjo zakonisht bëhet gradualisht. Nxënësit dhe mësimdhënësit fillimisht njihen me ndryshimet, trajnohen dhe ngadalë fillojnë t'i zbatojnë ato. Kjo zvogëlon stresin dhe konfuzionin, i bën ndryshimet më të lehta për t'u pranuar dhe përmirëson rezultatet. Prandaj ndryshimet graduale kanë më pak pasoja negative dhe u lejojnë njerëzve të ndihen më të sigurt dhe të mbrojtur.

Një shembull i mirë i ndryshimit evolucionar janë përpjekjet e grave për të fituar njohje për të drejtat e grave. Në të kaluarën gratë kishin pak të drejta. Me kalimin e kohës përmes arsimit, lëvizjeve shoqërore

dhe reformave ligjore, të drejtat e grave u zgjeruan gradualisht. Së pari ato fituan të drejtën për arsim, pastaj të drejtën për të punuar dhe më vonë të drejtën për të votuar dhe barazinë para ligjit. Ndryshimet u futën hap pas hapi, evolucionare. Telefonat gjithashtu u zhvilluan gradualisht: fillimisht kishte vetëm linja fikse, pastaj telefona celulare, ndërsa sot kemi telefona inteligjentë. Ndryshimet graduale duken të vogla, por përfitimet janë shumë të mëdha. Këta shembuj çojnë në përfundimin se evolucioni sjell ndryshime të qëndrueshme dhe afatgjata.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni tekstin dhe më pas përgjigjuni pyetjeve.

Ndryshime të shpejta në jetën e përditshme

Prezantimi i pagesave të reja digjitale nëpërmjet aplikacioneve mobile shkakton probleme. Njerëzit që janë mësuar të paguajnë me para në dorë do të duhet të përshtaten.

1. Për çfarë lloj ndryshimi flet teksti?
2. Si ndikon ky ndryshim te njerëzit?
3. Cilët njerëz do ta pranonin më lehtë ndryshimin dhe për kë do të shkaktonte vështirësi?
4. A janë gjithmonë të mira ndryshime të tilla? Pse po, pse jo?



MBANI MEND

Ndryshimet janë të rëndësishme si për shoqërinë ashtu edhe për njerëzit. Ato janë shenjë se shoqëria dhe njerëzit zhvillohen. Ato na ndihmojnë të përshtatemi me kushtet e reja, të fitojmë aftësi të reja, të përmirësojmë jetën tonë dhe të krijojmë mundësi më të mira për të ardhmen. Megjithatë, ndryshimet nuk janë të nevojshme me çdo kusht. Disa ndryshime mund të sjellin edhe probleme, siç janë pasiguria, stresi ose vështirësitë ekonomike. Prandaj është e rëndësishme të planifikoni ndryshimet me kujdes, të mendoni për pasojat e tyre të mundshme dhe t'i prezantoni ato gradualisht. Në këtë mënyrë njerëzit do të jenë në gjendje t'i pranojnë ato dhe t'u përshtaten atyre më lehtë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'janë ndryshimet shoqërore?
2. Në cilat fusha shoqërore mund të ndodhin ndryshimet? Tregoni të paktën tre ndryshime.
3. Si ndodhin ndryshimet shoqërore? Cilët faktorë mund t'i shkaktojnë ato?
4. Tregoni disa shembuj të ndryshimeve shoqërore nga jeta e përditshme dhe shpjegoni arsyet e ndodhjes së tyre!
5. Shpjegoni ndryshimin në shpejtësinë me të cilën ndodhin ndryshimet shoqërore. Tregoni shembuj!

4. KULTURA SI MËNYRË JETESE

„Kultura nuk është vetëm dituri ose art, por mënyrë jetese që formon karakterin dhe shpirtin e njerëzve.” – Herman Hese

Ç’ËSHTË SHOQËRIA, E Ç’ËSHTË KULTURA?

Edhe pse termat **kulturë** dhe **shoqëri** përdoren shpesh si sinonime dhe janë të lidhura ngushtë, ato **nuk kanë të njëjtin kuptim**. Shoqëria i referohet njerëzve që jetojnë së bashku dhe mënyrës se si janë të organizuar ekonomikisht dhe politikisht, ndërsa kultura përshkruan mënyrën e jetës, vlerat dhe sjelljen e atyre njerëzve.

Për shembull, kur dikush thotë: „U habita se sa e disiplinuar është shoqëria japoneze”, ai në fakt i referohet kulturës japoneze, e cila karakterizohet nga disiplinë e madhe, respekt për të tjerët dhe përgjegjësi kolektive, ndërsa vihet re lehtësisht në jetën e përditshme të njerëzve.

E kur thuhet: „Në Japoni, kultura nuk toleron vonesën”, kjo do të thotë se shoqëria japoneze ka rregulla dhe norma të rrepta. Njerëzit janë mësuar të jenë të saktë, të respektojnë rregullat dhe rendin dhe të tregojnë përgjegjësi ndaj të tjerëve.

Pra, koncepti shoqëri na tregon se **cilët njerëz jetojnë së bashku** dhe si janë të organizuar ekonomikisht dhe politikisht. Kultura, nga ana tjetër është **mënyra e jetesës së atyre njerëzve**: cilat janë vlerat, zakonet, gjuha, traditat, besimet, arti dhe mënyrat e sjelljes së tyre. Prej saj mësojmë se si njerëzit jetojnë, punojnë, mendojnë, komunikojnë dhe festojnë, ç’është e rëndësishme për ta dhe çfarë nuk është. Nuk mund të ketë shoqëri pa kulturë, as kulturë pa shoqëri, sepse vetëm njerëzit kanë nevojë për të, e krijojnë atë dhe e transmetojnë atë nga brezi në brez.

KULTURA – KONCEPTI DHE KUPTIMI

Fjala kulturë vjen nga fjalët latine colere dhe cultus, që do të thotë **kujdes, kultivim** ose **përsosje**. Kuptimi i saj origjinal ishte „kultivimi i tokës“, ndërsa më vonë mori kuptimin „kultivim, kujdes i shpirtërores“.

Shumë sociologë e kanë studiuar kulturën. Kjo është arsyeja pse ka kaq shumë përkufizime. Ja disa përkufizime për krahasim:

1. „Kultura është tërësia komplekse që përfshin njohuritë, besimin, artin, moralin, ligjin, zakonet dhe çdo aftësi dhe zakon tjetër të fituar nga njeriu si anëtar i shoqërisë.” – Edvard Tajlor
2. „Kultura përfshin vlerat, normat dhe rregullat e përbashkëta që udhëheqin sjelljen e njerëzve brenda shoqërisë.” – Emil Dyrkem

3. „Kultura është pjesa e realitetit së cilës njerëzit i japin kuptim.” – Maks Veber
4. „Kultura është mediumi përmes të cilit vlerat, njohuritë dhe mënyrat e sjelljes transmetohen brenda shoqërisë.” – Pier Burdje
5. „Kultura përbëhet nga vlerat e përbashkëta nga anëtarët e një shoqërie, normat që ata ndjekin dhe të mirat materiale që ata prodhojnë.” – Entoni Gidens

Pavarësisht dallimeve në përkufizimin dhe interpretimin e konceptit kulturë, të gjithë këta sociologë bien dakord se:

1. **kultura është fenomen shoqëror:** është diçka që krijohet dhe ndahet në shoqëri, e jo tipar personal i individit;
2. **ajo përbëhet nga elemente të përbashkëta:** vlera, rregulla, norma dhe zakone që udhëheqin sjelljen e njerëzve;
3. **nuk është e lindur, por mësohet dhe transmetohet:** kultura mësohet përmes **familjes, arsimit dhe institucioneve të tjera shoqërore** dhe kalohet nga brezi në brez;
4. **i jep kuptim jetës:** kjo është veçanërisht e dukshme në përkufizimet e Veberit dhe Gidensit (për ta, kultura është **sistem kuptimesh** përmes të cilave njerëzit i japin kuptim realitetit dhe veprimeve të tyre);
5. **ajo formëson sjelljen:** kultura **ndikon në të menduarit, veprimet dhe mënyrën se si komunikojnë njerëzit.**

Për këto arsye një përkufizim i zakonshëm me të cilin shumica e sociologëve do të pajtoheshin do të ishte: **Kultura është sistem i përbashkët vlerash, normash dhe kuptimesh që mësohen dhe formësojnë jetën dhe sjelljen e njerëzve në shoqëri.**

ELEMENTET E KULTURËS

Nëse pajtohemi me përkufizimin e mësipërm të kulturës, atëherë mund të konkludojmë gjithashtu se elementi i kulturës mund të konsiderohet gjithçka që formëson mënyrën e jetesës dhe sjelljes së njerëzve në shoqëri. Kjo do të thotë se lista e elementeve kulturore është shumë e gjatë. Përveç **vlerave, normave, zakoneve, gjuhës, fesë dhe artit**, elemente të kulturës mund të konsiderohen edhe sa vijon:

- **të mirat teknologjike dhe materiale** (mjete, makina, kompjuterë, telefona, makina, veshje, strehim, etj.);
- **simbolet dhe shenjat** – gjithçka që ka kuptim për njerëzit (flamuj, logo të klubeve sportive, simbole kombëtare, simbole pikturë (emotikona), simbole të punuara me dorë, etj.);
- **mitet, historitë dhe legjendat** – histori që përcjellin mençurinë, besimet dhe historinë e një komuniteti (përralla popullore, rrëfenja heroike, legjenda lokale, etj.);
- **arsimi dhe të nxëniti** – mënyra se si kultura transmetohet nga brezi në brez (në shkollë, nga mjeshtrit e vjetër, shkollat artizanale, etj.).


- **mënyrat e sjelljes** – mënyrat e pritura dhe të pranuara të sjelljes në jetën e përditshme (përshëndetja me shtrëngim duarsh ose përkulje, pritja në radhë, mënyra e veshjes, etj.).

Me fjalë të tjera, **kultura formëson të gjithë mënyrën e jetesës së njerëzve**. Çdo gjë që njerëzit kanë mësuar dhe krijuar mund të konsiderohet si element i kulturës. Megjithatë, elementet më domethënëse konsiderohen të jenë: vlerat, normat dhe rregullat, zakonet dhe tradita, gjuha, besimet, simbolet, arti dhe kujtesa kulturore.


Vlerat janë bindjet e përbashkëta të njerëzve për atë që është e mirë, e rëndësishme dhe e dëshirueshme. Ato janë një lloj pike referimi shoqërore. Ato konsiderohen një element i rëndësishëm i kulturës sepse vendimet tona varen prej tyre. Ato na ndihmojnë të vendosim se ç'është e drejtë dhe e gabuar dhe kanë ndikim në sjelljen tonë. Pa to njerëzit do ta kishin të vështirë të binin dakord se si të jetonin së bashku. Për shembull, nëse ndershmëria nuk konsiderohet një vlerë në shoqëri, atëherë njerëzit nuk do t'i rrisin fëmijët e tyre të jenë të ndershëm. Kjo do të thotë se nëse dikush humbet diçka, askush nuk do të përpiqet ta kthejë atë, sepse nuk ka besim se prona e dikujt tjetër nuk duhet të merret pa kërkuar lejen e pronarit. Kjo situatë do të ishte e ngjashme me anominë e Dyrkemit, kur vlerat dhe normat mungojnë ose janë të dobëta, ndërsa njerëzit nuk dinë si të sillen.

Normat janë mënyra të pritura dhe të pranuara të sjelljes në shoqëri. Ato na tregojnë se si duhet (ose nuk duhet) të sillemi në situata të ndryshme, bazuar në vlerat e një kulture që e kemi adoptuar si tonën. Ato mund të jenë të drejta (ligje) dhe morale (të pashkuara), por të gjithë i dinë dhe i ndjekin ato. Për shembull, Qyteti i Sigurt është normë ligjore (e rregulluar me ligj) me qëllim krijimin e sigurisë në trafik. Nga ana tjetër normë morale është të përshëndetësh fqinjin tënd, t'ia lësh vendin tënd në autobus një personi më të moshuar, etj.

Pse janë të rëndësishme normat? Normat e bëjnë sjelljen e njerëzve ndaj njerëzve të tjerë të parashikueshme dhe të rregullt. Kështu, të gjithë e dinë se çfarë pritët prej tyre. Nëse nuk do të kishte norma, njerëzit do të silleshin në shumë mënyra të ndryshme, gjë që mund të shkaktonte konflikte dhe kaos.



Zakonet, sipas sociologut Entoni Gidens, janë aktivitete dhe mënyra sjelljeje që nuk janë vetëm zakone, por edhe praktika shoqërore – sjellje që njerëzit i zbatojnë vazhdimisht dhe që janë pjesë e mënyrës së tyre të jetesës. **Me përsëritje të rregullt, ato formësojnë kulturën**. Për shembull, kur njerëzit qëndrojnë në radhë për të paguar në arkë ose për të hyrë në autobus, ata përsërisin praktikën e përditshme që të gjithë i bëjnë në të njëjtën ose të ngjashme. Këto praktika ndihmojnë në ruajtjen e rendit, sepse të gjithë dinë si të sillen në të



Telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknologjike janë pjesë e kulturës materiale



Kostumet dhe vallet tradicionale popullore janë pjesë e kulturës jomateriale

njëjtën situatë. E njëjta gjë vlen edhe për përshëndetjet, vaktet familjare, pirjen e kafesë së mëngjesit, etj. Çdo ditë ne përshëndesim njëri-tjetrin me përshëndetje, ditë të mbarë ose duke shtrënguar duart, sepse kjo është gjëja e duhur për të bërë. Familja praktikon të hajë së bashku për të ruajtur marrëdhëniet familjare. Pirja e kafesë së mëngjesit është zakon që tregon një mënyrë jetese, etj.

Gjuha është një nga elementet më të rëndësishme të kulturës. Nuk është vetëm mjeti kryesor i komunikimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis njerëzve, por është edhe pasqyrë e mënyrës se si komunitet mendon, ndjen dhe e kupton botën. Përmes gjuhës ne mësojmë gjërat më të rëndësishme rreth shoqërisë sonë – vlerat, zakonet, tregimet dhe historinë që transmetohen nga më të vjetrit te më të rinjtë. Kur njerëzit flasin të njëjtën gjuhë, ata lidhen më lehtë, shkëmbejnë ide dhe ndihen pjesë e komunitetit. Nëse gjuha e një populli zhduket, një përqindje e madhe e njohurive kulturore dhe veçantisë së atij populli humbet, sepse gjuha është mënyra se si ruhen dhe transmetohen zakonet, vlerat dhe traditat nëpër breza.

Besimet dhe feja janë elemente të rëndësishme të kulturës sepse ato ndikojnë në mënyrën se si njerëzit mendojnë, vlerat, sjelljen dhe identitetin e njerëzve në shoqëri. Në çfarë mënyrash e bëjnë këtë?

1. Feja ofron një sistem vlerash dhe normash morale (ç'është e mirë dhe ç'është e keqe, ç'lejohet dhe ç'është e ndaluar), të cilat transmetohen nga brezi në brez. Për shembull, në Islam dhe Krishterim ekzistojnë norma morale që ndalojnë gënjeshtren, vjedhjen, shkaktimin e padrejtësisë, vendosin detyrimin për të respektuar prindërit, për të ndihmuar të varfrit, etj. Këto vlera nuk janë vetëm rregulla fetare, por transmetohen brez pas brezi dhe bëhen pjesë e traditës kulturore.
2. Besimet fetare shprehen përmes **zakoneve, festave, ritualeve, simboleve, artit dhe arkitekturës**. Ato janë tipare kulturore të njohura të një shoqërie. Për shembull, Krishtlindjet, Pashkët, Bajrami i Ramazanit dhe Kurban Bajrami janë festa fetare, por në të njëjtën kohë tipare të forta kulturore. Ato shprehin besime, por me zakonet, simbolet, ritualet, artin dhe arkitekturën që lidhen me to, ato janë pjesë e kulturës. Festimi i këtyre festave është pjesë e kulturës së të gjithë shoqërisë në të cilën ato festohen.

Simbolet janë shenja, objekte, imazhe ose shprehje që i ndihmojnë njerëzit të kuptojnë njëri-tjetrin më lehtë sepse kanë të njëjtin kuptim për të gjithë. Ato nuk e përcjellin mesazhin drejtpërdrejt. Por përmes një kuptimi të dakorduar. Prandaj simbolet nuk janë vetëm shenja vizuale, ato janë bartës të ideve, vlerave dhe ndjenjave. Përmes tyre njerëzit **komunikojnë, shprehin identitetin e tyre dhe transmetojnë tradita kulturore**. Gjuha, flamujt, simbolet fetare, ngjyrat dhe gjestet janë simbole kulturore. Për shembull, **flamuri i Maqedonisë**, me diellin në mes, simbolizon **identitetin, pavarësinë dhe unitetin**. Është shenjë që lidh qytetarët dhe përfaqëson shtetin me të tjerët.



Simbolet si pjesë e çdo kulture

Kujtesa kulturore është koleksion njohurish, kujtimesh, ngjarjesh dhe simbolesh që një shoqëri e transmeton nga brezi në brez. Përmes saj njerëzit ndihen pjesë e së njëjtës histori dhe komunitet. Për shembull, përgatitja e sarmës, pitës ose gjomlezës sipas recetave tradicionale të gjysheve dhe stërgjysheve tona është pjesë e kujtesës kulturore. Përmes saj njohuritë për gatimin, shijet dhe zakonet lokale transmetohen nga brezi në brez, duke ruajtur kështu traditën kulturore.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Simbolet luajnë një rol të madh në komunikimin elektronik. Kur komunikojmë nëpërmjet mesazheve ose mediave sociale, shpesh përdorim shenja. Zbuloni se cilat janë këto shenja dhe shpjegoni pse i përdorim ato. Cili është kuptimi i tyre në komunikim?

AKTIVITETI 2. Hulumtoni kuptimin simbolik të ngjyrave dhe shpjegoni se si i interpretojnë njerëzit ato dhe nga çfarë varet kjo. Nga se varet se çfarë kuptimi simbolik do të kenë ngjyra e kuqe, e verdhë ose blu?

AKTIVITETI 3. Shpjegoni simbolikën e stemës dhe flamurit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AKTIVITETI 4. Hulumtoni se cilës pjesë të kulturës i përket festa e 11 Tetorit – Dita e Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Cili është qëllimi i festës?



MBANI MEND

Çdokush duhet ta njohë kulturën e tij sepse i ndihmon të kuptojnë se kush është dhe ku i përket. Duke njohur kulturën e vet dhe elementet e saj, do të jeni në gjendje të ndërtoni identitetin tuaj personal dhe kombëtar. Do t'ju mësojë të respektoni traditat dhe vlerat tuaja, të zhvilloni tolerancë dhe respekt për kulturat e tjera, të kuptoni lidhjen midis të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Pse është e rëndësishme kultura për jetën e njerëzve dhe shoqërinë?
2. Tregoni elementet bazë të kulturës dhe shpjegoni ato!
3. Shpjegoni ndryshimin midis termave shoqëri dhe kulturë!
4. Si ndikon kultura në sjelljen dhe stilin tonë të jetesës së përditshme? Jepni shembuj.
5. Krahasoni kulturën të cilës i përkisni me një kulturë tjetër dhe identifikoni ndryshimet, ndërsa pastaj komentoni mbi to!

5. NDARJA E KULTURËS

KULTURA DHE QYTETËRIMI – DY ANËT E SË NJËJTËS SHOQËRI

Kultura dhe qytetërimi janë koncepte të lidhura ngushtë, por nuk duhen barazuar. Koncepti qytetërim përdoret kur duam të shpjegojmë se sa e zhvilluar është një shoqëri dhe si është e organizuar (infrastruktura, ndërtesat, niveli i zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, mënyra se si funksionojnë institucionet). Koncepti kulturë shpjegon mënyrën se si jetojnë njerëzit, cilat vlera respektojnë, si mendojnë dhe si sillen (gjuha, traditat, zakonet, besimet, etj.). Ja një shembull (i një vendi fiktiv) nga i cili mund të shihni ndryshimin midis këtyre dy koncepteve:

Teknolandi është vend modern, shumë i zhvilluar me qytete moderne, rrugë të mirëmbajtura mirë, ura, ndërtesa të larta, transport publik efikas, shkolla të pajisura në mënyrë moderne, spitale, me sistem arsimor të zhvilluar dhe teknologji më të fundit. Ligjet janë të qarta dhe institucionet funksionojnë pa probleme të mëdha. E gjithë kjo tregon se Teknolandi është një shoqëri me një shkallë të lartë zhvillimi shkencor dhe teknologjik, domethënë shoqëri shumë e civilizuar. Megjithatë, kultura në jetën e përditshme të qytetarëve nuk është gjithmonë në të njëjtin nivel. Në Teknoland mund të vërehen situata në të cilat njerëzit nuk respektojnë normat themelore kulturore dhe morale: ata hedhin letra në rrugë, pështynë, nuk respektojnë rendin e hyrjes në kinema, hedhin bishta cigaresh kudo, fyejnë njëri-tjetrin... Edhe pse ka rregulla të qarta sjelljeje, mjedisi nuk reagon dhe e konsideron një sjellje të tillë normale. Pra, Teknolandi është shoqëri e civilizuar, por kultura në të është në nivel të ulët.

SI NDAHEN KULTURAT?

Kultura është koncept kompleks që përfshin të gjitha vlerat materiale dhe shpirtërore të krijuara nga njeriu në shoqëri. Meqenëse kultura shfaqet në forma të ndryshme, ajo ndahet sipas kriterëve të caktuar.

Një nga kriteret themelore për ndarjen e kulturave është **përmbajtja e kulturës**. Sipas këtij kriteri, bëjmë dallimin midis **kulturës materiale dhe shpirtërore**. Ne mund ta shohim dhe prekim kulturën materiale. Ajo përfshin të gjitha krijimet materiale të njeriut (mjetet, veshjet, bizhuteritë, shtëpitë, teknologjinë). Ne nuk mund ta prekim kulturën shpirtërore, por mund ta ndiejmë dhe ta mësojmë atë përmes edukimit, gjuhës, zakoneve, besimeve, muzikës, këngëve, historive etj. (vlera të paprekshme).

Një tjetër kriter i rëndësishëm për ndarjen e kulturave është se **kush e krijon atë dhe për kë është menduar**. Sipas këtij kriteri, kultura ndahet në **kulturë popullore (tradicionale), elitare dhe masive**. Kultura popullore krijohet nga populli dhe transmetohet brez pas brezi, më shpesh gojariht. Kjo kulturë ruan kujtesën kolektive dhe identitetin e popullit. Ajo pasqyron jetën e përditshme, zakonet dhe traditat e njerëzve të zakonshëm, është e përhapur dhe e arritshme për të gjithë. Ajo shprehet përmes këngëve, valleve, historive, zakoneve, veshjeve tradicionale etj. **Kultura elitare** është vepër e individëve të arsimuar dhe përfshin vepra arti të vlefshme dhe arritje intelektuale. Prandaj jo të gjithë mund ta kuptojnë dhe vlerësojnë atë. Ajo

njihet në letërsinë dhe muzikën klasike, pikturën, teatrin etj. Për shembull, kompozitori maqedonas Todor Skallovski është pjesë e kulturës elitare. Kompozimet e tij të muzikës klasike janë krijuar me cilësi të lartë artistike dhe intelektuale dhe ndikojnë në zhvillimin e kulturës muzikore në Maqedoni. **Kultura masive**, nga ana tjetër është e destinuar për një audiencë të gjerë dhe më shpesh transmetohet përmes medias. Është lehtësisht e kuptueshme dhe e arritshme për të gjithë. Qëllimi i saj është të argëtojë, informojë dhe të krijojë një ndjenjë komuniteti përmes internetit, televizionit, filmave, muzikës dhe videolojërave. Është e rëndësishme që të rinjtë janë përdorues aktivë të kësaj kulture përmes kanaleve në YouTube ose platformave të transmetimit. Shembulli më i mirë i kulturës masive janë librat dhe filmat e Hari Poterit. Ato lexohen dhe shikohen nga fëmijë, adoleshentë ose të rritur që nga vitet 1990 deri në ditët e sotme. Ato janë të pranishme në media, modë, meme dhe në gjuhën e përditshme. Ato janë produkte kulturore që zgjasin shumë dhe pranohen nga grupmoshat e ndryshme. E njëjta gjë vlen edhe për muzikën e Majkël Xheksonit, lojën për fëmijë dhe të rritur Super Mario, etj.

Kultura mund të ndahet edhe **sipas nivelit të kompleksitetit dhe zhvillimit**. Në këtë kontekst mund të flasim për **kulturën e lartë dhe kulturën popullore**. **Kultura e lartë** i referohet veprave të artit komplekse dhe të vlefshme si: muzika e Bethovenit, romanet e Dostojevskit, arti i Leonardo da Vinçit. Kultura popullore, nga ana tjetër është lehtësisht e arritshme dhe e destinuar për argëtim dhe përdorim të përditshëm. E tillë është, për shembull, muzika e këngëtares Tajlor Swift, sepse ndiqet nga miliona njerëz në të gjithë botën, muzika e saj dëgjohet në radio, Spotify, TikTok dhe YouTube, ajo ka fansa të të gjitha grupmoshave që i njohin këngët dhe tekstet, ndikon në modë, gjuhë dhe media sociale. Koncertet janë ngjarje të mëdha me një audiencë prej mijëra njerëzish. Lojërat konsiderohen gjithashtu kulturë popullore: Minecraft, Fortnite, trendet e TikTikut, memet, markat e modës Nike Adidas, reality show, etj.

Kultura gjithashtu ndryshon **sipas vendit në të cilin ekziston dhe bartësve të saj** (grupi shoqëror ose komuniteti). Në këtë kuptim kultura mund të jetë: **kombëtare, rajonale, nënkulturë, kundërkulturë**. **Kultura kombëtare** është karakteristikë e një populli, ajo rajonale shoqërohet me një hapësirë të caktuar, ndërsa **nënkultura dhe kundërkultura** i referohen grupeve më të vogla me vlerat dhe mënyrat e tyre specifike të sjelljes. Kultura kombëtare zakonisht është multikulturore, gjë që është edhe rasti me kulturën në Maqedoni. Ajo është e mbushur me trashëgimi të pasur historike dhe kulturore, folklor, zakone dhe art me multikulturalizëm të theksuar (ndërtesa të ndryshme fetare, festime, kuzhina dhe zakone, manifestime, etj.). Kulturat e Ohrit, Mijake dhe kultura e shqiptarëve në Maqedoninë Perëndimore (e njohur nga këngët dhe vallet shqipe të interpretuara me një instrument me dy tela – çifteli) janë shembuj të kulturave rajonale.

Nënkultura është kultura e një grupi brenda një shoqërie që ka vlerat, stilin, interesat dhe simbolet e veta, të ndryshme nga kultura dominuese. Nënkultura konsiderohet të jetë kultura e mjekëve, policisë, programuesve, gazetarëve, disa zanateve, etj. Të gjitha këto grupe janë nënkultura sepse kanë identitet kolektiv. Ata janë të bashkuar nga vlera dhe norma të përbashkëta (etika profesionale), mënyrë komunikimi (ata përdorin gjuhë profesionale – zhargon), simbole (ata veshin uniforma, përdorin mjete), mënyrë të veçantë të menduarit dhe ndjenjë përkatësie në grup. Për shembull, oficerët e policisë kanë të njëjtën uniformë, të njëjtin kod sjelljeje dhe respektojnë të njëjtën hierarki. Programuesit përdorin gjuhë teknike

dhe kanë kulturë digjitale dhe mënyrë specifike pune. Mjekët punojnë sipas betimit të Hipokratit, veshin bluza të bardha, stetoskop, punojnë në spitale, përdorin konceptinologji mjekësore dhe kujdesen për shëndetin e njerëzve. Ata ndihen si anëtarë të një komuniteti mjekësor.

Kultura rinore është nënkulturë e të rinjve. Ajo karakterizohet nga ndjekja e stileve të veshjeve dhe modës, dëshira për muzikë dhe argëtim, përdorimi i një gjuhe dhe zhargon të veçantë, kultura digjitale, rebelimi, kreativiteti, dinamizmi, dëshira për vetëshprehje dhe pranim i lehtë i ideve të reja dhe ndryshimeve shoqërore. Mjeshttrat e filigranit, argjendarisë ose muraturës, për shembull, kanë nënkulturë specifike, ndërsa nganjëherë një gjuhë specifike dhe sekrete (zhargon). Do të mësoni më shumë rreth kësaj kulture në mësim të mëvonshëm.

Kontrakultura (kundërkultura) është kur një grup njerëzish (më shpesh të rinj) janë të pakënaqur me vlerat, normat dhe rregullat e ofruara nga kultura dominuese (ajo që shumica e njerëzve e kanë pranuar). Prandaj ata e kundërshtojnë atë dhe më pas grupi krijon një kundërkulturë. Qëllimi i saj është të krijojë një sistem të ri vlerash. Më shpesh, kundërkultura krijohet nga të rinjtë kur shoqëria „nuk i dëgjon“, „nuk i kupton“ ose nuk u ofron atyre mundësi të drejta. Arsyet më të zakonshme për pakënaqësinë e tyre janë: padrejtësia sociale, papunësia, pamundësia për të përparuar, keqkuptimet brez pas brezi, sistemi arsimor i vjetëruar, mosbesimi ndaj qeverisë, ndjenja se mendimi i tyre nuk respektohet, kriza identiteti, etj. Duke krijuar kundërkulturë të rinjtë shprehin revoltë dhe kërkojnë ndryshim. Kundërkultura mund të jetë shkatërruese për shoqërinë, sepse minon normat ekzistuese shoqërore, promovon mosbindjen, dhunën dhe krijon përçarje dhe konflikte. Megjithatë, ajo mund të jetë edhe konstruktive nëse tregon ekzistencën e problemeve serioze në shoqëri.



Protestë për shkak të neglizhencës ndaj natyrës

Sipas periudhës kohore në të cilën ekziston, kultura ndahet në **tradicionale dhe bashkëkohore**. **Kultura tradicionale** është e lidhur me të kaluarën, traditën dhe trashëgiminë kulturore. Për shembull, kultura japoneze njihet nga kimonot e saj tradicionale dhe aranzhimet me lule – ikebana; kultura italiane nga arti i Rilindjes së Mikelangjelos; kultura afrikane nga maskat dhe gdhendjet e saj në dru rituale dhe kulti, etj. **Kultura bashkëkohore** pasqyron të tashmen dhe mënyrën bashkëkohore të jetesës. Ajo përdor media dhe teknologji të reja si: kubizmi në veprat e Pikasos, arti i rrugës i shprehur përmes grafitëve, instalimeve video, shfaqjeve, etj.

Kultura mund të jetë e dukshme dhe e fshehur. Kur është **e dukshme (eksplicite)**, ajo njihet lehtësisht në rregulla, ligje, programe edukative, letërsi ose vepra arti dhe mësohet lehtësisht. **Kultura e fshehur (implicite)** mësohet përmes praktikave të zakonshme të jetës së përditshme. Për shembull, ne nuk mësojmë nga ligjet dhe dokumentet e tjera se si të përshëndesim, respektojmë dhe mendojmë, por e bëjmë këtë nga prindërit dhe të rriturit, nga mësimdhënësit ose nga njerëz të tjerë përmes vëzhgimit, imitimit dhe përsëritjes së zakoneve të tyre tashmë të fituara.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)**AKTIVITETI 1.** „Nënkultura si pjesë e identitetit tim”

Hulumtoni nënkulturën së cilës i përkisni (ose nënkulturën e njerëzve që njihni).

Përshkruani dhe shpjegoni:

1. Pse e konsideroni veten anëtar të kësaj nënkulture?
2. Cilat vlera dhe qëndrime janë më të rëndësishme për anëtarët e kësaj nënkulture?
3. Si njihet kjo nënkulturë (veshja, pamja, simbolet, gjuha)?
4. Çfarë roli luan muzika, arti ose interneti në këtë nënkulturë?
5. Ku dhe si komunikoni dhe lidheni me njëri-tjetrin (personalisht ose elektronikisht)?
6. Si e percepton shoqëria në Republikën e Maqedonisë së Veriut këtë nënkulturë? A ka paragjykimet/stereotipe?
8. Si ndikon kjo nënkulturë në identitetin tuaj personal dhe jetën e përditshme?
9. Ç’ju pëlqen më shumë te nënkultura dhe ç’do të dëshironit të ndryshonte?
10. A mund të bëhet kjo nënkulturë në kundërkulturë? Shpjegoni si!

**MBANI MEND**

Njohja e llojeve të ndryshme të kulturave dhe nënkulturave na ndihmon të kuptojmë më mirë veten dhe të tjerët. Kultura në të cilën rritemi dhe së cilës i përkasim ndikon fuqishëm në vlerat, qëndrimet, sjelljen dhe ndjenjën tonë të përkatesisë. Është pjesë e rëndësishme e krijimit të identitetit personal të secilit person. Kur i kuptojmë ndryshimet kulturore, zhvillojmë tolerancë, respekt dhe empati më të madhe. Kjo kontribuon në komunikim më të mirë dhe marrëdhënie më njerëzore në shoqëri.

**KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA**

1. Ç’është kultura dhe ç’është qytetërimi? Shpjegoni ndryshimin.
2. Cilat janë llojet themelore të kulturës?
3. Jepni nga një shembull të kulturës materiale dhe jomateriale.
4. Shpjegoni përmes shembujve se ç’është kultura elitare, popullore dhe e popullarizuar?
5. Si ndikon teknologjia moderne në zhvillimin dhe përhapjen e kulturës?
6. Pse është e rëndësishme të respektohen ndryshimet në kultura?
7. Cilat karakteristika i ka kultura rinore së cilës ju i takoni? Me çfarë dallohet?

6. IDENTITETI KULTUROR

„Kultura formëson sjelljen tonë më shumë sesa jemi të vetëdijshëm.”

– Margaret Mid

Ç'ËSHTË IDENTITETI KULTUROR DHE SI KRIJOHET AI?

Karakteristika kryesore e anëtarëve të së njëjtës kulturë është se ata ndajnë **identitet të përbashkët kulturor**, respektivisht mënyra të ngjashme të të menduarit, sjelljes dhe jetesës. Ky identitet ndërtohet gradualisht, përmes ndarjes së njohurive dhe përvojave, përmes gjuhës të përbashkët që mundëson komunikimin dhe transmetimin e traditës, përmes zakoneve të ngjashme (festime të përbashkëta, festa, rituale), vlerave dhe normave të përbashkëta, kujtesës kolektive, etj. E gjithë kjo u lejon atyre të njohin njëri-tjetrin, të ndiejnë ndjenjë përkatësie ndaj komunitetit, por edhe të dallohen nga anëtarët e kulturave të tjera.

Sipas sociologut bashkëkohor britanik Stujart Hol, „identiteti nuk është diçka me të cilën lindim, por diçka që krijohet dhe ndryshohet vazhdimisht”. Kjo do të thotë se identiteti kulturor nuk është i fiksuar, por ndërtohet gjatë gjithë jetës përmes familjes, miqve, kulturës, medias dhe zgjedhjeve personale.

Identiteti kulturor është ndjenja që secili prej nesh e ka për kulturën/kulturat që i përkasin, si mendojmë, shprehemi, sillemi dhe si e njohim veten si pjesë të një komuniteti.

SI KRIJOHET IDENTITETI PERSONAL?

Familja është faktor i rëndësishëm nga i cili varet identiteti që do të ndërtojmë, sepse vlerat e para kulturore i mësojmë në shtëpi, në familje. Mësojmë gjuhën që flasim, zakonet, festat dhe mënyrën e sjelljes. Për shembull, nëse një prind vazhdimisht i thotë një fëmije se nuk është mjaftueshëm i mirë dhe se duhet të jetë si të tjerët; se nuk ka një shije të zhvilluar për muzikën, artin dhe stilin e veshjes; nëse e tall mendimin e tij ose e ndëshkon, me kalimin e kohës fëmija do të fillojë të dyshojë në vetvete dhe në aftësitë e tij. Ata do të fillojnë të fshehin interesat dhe ndjenjat e tyre dhe të ndërtojnë identitetin e tyre nga frika e gjykit, në vend që të zgjedhin vetë vlerat. Ata do të ndërtojnë identitet të bazuar në pritjet e të tjerëve dhe do të humbasin „veten“ e tyre. Shkolla dhe bashkëmoshatarët gjithashtu kanë ndikim të madh në formimin e identitetit. Një nxënës që është i ndryshëm nga të tjerët, për shembull: vishet ndryshe, dëgjon muzikë të ndryshme ose flet një dialekt, mund të tallet, të refuzohet ose të përjashtohet nga shoqëria. Nëse mësimdhënësit, në vend që t'i mbrojnë, i kritikojnë për ndryshimin, nxënësi mund të zhvillojë pasiguri dhe konfuzion rreth asaj se kush janë dhe ku i përkasin.



identiteti/et

Mediat, feja dhe mjedisi gjithashtu ndikojnë në formimin e identitetit tonë, por prapëseprapë gjëja më e rëndësishme nga të gjitha është përvoja dhe zgjedhja jonë personale, sepse ne vendosim vetë se cilat vlera, qëndrime dhe mënyra jetese do të pranojmë dhe cilat jo. Kështu, identiteti është kombinim i ndikimeve të jashtme dhe lirisë personale. Identiteti personal ndryshon vazhdimisht për secilin prej nesh për shumë arsye: përvoja e fituar që ndryshon qëndrimet tona, sfidat me të cilat përballemi, sukseset, dështimet, arsimi, punësimi, marrëdhëniet e dashurisë, humbja e të dashurve, etj. Me fjalë të tjera, identiteti ynë personal ndryshon sepse secili prej nesh mëson, përmirësohet dhe përshtatet me rrethanat e reja të jetës.

Identiteti gjinor është shqisa e brendshme e një personi, por edhe ndikimet shoqërore dhe rrethanat kulturore në të cilat formohet vetëdija e tyre personale si burrë ose grua, si asnjëri ose të dy, pavarësisht nga gjinia biologjike e caktuar në lindje.

Në shoqërinë moderne rolet gjinore nuk ndahen dhe nuk merren përsipër vetëm sepse dikush lind biologjikisht si burrë ose grua. Më parë ishte kështu sepse njerëzit kujdeseshin për mendimet e të tjerëve, domethënë ata ndikoheshin nga kuptimet dhe përfaqësimet kolektive të gjërave. Identiteti gjinor nuk është thjesht një çështje zgjedhjeje personale edhe sot. Rrethanat dhe ndikimet shoqërore dhe kulturore ende luajnë një rol të rëndësishëm në këtë. Megjithatë, në kushtet ku mbizotëron individualizmi dhe e drejta për zgjedhje personale, si karakteristikat kryesore të shoqërisë moderne, zgjedhjet personale kanë përparësi. Për shembull, një baba mund të gatujë dhe të kujdeset për fëmijët, ndërsa një nënë mund të punojë si shofer autobusi ose mekanik makinash. Kjo do të thotë se identiteti gjinor është personal dhe subjektiv, jo i imponuar. Ai bëhet i mundur nga një mjedis shoqëror tolerant. Përmes ndarjes së punës, shoqëria u ofron njerëzve role dhe norma të caktuara gjinore, të cilat ata mund t'i pranojnë, përshtatin ose refuzojnë, varësisht nga mënyra se si e perceptojnë veten. Përveç kësaj, përvoja e vetes është e kushtëzuar shoqërisht. Prandaj identiteti gjinor është kombinim i ndjenjave personale dhe kontekstit shoqëror në të cilin jeton personi.

Identiteti etnik bazohet në ndjenjën e individit të përkatësisë në grup të caktuar bazuar në idenë e **origjinës, gjuhës, kulturës, traditës dhe historisë së përbashkët**. Ky identitet na tregon nga vimë dhe me cilin grup njerëzish jemi të lidhur. Identiteti etnik shpesh transmetohet përmes familjes, por edhe përmes zakoneve, festave dhe gjuhës së përdorur në jetën e përditshme. Identiteti i ndryshëm etnik nuk do të thotë se dikush është më i mirë ose më i keq, por që njerëzit kanë origjinë të ndryshme dhe kulturë të ndryshme, gjë që e bën shoqërinë multikulturore, e për këtë arsye më të pasur nga ana kulturore.

Identiteti që secili prej nesh e ndërton bazuar në vendin dhe rolet që marrim gjatë gjithë jetës sonë quhet **identitet social**. Tregon se ç'bën secili prej nesh, çfarë lloj reputacioni kemi, çfarë lloj marrëdhëniesh kemi me të tjerët, cilat janë hobet tona, etj. Për shembull, në periudhë të caktuar të jetës sonë secili prej nesh merr një rol familjar (djalë/bijë, vëlla/motër, baba/nënë) që pasqyron identitetin tonë familjar. Kur angazhohemi në procesin arsimor, fitojmë role të reja (nxënës, student), të cilat na japin një identitet arsimor, dhe fitojmë një identitet profesional kur marrim një punë (mësimdhënës, avokat, mekanik makinash, politikan, etj.). Në varësi të marrëdhënies sonë me të tjerët, mund të fitojmë rolin e një miku, shoku, fqinji, të dashuri, të dashure ose një identiteti të ri social. Identiteti fetar tregon besimin tonë,

identitetin politik – qëndrimet tona ndaj një ideologjie të caktuar politike, etj. Është e rëndësishme të theksohet se një person mund të ketë role të shumta në të njëjtën kohë, ndërsa ato mund të ndryshojnë gjatë gjithë jetës për arsye të ndryshme.

Nga e gjithë kjo mund të konkludojmë se identiteti është krijim kompleks që përgjigjet pyetjeve „kush jam unë?“ dhe „si lidhem me ata përreth meje?“.

NGJASHMËRITË KULTURORE, NDRYSHIMET KULTURORE DHE UNIVERSALET KULTURORE

Identiteti kulturor ndërtohet nëpërmjet dallimeve kulturore (ç’na bën të veçantë, të ndryshëm nga të tjerët), nëpërmjet asaj që kemi të përbashkët dhe na lidh me të tjerët (ngjashmëri kulturore) dhe nëpërmjet elementeve kulturore që janë të pranishme në të gjitha shoqëritë (universale kulturore).

Ngjashmëritë kulturore janë vlera, norma ose praktika të përbashkëta nga anëtarët e kulturave të ndryshme që ekzistojnë brenda një rajoni më të gjerë gjeografik ose konteksti historik. Për shembull, ajvari, sarma, qebapi etj. janë elemente kulturore që gjenden në shumë kultura të veçanta në Gadishullin Ballkanik dhe më gjerë. Është i ngjashëm me disa elemente artistike, argëtuese dhe të tjera kulturore. Në secilën prej kulturave të veçanta këta elemente më shpesh modifikohen, por në thelb janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Kjo është arsyeja pse ato quhen ngjashmëri kulturore. Ngjashmëria e tyre nuk është vetëm në materialin nga i cili përgatiten, por edhe në dimensionin e tyre shoqëror. Për shembull, përgatitja e ajverit është një lloj rituali shoqëror në të cilin merr pjesë familja, e më shpesh edhe fqinjët ose shokët. Secila prej këtyre ngjashmërive kulturore në mjedise specifike merr specifika lokale. Në këtë kuptim ne flasim edhe për dallimet kulturore.

Dallimet kulturore i referohen ndryshimeve në gjuhë, tradita, besime, vlera dhe zakone të përditshme të njerëzve në shoqëri të ndryshme. Për shembull, grupe të ndryshme etnike, popuj dhe kombe flasin gjuhë të ndryshme, kanë vlera, norma, zakone të ndryshme dhe përdorin simbole të ndryshme, por këto janë elemente pa të cilat nuk mund të ekzistojë asnjë kulturë. Përmes dallimeve kulturore njerëzit e njohin kulturën e tyre, forcojnë ndjenjën e përkatësisë ndaj komunitetit të tyre dhe ndërtojnë identitetin e tyre personal dhe grupor. Sot shpesh ndodh komercializimi dhe përvetësimi i disa elementeve kulturore të pranishme në kultura të shumta. Entet private ose publike „patentojnë“ disa ngjashmëri kulturore si të tyret. Ndonjëherë ato dështojnë ta bëjnë këtë. I tillë ishte rasti me përpjekjen e kompanisë slovene „Kolinska“ për të patentuar emrin „Ajvar“ si markën e saj tregtare. Megjithatë, Zyra Gjermane e Patentave dhe Markave Tregtare vendosi që „ajvari“ është një lloj gatimi tradicional në disa vende dhe nuk mund të përvetësohet si markë private. Sot kjo fjalë përdoret dhe mund të patentohet vetëm me një origjinë specifike gjeografike. Për shembull, „ajvari maqedonas“ ose „ajvari i Leskovcit“, etj. Në këtë mënyrë respektohen si ngjashmëritë ashtu edhe specifikat, pra ndryshimet.



Dallimet kulturore janë pasuri

Kujtohuni në rolet e gjuhës, normave, zakoneve dhe vlerave si elemente të kulturës dhe pse janë ato të rëndësishme?


Universalet kulturore janë elemente të kulturës që i hasim në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kulturat pa përjashtim. Kjo është arsyeja pse ato quhen universale. Njerëzit i krijojnë ato si individë të bashkuar shoqërisht, e jo individualisht sepse janë absolutisht të nevojshme për të gjithë. Mbijetesa e tyre (ushqimi, kujdesi për riprodhimin, mirëmbajtja e specieve njerëzore, etj.) dhe organizimi i jetës shoqërore (sipas të cilave norma, rregulla dhe institucione do të organizojnë jetën) varen prej tyre.

Për shembull:

- të gjitha shoqëritë kanë mënyrë të caktuar për të siguruar burimet materiale të nevojshme për mirëmbajtjen e jetës (**ekonomi e caktuar**);
- të gjitha shoqëritë (pa përjashtim) kanë zgjidhje **për lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Martesa, familja, kujdesi për fëmijët dhe të rriturit** janë universale;
- të gjitha shoqëritë kanë mënyrë të caktuar komunikimi. Komunikimi, gjuha, etj. janë universale;
- të gjitha shoqëritë **u lejojnë** anëtarëve të tyre të bëjnë diçka dhe i ndalojnë ata të bëjnë diçka. **Rregullat dhe normat** janë universale;
- të gjitha shoqëritë ofrojnë zgjidhje për mënyrën **se si njerëzit mund të organizohen vetë.**

Pra, duhet të ketë një ndarje të roleve e të ngjashme.

Kjo do të thotë se në të gjitha shoqëritë njerëzit prodhojnë, martohen, komunikojnë, hanë dhe respektojnë normat morale, megjithëse kjo manifestohet në mënyra të ndryshme në kultura të ndryshme. Për shembull, diku martesa lidhet me zgjedhjen e partnerëve, ndërsa diku me marrëveshje midis familjeve; dieta në disa kultura bazohet në oriz dhe perime, në të tjera në mish ose ushqime deti, etj. Normat morale që konsiderohen të pranueshme në shoqëri mund të jenë rreptësisht të ndaluara në tjetër, etj.



Përshëndetje si pjesë e kulturave të ndryshme

Ç'NDODH KUR TAKOHEN KULTURA TË SHUMËFISHTA? (ENKULTURIMI, PËRSHTATJA, AKULTURIMI, ASIMILIMI)

Kur për çfarëdo arsye (turizëm, punë, studim, punësim, zhvendosje, tregti, miqësi, etj.), njerëzit vijnë në kontakt me kultura të ndryshme, ndodhin disa procese të rëndësishme kulturore. Së pari, në situata të caktuara mund të ndodhë një lloj shoku kulturor,

veçanërisht kur bien në kontakt me një kulturë që është shumë e ndryshme nga ajo në të cilën dikush është rritur dhe është formuar. Kjo është ndjenjë konfuzioni dhe stresi. Mund të lindë për shkak të mungesës së të kuptuarit të kulturës së re, d.m.th. normave, vlerave dhe rregullave të sjelljes së saj. Për shembull, kur takojmë dikë që ha me duar, në vend që të hajë me takëm, fillimisht shokohemi, por më vonë kuptojmë se ai është anëtar i kulturës indiane, në të cilën të hash me duar është mënyrë e pranuar përgjithësisht e të ngrënit.

Kjo ndodh sepse secili prej nesh njihet me kulturën tonë spontanisht që në moshë të re. Antropologët e quajnë këtë **enkulturim**. Ky është procesi kryesor dhe fillestar i të mësuarit të kulturës sonë. Përmes tij, ne mësojmë dhe përvetësojmë vlerat, normat, gjuhën, simbolet dhe modelet e sjelljes së kulturës sonë, e për këtë arsye na duket se është më e mira. Ky proces zgjat një jetë të tërë, por është më intensiv në fëmijëri dhe adoleshencë, sepse këto janë periudhat kur qëndrimet dhe vlerat e njerëzve formohen më intensivisht. Proces i enkulturimit zhvillohet në familje, shkollë, me shokët, përmes medias... Pasojat e enkulturimit mund të jenë pozitive dhe negative. Ato janë pozitive nëse individi ka përvetësuar vlerat e duhura, sillet mirë dhe ka arritur të integrohet në komunitet. Megjithatë, nëse ato janë negative (sillen në mënyrë diskriminuese ose të dhunshme), ato mund të shkaktojnë pasoja negative.

Procesi i enkulturizimit përcakton kryesisht qëndrimin tonë ndaj kulturave të tjera. Gjatë kontakteve të para dhe intensive me një kulturë tjetër, shpesh habitemi dhe ndonjëherë tronditemi nga ndryshimet kulturore, por gradualisht i pranojmë ato ose përshtatemi me ndryshimet. Ky është procesi i **adaptimit** kulturor – ne përshtatemi me kushtet e reja të jetesës. Ky proces ndodh më shpesh kur zhvendosemi, fillojmë një shkollë ose punë të re, si dhe kur biem në kontakt me rregulla, norma ose teknologji të reja shoqërore. Kur zhvendosemi në vend tjetër, duhet të përshtatemi me kulturën e re. Është pozitive që përmes adaptimit e kemi më të lehtë të gjejmë rrugën tonë dhe të integrohemi në shoqërinë e re, ndërsa një pasojë negative (më shpesh në periudhën fillestare) mund të jetë stresi dhe një ndjenjë pasigurie dhe presioni. Edhe pse adaptimi kërkon kohë dhe përpjekje, është proces i nevojshëm që na lejon të përshtatemi më lehtë dhe të vazhdojmë të jetojmë me sukses në kushtet e reja.

Me kalimin e kohës dhe me frekuencën e kontaktit me kultura të ndryshme, përshtatja shndërrohet në përvetësim më aktiv të vlerave, zakoneve dhe mënyrave të reja të jetesës. Ky proces quhet akulturim. Pasojat e këtij procesi mund të jenë pozitive dhe negative. Për shembull, kur njerëzit shpërngulen në vend tjetër për arsye ekonomike, ata detyrohen të mësojnë gjuhën dhe të pranojnë rregullat e shoqërisë së re. Kjo ka ndikim pozitiv në integrimin e tyre dhe u siguron atyre kushte më të mira jetese. Një pasojë negative mund të jetë ndjenja e humbjes së identitetit të tyre kulturor dhe vështirësitë midis të rinjve që rriten midis dy kulturave. Kur njerëzit largohen për arsim (studim, trajnim, etj.), ata përvetësojnë vlera, zakone dhe mënyra të reja të të menduarit, njohuri të zgjeruara dhe botëkuptim të ri. Akulturimi ndodh edhe nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm me median dhe internetin. Ato ofrojnë qasje të lehtë në kulturën globale,



Të njëjtë, por të ndryshëm

kreativitet dhe lidhje me botën, por ato kanë edhe pasoja negative, siç është neglizhenca e zakoneve dhe gjuhës tradicionale. Akulturimi është proces i pashmangshëm në botën moderne. Ai ndodh për arsye të ndryshme, ndërsa sjell si përfitime ashtu edhe sfida, prandaj është e rëndësishme të vazhdohet me respekt dhe ruajtje të identitetit të vet kulturor.

Asimilimi është procesi i humbjes së identitetit të vet dhe krijimit të një identiteti të ri kulturor. Për shembull, nëse zhvendoseni për të jetuar me familjen tuaj në një vend tjetër dhe pas një kohe harroni vlerat kulturore të vendit tuaj dhe pranoni plotësisht gjuhën, vlerat, zakonet dhe mënyrën e jetesës së kulturës së re, kjo do të thotë se keni kaluar nëpër një proces asimilimi. Sociologët më shpesh e përshkruajnë asimilimin në mënyrë metaforike. Krahasohet me një tenxhere shkrirjeje, në të cilën përzihen kultura të ndryshme, por më shpesh kultura dominuese ka ndikimin më të fortë. Në rastin e asimilimit individi hyn në „tenxhere“ me kulturën e tij por me kalimin e kohës kultura dominuese mbizotëron „shijen“ e tij dhe në fund mbetet vetëm shija dominuese. Pra, asimilimi është një lloj shkrirjeje, e cila më shpesh përjetohet si „humbje e rrënjëve“, krizë identiteti ose konflikt i brendshëm. Ky proces është më i theksuar te të moshuarit.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1: Lexoni dhe analizoni situatat e përshkruara më poshtë, e më pas përgjigjuni pyetjeve. Qëllimi i aktivitetit është të kontrolloni se a keni mësuar si formohet dhe ndryshon identiteti kulturor dhe cilat ndryshime shkaktohen nga kontaktet kulturore.

SITUATA 1. FamNjë familje nga Maqedonia shpërngulet në Japoni

Imagjinoni sikur familja juaj shpërngulet në Japoni. Ju të gjithë mësoni gjuhën japoneze, respektoni rregullat e rrepta të sjelljes, disiplinën në punë dhe kulturën japoneze të bazuar në kolektivizëm (bashkësi). Ju dhe vëllai/motra juaj mësoni në shkollë japoneze. Megjithatë, në shtëpi flisni gjuhën tuaj amtare, festoni festat familjare, dëgjoni muzikë popullore dhe përgatitni ushqim tradicional.

1. Cilat dallime kulturore janë më të dukshme dhe cili është ndikimi i tyre?
2. A kalon familja një shok kulturor?
3. A është ky një shembull i akulturimit, adaptimit apo asimilimit?
4. Cilat janë pasojat pozitive dhe negative të kontaktit të dy kulturave?
5. A do të integrohen fëmijët më shpejt se prindërit? Pse?

SITUATA 2. Nxënësi një nga Maqedonia shkon në shkëmbim në Arabinë Saudite

Studenti shkon në qëndrim studimor njëvjeçar në Arabinë Saudite, ku ai përballet me rregulla, norma, zakone dhe mënyra të ndryshme fetare të komunikimit.

Ai mëson arabisht, respekton mënyrën lokale të veshjes dhe sjelljes dhe përshtatet me kulturën akademike lokale. Ai ndihet më shumë si arab sesa si maqedonas.

1. Hulumtoni ndryshimet më të mëdha kulturore në këtë shembull dhe si ndikojnë ato te studenti!
2. A e bën më të vështirë ekzistenca e ndryshimeve të mëdha kulturore procesin e përshtatjes?
3. A përshtatet apo asimilohet studenti?
4. A ekziston mundësia e humbjes së identitetit kulturor?
5. A mund të lindë një konflikt midis vlerave personale dhe shoqërore?
6. Cilat janë pasojat pozitive dhe negative të një kontakti të tillë kulturor?



MBANI MEND

Identiteti kulturor nuk është diçka e pandryshueshme, por ndërtohet përmes familjes, arsimit, shoqërisë dhe kontakteve kulturore. Të kuptuarit e ndryshimeve dhe proceseve kulturore si enkulturizimi, akulturizimi, përshtatja dhe asimilimi na lejon të pranojmë më lehtë ndryshimet që ndodhin kur takohemi me kultura të tjera. Në këtë mënyrë ne zhvillojmë tolerancën, respektin për diversitetin dhe bëhemi të aftë të jetojmë në shoqëri shumëkulturore.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Si ndërtohet identiteti kulturor?
2. Si quhet identiteti kulturor që secili prej nesh ndërton bazuar në vendin dhe rolet që merr gjatë gjithë jetës sonë?
3. Cilat janë ngjashmëritë kulturore, ndryshimet kulturore dhe universalet kulturore? Jepni nga një shembull për secilën!
4. Cilat procese kulturore mund të ndodhin kur dy kultura të ndryshme bien në kontakt?
5. Jepni një shembull të adaptimit kulturor.
6. Ç'është asimilimi dhe si ndryshon ai nga adaptimi kulturor?

7. LLOJET E SJELLJES DHE QASJA NDAJ KULTURËS

„Kam një ëndërr që katër fëmijët e mi të vegjël një ditë do të jetojnë në një komb ku nuk do të gjykojnë nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre.” – Martin Luter King

JETA MIDIS KULTURAVE – SI SILLEMI DHE SI PËRSHTATEMI?

Qasja jonë ndaj kulturave përcakton kryesisht se si ne, si qytetarë të një shoqërie shumëkulturore, do të integrohemi në të, si do ta ruajmë identitetin tonë kulturor dhe si do të ndërtojmë marrëdhënie me të tjerët që janë të ndryshëm nga ne. Qasja më e dobishme dhe e pranueshme për të gjithë është ajo e bazuar në respekt të ndërsjellë, tolerancë, dialog, mirëkuptim dhe mësim të ndërsjellë të kulturave. Pse? Sepse në këtë mënyrë përpiqemi të kuptojmë dhe të pranojmë atë që është e ndryshme nga kultura së cilës i përkasim, shmangim stereotipet, paragjykimet, diskriminimin, shovinizmin, racizmin dhe konfliktet që ato shkaktojnë. Në këtë mënyrë kuptojmë se ka mënyra të ndryshme jetese nga tonat. Megjithatë, ka njerëz që, për arsye të ndryshme, janë të mbyllur në kulturën e tyre. Ata nuk mendojnë në mënyrë kritike dhe nuk përpiqen të kuptojnë se ç'është e mirë ose e keqe në kulturat e tjera, por përkundrazi i injorojnë dhe i gjykojnë ato. Kjo qasje çon në intolerancë, konflikte dhe izolim. Si rezultat negativ i kësaj qasjeje merren **stereotipe** dhe **paragjykime** negative.

Për shembull, ju nuk keni qenë kurrë në Japoni dhe i konsideroni japonezët të ftohtë, jo komunikues, të disiplinuar dhe dashamirës të teknologjisë vetëm sepse dikush jua ka thënë këtë. Ose arrini në përfundim se të gjithë amerikanët janë sipërfaqësorë bazuar në disa video në TikTok që keni parë. Këta janë shembuj të paragjykimeve negative. Është e vërtetë që japonezët janë njerëz të mirë, të sjellshëm, të kujdesshëm dhe të disiplinuar, por jo të ftohtë. Ata thjesht përmbahen kur janë në publik. Por edhe nëse janë, kjo nuk do të thotë se çdo japonez është i tillë. Kur i atribuoni karakteristikat e një numri të vogël njerëzish një grupi ose komuniteti të tërë (përgjithësoni), atëherë krijoni stereotipe. Ato janë të dobishme për njerëzit sepse nxjerrin përfundime më shpejt. Nëse këto përfundime nuk kontrollohen, ato zakonisht nuk janë të sakta. Stereotipet mund të jenë të sakta deri në farë mase, siç është pretendimi se të gjithë lojtarët e basketbollit janë të gjatë. Stereotipet dhe paragjykimet mund të jenë pozitive ose negative. Ato janë pozitive kur një grupi i atribuohen karakteristika pozitive, për shembull, se gjermanët janë të saktë, se kinezët janë gjeni në matematikë, ose se shqiptarët e mbajnë fjalën dhe kanë kult të familjes, ndërsa se maqedonasit janë këngëtarë, valltarë, të butë dhe paqësorë. Paragjykimet negative çojnë në nënçmimin e diversitetit kulturor, diskriminim dhe padrejtësi të tjera.

Mendoni për padrejtësinë që u shkaktohet vajzave nëse një mësimdhënës thotë: „Vajzat nuk janë të mira në matematikë“.

Diskriminimi fillon me stereotipe, vazhdon me paragjykime dhe përfundon me sjellje të padrejtë (diskriminim).

Ja një shembull për të kuptuar këtë proces: nëse mbillni një farë dhe e ujitni, ajo do të lëshojë rrënjë dhe do të rritet në kërcell, ndërsa nga kërcelli do të zhvillohet një mbulesë. Kështu funksionon procesi i krijimit të diskriminimit.

Fara mund të jetë stereotip negativ që mund të thotë, për shembull, se fëmijët nga fshati nuk janë të talentuar në të nxënë. Në fillim duket si supozim i thjeshtë, i shqiptuar pa shumë mendim. Por nëse përsëritet vazhdimisht dhe pranohet si e vërtetë, ajo farë lëshon rrënjë. Prej saj rritet kërcelli – paragjykimi. Njerëzit fillojnë të besojnë paraprakisht se këta fëmijë janë më pak të aftë, kanë pritje më të ulëta prej tyre dhe nuk u japin të njëjtat mundësi. Në fund formohet mbulesa – diskriminimi. Këta fëmijë mund të neglizhohen në arsim, të mos inkurajohen të vazhdojnë arsimin e tyre ose t'u zvogëlohen shanset për zhvillim. Kështu, nga një farë e vogël e një stereotipi negativ, rritet një pemë e tërë padrejtësie. Frutat e një peme të tillë të helmuar janë gjithashtu helmuese.

Pra, diskriminimi është sjellja e padrejtë e njerëzve e shkaktuar nga stereotipet dhe paragjykimet negative. Në këtë shembull nxënësit diskriminohen sepse nuk trajtohen sipas aftësive të tyre reale, por sipas një stereotipi negativ (një pretendim i paverifikuar për fëmijët nga fshatrat). Diskriminimi është i dëmshëm si për njerëzit ashtu edhe për shoqërinë sepse krijon pabarazi dhe përçarje. Kur dikush diskriminohet, ai ndien pakënaqësi, padrejtësi dhe vetëvlerësim të ulur. Mundësitë e tyre për përparim kufizohen dhe kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Në vend të unitetit, krijohet një ndarje midis „nesh“ dhe „atyre“, gjë që çon në përçarje.

ETNOCENTRIZMI

Kritikat dhe vërejtjet që shpesh i drejtojmë në mënyrë të pavetëdijshme ndaj anëtarëve të një kulture të ndryshme nga e jona në komunikimin e përditshëm përmbajnë kryesisht qëndrime etnocentrike. Ato më shpesh kanë përmbajtjen e mëposhtme: „Pse veshin rroba të tilla? E jona është më e bukur.“ „Si mund ta hanë atë ushqim të pashëndetshëm? Kuzhina jonë është më e shijshme.“ „Ç'u pëlqen atyre në atë muzikë? Le të vijnë ta dëgjojnë tonën.“

Këta shembuj çojnë në përfundimin se **etnocentrizmi është qëndrim sipas të cilit kultura e dikujt konsiderohet më e sakta dhe më e mira**. Të duash dhe të respektosh kulturën, gjuhën dhe traditën e vet është plotësisht normale. Pra, etnocentrizmi në vetvete nuk është negativ. Megjithatë, ai bëhet negativ kur kulturat e tjera vlerësohen si më pak të vlefshme, domethënë nënvlerësohen.

Etnocentrizmi si fenomen fillon të marrë formë së pari në familje. Përmes procesit të enkulturizimit, fëmija mëson gjuhën, zakonet, normat dhe vlerat e kulturës së vet që në moshë të vogël. Nëse ata dëgjojnë vazhdimisht nga prindërit e tyre se kultura e tyre është më e mira, se njerëzit e tyre janë më mikpritësit, se ushqimi në kulturën e tyre është më i shijshmi dhe se në kulturat e tjera nuk është, është e madhe mundësia që tek ai të formohen qëndrime etnocentrike. Mungesa e kontaktit me anëtarët e kulturave të tjera gjithashtu është një shkak i etnocentrizmit. Kur nuk kemi informacion të mjaftueshëm rreth kulturave të tjera, nuk i njohim ndryshimet kulturore dhe mund të konkludojmë se jemi më të mirët.

RELATIVIZMI KULTUROR

Relativizmi kulturor është qasja e kundërt e etnocentrizmit. Nëse etnocentrizmi fillon nga qëndrimi se i yni është më i miri, atëherë qëndrimi i relativizmit kulturor do të ishte së pari të mësojmë dhe të kuptojmë, ndërsa pastaj të formojmë një mendim. Kjo do të thotë se nuk duhet t'i nënvlerësojmë njerëzit që janë të

ndryshëm nga ne derisa të mësojmë se ç'është e rëndësishme për ta dhe kulturën e tyre. Në vend që të gjykojmë sipas standardeve tona, duhet të përpiqemi të kuptojmë kuptimin e një fenomeni të caktuar në mjedis tjetër kulturor.

Ja disa shembuj që tregojnë se si, duke zbatuar relativizmin kulturor, mund t'i shmangim aspektet negative të etnocentrizmit:

Në Japoni njerëzit shpesh përkulen kur përshëndeten dhe shmangin kontaktin me sy. Nëse dikush na shikon drejtpërdrejt në sy, kjo do të thotë se na tregon respekt. Nëse nuk e dimë këtë fakt të rëndësishëm rreth kulturës japoneze, mund të krijojmë mendimin se japonezët, krahasuar me ne, janë njerëz të ftohtë dhe të pakëndshëm. Një përfundim i tillë do të ishte qëndrim etnocentrik, sepse ne e gjykojmë kulturën e tyre sipas zakoneve tona. Në Gjermani vonesa konsiderohet mungesë respekti. Nëse dikush këmbëngul në saktësi, kjo do të thotë se ata respektojnë detyrimin e rënë dakord dhe kohën e të tjerëve, jo se janë të rreptë ose të paepur. Mungesa e këtij informacioni mund të jetë gjithashtu shkak i etnocentrizmit.

SHOVINIZMI

Shovinizmi mund të përkufizohet si formë jashtëzakonisht negative e etnocentrizmit. Është qëndrim që lartëson grupin e vet (njerëzit, gjininë, fenë ose kombin), ndërsa nënçmon të tjerët që janë „të ndryshëm“. Shovinizmi shoqërohet me një ndjenjë urrejtjeje. Nuk fillon nga supozimi „ne jemi të mirë“, por nga supozimi „të tjerët/të ndryshëm janë të pavlerë“. Arsyet për shfaqjen e shovinizmit janë të ndryshme. Te disa të rinj shovinizmi shpesh buron nga një nevojë e fortë për t'u ndier pjesë e një grupi dhe për ta dëshmuar veten. Në adoleshencë të rinjtë duan të ndihen të fuqishëm dhe të pranuar. Ndonjëherë ata e arrijnë këtë duke nënçmuar të tjerët. Për shembull, një grup nxënësish mund të tall qëllimisht një shok klase nga një etni e ndryshme, duke thënë: „Je kaq... i ndyrë dhe i prapambetur.“ Ose një djalë mund të thotë: „Gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe të mos përfshihen në politikë.“ Kjo nuk është vetëm shaka, por një nënçmim i qartë.

Mediat sociale mund ta përforcojnë më tej këtë sjellje duke përhapur video që bëjnë thirrje për dhunë me komente si: „Ata duhet të dëbohen të gjithë nga vendi“. Të rinjtë, të ndikuar nga grupi dhe dëshira për t'u dukur „të fortë“, ndonjëherë përvetësojnë pikëpamje të tilla ekstreme pa menduar për pasojat.

Te të rriturit shovinizmi shpesh shoqërohet me frikën e humbjes së punës ose frikën e paragjytimeve. Për shembull, disa njerëz, kur ndihen të kërcënuar ekonomikisht, fillojnë të kërkojnë dikë për të fajësuar dhe shprehin pikëpamje shoviniste si: „Ata na marrin vendet e punës, kështu që duhet të largohen që këtej“. Ose: „Njerëzit tanë i përkasin një race më të respektuar se të tjerët“. Këto pikëpamje janë të rrezikshme sepse justifikojnë diskriminimin dhe dhunën. Gjithashtu, përvoja personale e dikujt me një person mund të çojë në përgjithësime, si për shembull: „Njëri prej tyre më vodhi... kështu janë njerëzit“. Nëse dikush është rritur në mjedis ku urrejtja ndaj një grupi të caktuar justifikohet dhe pranohej, ky qëndrim mund të bëhet pjesë e identitetit të tyre. Pa arsim, mendim kritik dhe respekt për diversitetin, qëndrime të tilla mund të çojnë në përçarje dhe konflikte serioze në shoqëri.

SEKSIZMI

Sot **seksizmi** është temë për të cilën flitet gjithnjë e më shumë. Është diskriminim ose nënvlerësim bazuar në gjini. Mund t'u drejtohet të dy gjinive, por historikisht, më shpesh i është drejtuar grave. Në shoqërinë moderne seksizmi nuk pranohet më si mënyrë „normale“ e të menduarit, por konsiderohet i padrejtë, diskriminues dhe i dëmshëm për të drejtat dhe liritë e njeriut. Ai njihet përmes fyerjeve në situata të përditshme. Për shembull, nëse dikush në shkollë thotë: „Vajzat nuk janë të mira në matematikë.“ ose „Djemtë nuk duhet të qajnë, është turp.“ – këto janë qëndrime seksiste. Në

rastin e parë aftësitë e vajzave nënvlerësohen, ndërsa në të dytin krijohet presion midis djemve të cilëve u kërkohet të mos i tregojnë emocionet e tyre. Të dy shembujt tregojnë se seksizmi kufizon si vajzat ashtu edhe djemtë, duke vendosur rregulla për to se si duhet të sillen. Seksizmi mund të shihet edhe në mediat sociale, ku vajzat shpesh gjykojnë nga pamja e tyre, ndërsa djemtë nga sa mashkullorë janë. Për shembull, nëse një vajzë dëshiron të luajë futboll dhe dikush nuk e lejon sepse mendon se është sport mashkullor, atëherë seksizmi shndërrohet në diskriminim. Gjithashtu është gjinor kur një djalë dëshiron të bëjë balet, ndërsa të tjerët tallen me të. Sot shumë të rinj përpiqen t'i thyjnë këto stereotipe dhe të tregojnë se të gjithë kanë të drejtë të zgjedhin atë që duan, pavarësisht nga gjinia. Është e rëndësishme të dimë dhe të kuptojmë se seksizmi krijon pabarazi dhe padrejtësi dhe të shihet ai si problem që duhet kapërcyer.



Seksizëm: Vlerësim i pabarabartë i punës mashkullore dhe femërore

HOMOFOBIA

Njerëzit që gjykojnë të tjerët për shkak të orientimit të tyre të ndryshëm seksual dhe identitetit gjinor janë homofobë. **Homofobia** është një lloj frike ose neverie e bazuar në paragjyime ose urrejtje ndaj njerëzve me orientim homoseksual (homoseksualë dhe lezbike), si dhe ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT+. Homofobia konsiderohet e padrejtë sepse i lëndon njerëzit. Por nëse e dimë identitetin gjinor të një personi, atëherë mund të jemi më të kujdesshëm në mënyrë që ai person të mos lëndohet. Homofobia është të mos duash të ulesh në bankë me një person homoseksual, të tallesh me të në mediat sociale, të shmangësh qëllimisht praninë e tij etj.

Në të gjithë botën qëndrimet ndaj homofobisë ndryshojnë. Edhe pse ka ligje që mbrojnë anëtarët e komunitetit LGBT+, ato nuk zbatohen në të njëjtën mënyrë kudo. Ende ka debate politike rreth të drejtave të tyre. Në



Bastisja naziste në Institutin e seksologjisë më 6 maj 1933

disa vende ato dënohen dhe sanksionohen zyrtarisht. Ky është rasti në vendet në të cilat homoseksualiteti dhe në përgjithësi sjelljet LGBT+ konsiderohen çështje që lidhen me të drejtat dhe liritë e njeriut. Në vende të tjera homofobia është zyrtarisht e ndaluar, por ekziston një stigmë (dënim) i fortë shoqëror ndaj njerëzve me orientime të ndryshme seksuale. Ky është rasti me shumicën e vendeve të Ballkanit. Në vendet e treta (Afrika dhe Lindja e Mesme), homofobia është institucionalizuar zyrtarisht, ligjërisht dhe moralisht. Në to homoseksualiteti është kriminalizuar, dënimet janë shumë të rënda dhe nuk ka tolerancë publike për njerëzit me orientime të ndryshme seksuale.

RACIZMI

Racizmi është diskriminim, denigrim ose trajtim i pabarabartë i njerëzve për shkak të racës ose ngjyrës së lëkurës së tyre. Gjatë gjithë historisë racizmi është mbështetur dhe miratuar ligjërisht në shumë pjesë të botës. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në vitet 1960 njerëzit me ngjyrë dhe të bardhë kishin shkolla, autobusë, restorante dhe hapësira të ndara publike. Në Afrikën e Jugut sistemi i aparteidit i ndau njerëzit sipas racës dhe u dha më shumë të drejta të bardhëve sesa të zinjve. Në atë kohë racizmi ishte i institucionalizuar, domethënë i integruar në vetë ligjet dhe politikat shtetërore. Sot në shumicën e vendeve racizmi është i ndaluar dhe të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit. Por kjo nuk do të thotë se racizmi është zhdukur. Shpesh shfaqet në formë të fshehur. Për shembull, në disa vende evropiane njerëzit me lëkurë të errët raportojnë se ndalohen dhe kontrollohen nga policia më shpesh. Në sport, veçanërisht në futboll, ka ende raste të tifozëve që përdorin fyerje raciste ndaj lojtarëve me prejardhje afrikane. Komentet që përhapin stereotipe dhe urrejtje bazuar në racë shfaqen në mediat sociale. Në shumë shoqëri pakicat racore kanë më shumë vështirësi në qasjen në arsim cilësor, punë të paguara mirë ose kujdes shëndetësor. Për shembull, komuniteti rom në disa vende evropiane shpesh përballet me varfëri dhe diskriminim. Në disa raste njerëzit me emra të huaj kanë më shumë vështirësi në marrjen e një ftese për një intervistë pune edhe pse kanë të njëjtat kualifikime si kandidatët e tjerë. Dallimi midis së kaluarës dhe së tashmes është se racizmi dikur lejohej dhe justifikohej zyrtarisht, ndërsa sot dënohet dhe ndëshkohet.

KOSMOPOLITIZMI



Ideja e kozmopolitizmit: Toka është shtëpi e përbashkët!

Njeriu i cili ndihet si „qytetar i botës”, e jo vetëm anëtar i një kombi, quhet **kozmpolit**. Ai ka miq nga të gjitha kombësitë dhe nuk i ndan njerëzit në „tanët” dhe „të huaj”. Ai përpiqet t’i kuptojë të tjerët pa i gjykuar për ndryshimet e tyre. I pëlqen të udhëtojë, të mësojë gjuhë të huaja dhe të njihet me traditat dhe zakonet e popujve të tjerë. Mënyra e të menduarit që përfshin qëndrime të tilla quhet kozmopolitizëm. Sipas tij, të gjitha ndryshimet kulturore duhet të kuptohen si vlera të përbashkëta dhe të gjithë njerëzit duhet të çmohen dhe vlerësohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht se kush janë dhe nga vijnë. Ai beson se disa probleme shoqërore duhet dhe mund të zgjidhen vetëm

në nivel global. Për shembull, ndryshimi i klimës, varfëria dhe ndotja e ajrit janë probleme globale të cilat vendet duhet t'i zgjidhin së bashku sepse ato ndikojnë te të gjithë.

Mendo nëse edhe ti mund ta quash veten kozmopolit?

NDËRKULTURIZMI

Ndërkulturalizmi është qasje e cila është e ngjashme me kozmopolitizmin. Dallimi është se ndërkulturalizmi inkurajon dialogun aktiv dhe bashkëveprimin midis kulturave të ndryshme brenda një shoqërie. Sipas kësaj qasjeje kulturat e ndryshme në shoqëri mbeten të ndara (secila ruan zakonet dhe traditat e veta), por komunikojnë me njëra-tjetrën. Qëllimi nuk është të fshihet identiteti i askujt, por të ketë mirëkuptim dhe bashkëpunim. Shembulli më i përshtatshëm i ndërkulturalizmit është shoqëria jonë në të cilën maqedonasit, shqiptarët, turqit, boshnjakët, romët, serbët dhe popujt e tjerë jetojnë së bashku dhe mësojnë nga njëri-tjetri rreth kulturave të tyre.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni shembullin dhe më pas përgjigjuni pyetjeve. Në këtë mënyrë do të zbuloni se cila qasje ndaj kulturave është më e pranueshme për ju.

Një nxënës i ri vjen në shkollën tuaj, i cili është zhvendosur nga një vend tjetër. Ai flet maqedonisht me një theks të ndryshëm dhe ka zakone të ndryshme fetare dhe kulturore.

Disa nxënës komentojnë:

1. „Ai nuk duhet të jetë nxënës i mirë, arsimi i tyre nuk është si i ynë.“
2. „Nuk dua të punoj me të në grup, ai do të na ngadalësojë.“
3. „Lëreni të kalojë kohë me shokët e tij.“
4. „Interesante, do të doja që ai të më tregonte më shumë rreth kulturës së tij.“
5. „Në këtë shtet të gjithë duhet të sillen si ne.“

Pas disa javësh mësimdhënësi/ja vëren se Aroni është ulur vetëm gjatë pushimit.

1. Mendoni se cilat nga pohimet janë paragjykime, cilat janë stereotipe, shoviniste, diskriminuese, ndërkulturore. Shpjegoni pse.
2. Çfarë pasojash mund të ketë sjellja e nxënësve të tjerë te një nxënës i ri?

AKTIVITETI 2. Përgjigjuni në mënyrë të pavarur se me cilat pikëpamje pajtoheni dhe me cilat jo:

1. „Njerëzit nga kultura të tjera duhet të përshtaten me shumicën“.
2. „Disa kultura janë më të zhvilluara se të tjerat.“
3. „Nuk ndihem rehat të punoj me dikë që është shumë ndryshe nga unë.“
4. „Diversiteti pasuron shoqërinë.“



MBANI MEND

Njohja e qasjeve të ndryshme ndaj kulturave na ndihmon të kuptojmë më mirë njerëzit përreth nesh dhe të respektojmë vlerat, traditat dhe mënyrat e tyre të jetesës. Në botën moderne, ku komunikojmë vazhdimisht me njerëz nga prejardhje të ndryshme, kjo njohuri kontribuon në tolerancë më të madhe, bashkëpunim më të mirë dhe ulje të paragjytimeve.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'janë stereotipet dhe ç'janë paragjykimet? Jepni shembuj.
2. Si krijohen stereotipet dhe paragjykimet?
3. Shpjegoni pse stereotipet mund të jenë të dëmshme?
4. Si ndikojnë paragjykimet në qëndrimet ndaj njerëzve të tjerë?
5. Shpjegoni (duke përdorur shembuj) lidhjen midis paragjytimeve nga njëra anë dhe diskriminimit, homofobisë, racizmit dhe etnocentrizmit nga ana tjetër.
6. Si mund të kontribuojmë në uljen e stereotipeve dhe paragjytimeve në jetën e përditshme?

8. KULTURA BASHKËKOHORE PËRMES PRIZMIT TË KULTURËS RINORE

*„Rinia ka potencialin të bëhet bartëse e ndryshimeve radikale shoqërore.“ –
Herbert Markus*

KULTURA BASHKËKOHORE – MEDIATIKE

E kundërta e kulturës tradicionale është **kultura bashkëkohore**. Nëse kultura tradicionale bazohet në zakone, besime dhe vlera që transmetohen brez pas brezi dhe njihen nga kostumet popullore, folklori dhe muzika tradicionale, kultura bashkëkohore zhvillohet nën ndikimin e teknologjisë, globalizimit dhe medias. Prandaj karakteristikat e saj kryesore janë: **ndikimi i fortë i internetit dhe mediave sociale, ndryshimet e shpejta, trendet, individualizmi dhe liria e shprehjes, ndikimet globale muzikore dhe të modës...** Kultura bashkëkohore mund të quhet edhe kultura mediatike, sepse media luan një rol qendror.

Në shoqëritë bashkëkohore media formëson realitetin dhe sistemin tonë të vlerave. Televizioni, interneti dhe mediat sociale jo vetëm që informojnë, por edhe ndikojnë në formimin e qëndrimeve tona në lidhje me suksesin dhe pozicionin tonë personal në shoqëri. Për shembull, media shpesh e paraqet suksesin përmes pasurisë materiale, famës dhe pamjes fizike. Përmes videove në Instagram dhe YouTube, krijohet një imazh se jetë e suksesshme do të thotë luks, udhëtime dhe popullaritet. Përmes përsëritjes së vazhdueshme të përmbajtjes së tillë, njerëzit, veçanërisht të rinjtë, fillojnë t'i pranojnë këto vlera si standardin me të cilin duhet të jetojë dikush.

Media promovon standardet e bukurisë dhe pamjes. Reklamat, filmat dhe mediat sociale imponojnë standarde të caktuara të pamjes fizike. Platforma si TikTok krijojnë trende që lidhen me modën, grimin dhe trupin, gjë që krijon presion mbi të rinjtë që të përshtaten me këto standarde. Ja një shembull nga jeta reale: Kohët e fundit trendi „Estetika e vajzës së pastër“ u shfaq në TikTok, duke promovuar një pamje të përsosur femërore – lëkurë të pastër dhe të shkëlqyeshme, grim diskret dhe stil të pastër. Shumë vajza filluan të përdorin produkte kozmetike për t'u dukur si ndikuese. Për shkak të krahasimeve me ta dhe pamundësisë për të arritur „idealin“, disa prej tyre filluan të ndienin presion të fortë dhe humbën vetëbesimin.



Ndikimi i influencersve te të rinjtë

Media ndikon në vlerat tona shoqërore. Një shembull i mirë se si media ndikon në shoqëri është aktivistja e re Greta Tunberg. Përmes medias dhe rrjeteve sociale ajo i dërgoi një mesazh të gjithë botës se qeveritë duhet ta marrin


më seriozisht ndryshimin e klimës. Fjalimet e saj, përfshirë atë në Samitin e Kombeve të Bashkuara, u transmetuan kudo. Në këtë mënyrë ajo u bë simbol i luftës së të rinjve kundër ndryshimeve klimatike. Përmes internetit shumë të rinj u organizuan dhe shkuan në protesta në vende të ndryshme. Kjo tregon se media mund të ndihmojë që një ide të bëhet një lëvizje globale dhe të rrisë ndërgjegjësimin për çështje të rëndësishme.

Media krijon kulturën e konsumatorit. Reklamat dhe përmbajtja e sponsorizuar na inkurajojnë të blejmë më shumë dhe t'i kushtojmë vëmendje markave. Ato shpesh krijojnë ndjesinë se kemi nevojë për një produkt të ri, edhe kur i vjetri është ende i mirë. Për shembull, kur Apple reklamon një model të ri të iPhone, reklamat nuk flasin vetëm për karakteristikat e tij. Ato dërgojnë mesazhin se ky telefon do të thotë prestigj, sukses dhe jetë moderne, sepse reklamohet nga njerëz të rinj dhe të suksesshëm. Kjo krijon përshtypjen se çdo i ri duhet të ketë iPhone-in më të fundit, ndërsa të tjerët, edhe nëse janë në gjendje të mirë, janë modele të vjetruara.

Media jo vetëm që inkurajon një kulturë blerjesh midis të rinjve, por blerjet bëhen një simbol identiteti dhe përkatësie. Personi që përdor iPhone shpesh ndihet modern, i përparuar teknologjikisht dhe elegant. Dhe kur shumë të rinj përdorin të njëjtin telefon, krijohet një ndjenjë përkatësie në grup me stil dhe vlera të ngjashme.

Shumë sociologë kanë hulumtuar ndikimin e medias dhe konsumit në identitet dhe shoqëri. Për shembull, Pjer Bordie ka hulumtuar se si shija, stili dhe markat lidhen me përkatësinë klasore dhe si njerëzit i përdorin ato për të treguar se ku i përkasin në shoqëri. Teodor Adorno foli për „industrinë e kulturës“ dhe shpjegoi se si media ndikon në të menduarit dhe sjelljen e njerëzve përmes kulturës masive dhe reklamimit. Të dy bien dakord se në shoqëri konsumi, objektet nuk janë vetëm për përdorim praktik, por bëhen edhe bartës të kuptimit. Blerja e një iPhone nuk është vetëm vendim teknik. Është mënyrë për një individ për të treguar se kush është dhe ku i përket në shoqëri. Kështu, mediumi përmes reklamimit nuk shet vetëm një produkt, por shet edhe vlera dhe një stil jetese.

Kultura bashkëkohore bazohet në individualizëm dhe liri shprehjeje. Kjo do të thotë se ajo krijon sistem vlerash sipas të cilit çdo person ka të drejtë të jetë i ndryshëm, të ketë mendimin e vet dhe të vendosë vetë për jetën e tij. Ky është tipar veçanërisht i rëndësishëm i kulturës moderne. Ajo e vendos individin në qendër të vëmendjes. Ajo i inkurajon njerëzit të shprehin stilin e tyre (përmes veshjeve, modelit të flokëve ose muzikës), të zgjedhin një profesion që u pëlqen dhe të shprehin mendimin e tyre, edhe nëse është i ndryshëm nga mendimi i shumicës. Rrjetet sociale janë mënyrë për të shprehur identitetin personal.



Rrjetet sociale – një mënyrë e shprehjes së identitetit personal



AKTIVITETI 2. Shkruani një ese të shkurtër në të cilën do të përshkruani kulturën rinore në Maqedoni sipas renditjes së mëposhtme të pyetjeve: Cilat janë karakteristikat kryesore me të cilat njihet kultura rinore në vendin tonë? Për çfarë janë më të interesuar të rinjtë? Cilat trende janë të pranishme në muzikë, modë dhe mediat sociale? Ç'është karakteristikë e stilit të veshjes dhe mënyrës së shprehjes të të rinjtë? Sa ndikojnë mediat sociale në jetën e përditshme të të rinjve? A kanë të rinjtë mundësi të mjaftueshme për të shprehur idetë e tyre? Çfarë cilësish pozitive kanë të rinjtë në vendin tonë? Ç'do të dëshironit të shihnit të përmirësuar në kulturën rinore?



MBANI MEND

Interneti e transformon kulturën në kulturë globale, digjitale, të individualizuar dhe që ndryshon me shpejtësi. Jo vetëm që e modernizon atë, por krijon edhe kulturë të re digjitale në të cilën komunikimi, identiteti dhe vlerat formësohen përmes hapësirës digjitale.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cilat janë karakteristikat kryesore të kulturës bashkëkohore mediatike?
2. Cilat media kanë ndikimin më të madh në kulturën bashkëkohore?
3. Si ndikojnë mediat në krijimin e identitetit të të rinjtë?
4. Si ndikojnë reklamat në dëshirat dhe zakonet e konsumit të të rinjve?
5. Tregoni dhe shpjegoni disa pasoja të përdorimit të tepërt të rrjeteve sociale?
6. Shpjegoni se ç'do të thotë të jesh i shkolluar për median?
7. Pse është e rëndësishme të vlerësojmë në mënyrë kritike informacionin që marrim përmes medias?

9. RRUGA E NJERIUT PËRMES SOCIALIZIMIT

„Zhvillimi moral zhvillohet në fazë.“ – Lorens Kolberg

Socializimi është proces përmes të cilit mësojmë se si të jetojmë dhe si të sillemi në shoqërinë e njerëzve të tjerë dhe në shoqëri. Ne mësojmë se cilat rregulla dhe vlera janë të rëndësishme, pse duhet t'i pranojmë normat dhe si të sillemi sipas tyre. Socializimi na ndihmon të bëhemi pjesë e kulturës dhe shoqërisë. Socializimi është proces më i gjerë që, përveç enkulturizimit, përfshin të mësuarit e shumë roleve të tjera shoqërore.

Socializimi fillon në familje që në lindje dhe zgjat një jetë. Në varësi të kulturës dhe periudhës në të cilën zhvillohet procesi i socializimit dhe burimit nga i cili mësojmë (faktorët/agjentët e socializimit), ai ndahet në **primar**, **sekondar** dhe **terciar**.

Socializimi primar zhvillohet në familje. Ai fillon që në lindje dhe zgjat deri në moshën rreth gjashtë ose shtatë vjeç, ose deri në kohën kur filloni shkollën. Në familje ju mësoni se ç'është e mirë dhe ç'është e keqe; si t'i respektoni të tjerët; si t'i zgjidhni problemet; si të përballeni me emocionet; si t'i shprehni ndjenjat dhe si të zhvilloni vetëbesimin. Ju fitoni aftësi të higjienës së përditshme, të veshjes dhe të ngrënies. Ju mësoni rolet në familje (prind-fëmijë, vëlla/motër). Ajo që mësoni në familje është shumë e rëndësishme sepse jeta juaj e ardhshme varet prej saj. Nëse rriteni në mjedis me dashuri, mbështetje dhe rregulla të qarta,

do të zhvilloni vetëbesim, përgjegjësi dhe respekt për të tjerët. Vlera të tilla do t'ju ndihmojnë më vonë të ndërtoni miqësi, të merrni vendime të mira dhe të përballeni me sfidat në shkollë, në punë dhe në shoqëri. Dhe anasjelltas, nëse ka fyerje dhe mosmarrëveshje të vazhdueshme në familje, kjo do ta bëjë fëmijën të ndihet i pasigurt dhe në ankth, ndërsa në disa raste agresiv. Ajo që mësohet në shtëpi nga prindërit shpesh bëhet themeli për sjelljen tuaj të ardhshme.

Socializimi sekondar fillon në kopsht, por bëhet veçanërisht i fortë me përfshirjen e fëmijës në shkollë dhe vazhdon gjatë gjithë fëmijërisë, adoleshencës dhe më vonë në jetë.



Bashkëmoshatarët si faktor i socializimit

Ai zhvillohet në institucione formale shoqërore si: shkolla, klube sportive, organizata për fëmijë dhe të rinj, etj. Megjithatë, shoqëria dhe miqësia gjithashtu kanë ndikim të fortë.

Bashkëmoshatarët kanë ndikim të madh, veçanërisht gjatë viteve të adoleshencës. Prej tyre mësojmë se si të sillemi në shoqëri, si të komunikojmë dhe si t'i përkasim një grupi. Nëse një stil i caktuar veshjeje është në modë midis bashkëmoshatarëve tuaj, ka gjasa që edhe ju të dëshironi të visheni në atë mënyrë. Arsyeja është e thjeshtë – të gjithë duhet t'i përkasin dhe të pranohen. Kur jemi pjesë e një grupi, ndihemi më të sigurt. Nëse grupi juaj përdor zhargon ose shprehje të caktuara, do të gjendeni përballë një zgjedhjeje: nëse do ta përvetësoni atë mënyrë të foluri në mënyrë që të mbeteni pjesë e grupit apo të qëndroni besnikë ndaj vetes. Ndonjëherë presioni është i drejtpërdrejtë („Hajde, mos u sill çuditshëm“), e ndonjëherë është i tërthortë (thjesht nuk doni të veçoheni). Ndoshta filloni të luani një lojë të caktuar video sepse të gjithë të tjerët e luajnë atë, edhe pse nuk ishit të interesuar për të më parë. Kjo do ta bëjë më të lehtë për ju të merrni pjesë në biseda dhe aktivitete të përbashkëta. Kjo tregon se bashkëmoshatarët gjithashtu ndikojnë në interesat dhe kohën tonë të lirë. Nëse një grup njerëzish shpesh lënë mësimet, nuk mësojnë dhe kanë nota të dobëta, kjo mund të ndikojë edhe në sjelljen tuaj. Gradualisht mund të filloni t'i justifikoni veprime të tilla dhe t'u bashkoheni atyre vetëm për të mos qenë ndryshe. Me kalimin e kohës kjo mund të ndikojë në sukseset, zakonet dhe mundësitë tuaja në të ardhmen.

Ndikimi i bashkëmoshatarëve nuk është gjithmonë negativ. Nëse grupi juaj mëson rregullisht, mbështet njëri-tjetrin, luan sporte, ka qëllime dhe ambicie, atëherë do të ndiheni edhe të motivuar për të përparuar. Mjedisi pozitiv ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit, përgjegjësisë dhe identitetit të shëndetshëm. Prandaj është e rëndësishme të dini se përkatësia është e rëndësishme, por është edhe më e rëndësishme të mos sakrifikoni vlerat dhe qëllimet tuaja vetëm për t'u pranuar.

Socializimi terciar zhvillohet përmes medias, internetit, muzikës, filmave dhe mediave sociale. Përmes tyre të rinjtë mësojnë ide, trende, stile veshjeje, gjuhë dhe vlera të reja që nuk i kanë mësuar në familjen e tyre ose në shkollë. Për shembull, kur dëgjoni këngët e Taylor Swift, nuk e dëgjoni vetëm muzikën, por përmes teksteve të këngëve mësoni për miqësinë, guximin dhe vetëbesimin.

Përktheni këngët „You belong with me“ dhe „Fearless“ dhe analizoni se çfarë mesazhi u përcjellin të rinjve!

Përmes serialeve dhe filmave artistikë të rinjtë mësojnë rreth marrëdhënieve, konflikteve dhe roleve shoqërore, por ndonjëherë ata përballen me përfaqësime dhe imazhe joreale të jetës. Për shembull, shpesh krijohet një imazh se të gjithë duhet të kenë pamje perfekte, shumë para ose jetë emocionuese. Reklamat gjithashtu mund të ndikojnë në vlerat, stilin e veshjes, sjelljen dhe madje edhe vetëbesimin e të rinjve. Ato bëhen faktor i fortë i socializimit, sepse përmes tyre të rinjtë mësojnë se ç'është e popullarizuar, e suksesshme dhe e dëshiruar. Meqenëse ky socializim zhvillohet kryesisht në mënyrë elektronike, është shumë e rëndësishme që të rinjtë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të dinë se jo gjithçka që shohin dhe dëgjojnë është e vërtetë ose e saktë. Komuniteti më i gjerë, siç është komuna, fqinjët, kisha ose xhamia, janë gjithashtu vende ku zhvillohet socializimi, sepse ata mësojnë vlera, rregulla, norma dhe zakone që nuk mësohen në familje ose në shkollë.

Enkultimizimi është proces shoqëror më i ngushtë sesa socializimi. Ai i referohet futjes së një individi në kulturën e komunitetit të tij ose të saj. Enkultimizimi është pjesë e socializimit dhe është proces përmes të cilit të rinjtë mësojnë vlerat dhe traditat kulturore të shoqërisë në të cilën jetojnë. Socializimi përgjigjet pyetjeve se si të jetohet dhe si të sillet në shoqëri, ndërsa enkultimizimi përgjigjet pyetjes se ç'është kultura ime dhe si e përjetoj atë.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Elena është fanse e madhe e Tajlor Svift. Përveç dëgjimit të muzikës së saj, ajo ndjek rregullisht reklamën dhe markat e modës që lidhen me turneun e këngëtares të njohur si „The Eras Tour“ (Turneu nëpër periudha). Për shkak të ekspozimit ndaj reklamave dhe përmbajtjes në mediat sociale, Elena fillon të blejë rroba të frymëzuara nga stili i këngëtares, organizon festa ditëlindjeje me tematikë në stilin e saj dhe ndryshon stilin e saj (modelimin e flokëve, grimin) sipas trendeve që sheh në media. Pyetje për hulumtim:

1. Sipas cilave veprime të Elenës mund të konkludojmë se ajo është e ndikuar nga media dhe reklamën?
2. A blen Elena rroba sepse i pëlqejnë vërtet apo sepse dëshiron të ndjekë stilin e Tajlor Svift? Shpjegoni.
3. Si ndikojnë mediat sociale në shprehjen e saj të vetvetes dhe në stilin e saj?
4. A mund të „shesin“ reklamën dhe përmbajtja mediatike një mënyrë jetese, jo vetëm produkte? Si e shihni këtë në këtë shembull?
5. Cili është ndryshimi midis të qenit i frymëzuar nga dikush dhe të ndjerit nën presion për ta imituar atë?
6. Si mund ta ndryshojë ndikimi i medias vetëbesimin dhe miqësitë e Elenës?
7. A mendoni se Elena do të kishte bërë të njëjtën gjë nëse nuk do të kishte ndjekur muzikën dhe reklamën që lidhen me turneun? Pse?



MBANI MEND

Socializimi dhe kulturalizimi janë procese të rëndësishme sepse nëpërmjet tyre mësojmë se si të jetojmë me njerëz të tjerë dhe si të ndërtojmë identitetin, qëndrimet dhe vetëbesimin tonë nëpërmjet familjes, shkollës, bashkëmoshatarëve dhe medias. Pa këto dy procese një person nuk do të ishte në gjendje të zhvillohej plotësisht si person, as të funksiononte me sukses në komunitet.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Pse socializimi është i rëndësishëm për zhvillimin e personit?
2. Cilat janë llojet kryesore të socializimit?
3. Ku zhvillohet më shpesh socializimi primar?
4. Cilat institucione kanë rol të rëndësishëm në socializimin sekondar?
5. Shpjegoni pse themi se procesi i socializimit zgjat gjatë gjithë jetës?
6. Si kontribuon socializimi në funksionimin e suksesshëm të individit dhe shoqërisë?
7. Cilat institucione më shpesh janë përgjegjëse për socializimin terciar?

10. SOCIOLOGJIA E BREZAVE DHE CIKLEVE JETËSORE

„Brezat nuk përcaktohen vetëm nga mosha, por nga një përvojë e përbashkët historike.” – Karl Manhajm

JETA JONË PËRMES PERIUDHAVE

Jeta e çdo personi kalon nëpër disa faza: fëmijëri, adoleshencë, moshë madhore dhe pleqëri. Këto faza quhen cikle jetësore dhe janë pjesë e zhvillimit të çdo personi. Sociologjikisht, këto nuk janë vetëm faza të ndryshme të rritjes. Role dhe pritje shumë specifike shoqërore i bashkëngjiten secilës fazë.

Fëmijëria është faza e parë e jetës. Është kohë kur trupi ndryshon dhe rritet me shpejtësi fizikisht dhe kur mësohen aftësi të reja: të ecin, të flasin, të luajnë, të ndjekin rregullat, të sillen saktë me të tjerët. Në këtë fazë fëmijët krijojnë marrëdhënien e tyre të parë me prindërit dhe familjen e tyre, e përmes kësaj marrëdhënie ata mësojnë se ç’do të thotë besimi, siguria, emocionet, detyrimet dhe përgjegjësitë. Prandaj zhvillimi ynë i ardhshëm varet nga fëmijëria.

Faza e dytë e jetës është **adoleshenca**. Në këtë fazë fëmija gradualisht bëhet person i ri. Zakonisht zgjatet nga mosha dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Është kohë kur, përveç trupit, ndryshon edhe mendja. Të rinjtë mësojnë të jenë të pavarur, të marrin vendime dhe të zbulojnë identitetin e tyre. Ata e kuptojnë se kush janë dhe ç’duan në jetë. Gjatë kësaj periudhe faktorët e socializimit kanë ndikim të madh: bashkëmoshatarët, shkolla, familja dhe media. Të rinjtë frymëzohen nga mediat sociale, muzika, filmat dhe trendet, por në të njëjtën kohë ata mësojnë të krijojnë qëndrimet dhe vlerat e tyre. Për shembull, nëse ju dhe shumica e miqve tuaj nga brezi juaj ju pëlqen muzika e Taylor Swift, kjo do të jetë një nga arsyet për të kaluar më shumë kohë, sepse mendoni dhe e kuptoni muzikën e saj në të njëjtën mënyrë. Adoleshenca është e rëndësishme sepse atëherë mësojmë se si të jetojmë në mënyrë të pavarur dhe të ndërtojmë personalitetin tonë.

Faza tjetër e jetës është **mosha madhore**. Në këtë fazë të jetës një person bëhet plotësisht i pavarur dhe merr përgjegjësi për vendimet dhe veprimet e tij. Zakonisht fillon pas adoleshencës dhe zgjat më gjatë. Gjatë kësaj periudhe njerëzit zgjedhin një profesion, krijojnë familje, ndërtojnë karrierë dhe përpiqen për një jetë të qëndrueshme dhe më të sigurt. Në moshë madhore personi është emocionalisht më i qëndrueshëm, më me përvojë dhe më i aftë për të marrë vendime të rëndësishme. Personi e realizon potencialin e tij kontribuon në shoqëri dhe bëhet shembull dhe mbështetje për brezat e rinj.



Cikli jetësor nga fëmijëria në pleqëri

Pleqëria është faza e fundit e ciklit jetësor dhe zakonisht fillon pas përfundimit të jetës së punës së një personi. Gjatë kësaj periudhe personi ka përvojë të pasur jetësore dhe më shumë kohë për veten dhe familjen e tij pasardhësit dhe interesat personale. Edhe pse mund të shfaqen dobësi fizike ose probleme shëndetësore, pleqëria është kohë kur më të moshuarit u kalojnë mençurinë dhe përvojën jetësore brezave të rinj.

JETA DIKUR DHE TANI: KUPTIMI I DALLIMEVE NDËRBREZORE

Edhe pse të gjitha brezat e njerëzve kalojnë nëpër këto faza të jetës, secili prej tyre përjeton fëmijërinë, rininë, moshën madhore dhe pleqërinë ndryshe sepse ka karakteristika të ndryshme brezash që i formësojnë ata.

Lloji i brezit	Vitet e përafërta të lindjes	Karakteristikat kryesore
Bebi bumersat	1946 – 1964	E vlerësojnë stabilitetin dhe punën, janë rritur në një periudhë rritjeje ekonomike, besojnë në vlerat tradicionale.
Brezi iks	1965 – 1980	Të pavarur, të adaptueshëm, kanë përvojë me teknologji të ndryshme (kompjuterë, internet), shpesh kritikë ndaj autoritetit.
Milenialët (brezi ypsilon)	1981 – 1996	"Pionierë" digjitalë, vlerësojnë arsimin dhe përvojat, respektojnë ekuilibrin midis punës dhe jetës private.
Brezi zet	1997 – 2009	Të lindur me internetin, praktikë, krijues, shokët e tyre janë mjete digjitale.
Brezi alfa	2010 – sot	Rriten me pajisje inteligjente, inteligjencë artificiale, teknologji të përparuara, mësojnë vizualisht dhe në mënyrë interaktive.

Paraqitje tabelare e karakteristikave të brezave

Brezi Bebi bumersat përfshin njerëz të lindur pas Luftës së Dytë Botërore. Ata u rritën në periudhë rindërtimi dhe rritjeje ekonomike. Në shumë vende ishte një kohë kur familjet u rritën, u ndërtuan shtëpi të reja dhe besohej se puna e palodhur mund të arrinte një të ardhme më të mirë. Disiplina dhe përgjegjësia vlerësoheshin, ndërsa respekti për familjen, pleqtë dhe sjellja e mirë ishin vlerat më të rëndësishme. Arsimi konsiderohej çelësi i suksesit. Bebi bumersat u rritën pa internet dhe pa telefona celularë. Fëmijëria e tyre ishte e mbushur me lojëra jashtë, komunikim të drejtpërdrejtë dhe komunitete të forta lokale. Si të rinj, ata morën pjesë në ndryshime shoqërore, lëvizje për të drejtat e njeriut dhe transformime kulturore.

Brezi iks e kaloi fëmijërinë e tyre pa internet dhe telefona inteligjentë. Lojërat e fëmijëve zhvilloheshin jashtë, në lagje, përmes kontakteve të përditshme me shokët. Në adoleshencë këta të rinj u përballën me ndikimet e televizionit, muzikës dhe shkollës, por familja luajti rolin më të fortë në socializim. Në moshën e rritur të hershme anëtarët e këtij brezi shpesh përpiqeshin për një punë të qëndrueshme dhe siguri afatgjatë. Për shembull, shumë prej tyre qëndruan në të njëjtën punë për vite me radhë, duke vlerësuar besnikërinë, bindjen dhe disiplinën.

Përfaqësuesit e brezit ypsilon, të njohur si mijëvjeçarë (të lindur në fund të mijëvjeçarit të dytë), u rritën në kohë kur interneti bëhej gradualisht pjesë e jetës së përditshme. Fëmijëria e këtij brezi bazohet në vlerat tradicionale, por në adoleshencë ata tashmë fillojnë të përdorin telefonat celularë dhe mediat sociale. Kjo ka ndikuar në mënyrën se si ata ndërtojnë miqësi dhe identitet. Në moshën e rritur të hershme mijëvjeçarët kanë ndërruar punë më shpesh, madje edhe profesione, të cilat u sollën atyre përmbushje personale, jo vetëm një pagë të sigurt. Për shembull, një i ri nga ky brez mund të lërë një punë të qëndrueshme për të filluar biznesin e vet ose për të punuar „i pavarur“ në kërkim të një lirie dhe ekuilibri më të madh midis punës dhe jetës private.



Dallimet ndërmjet brezave: avantazh apo sfidë!

Brezi zet quhet edhe „brezi digjital“ sepse u rrit me telefona inteligjentë, internet dhe media sociale që në moshë të vogël. Socializimi i tyre është i lidhur fort me komunikimin elektronik. Në adoleshencë, përveç shkollës dhe familjes, ndikuesit, trendet dhe përmbajtja digjitale kanë ndikim të madh. Për shembull, një i ri mund të shprehë identitetin e tij përmes një profili në mediat sociale, të marrë pjesë në komunitete digjitale ose të ndërtojë mendimet e tij bazuar në ngjarje globale që ndjek në kohë reale. Ky brez tregon ndjeshmëri më të madhe ndaj çështjeve të shëndetit mendor, ekologjisë dhe të drejtave të njeriut.

Një nga arsyet më të zakonshme për sjellje devijuese janë **kufizimet sociale dhe ekonomike**. Kur njerëzit nuk kanë mundësi për arsim, punë ose jetë të mirë, ata vendosin më lehtë të arrijnë qëllimet e tyre me mjete të paligjshme. Për shembull, një i ri që nuk ka mundësi të gjejë punë dhe detyrohet të jetojë në varfëri mund të tundohet të vjedhë për të siguruar para. Kjo nuk do të thotë se varfëria çon në mënyrë të pashmangshme në krim, por që kushtet e vështira rrisin rrezikun e një sjelljeje të tillë. Megjithatë, nëse dikush do ta ndjekë atë rrugë varet edhe nga mjedisi. Për shembull, në disa qarqe biznesi të nivelit të lartë mjedisi imponon një kriter që suksesi matet ekskluzivisht përmes fitimit dhe pushtetit. Një mjedis i tillë krijon ambient ku është „normale“ të anashkalohen ligjet për të mposhtur konkurrencën në mënyrë që të fitohen më shumë para dhe pushtet.

Ndikimi i bashkëmoshatarëve dhe i mjedisit gjithashtu është i madh. Nëse grupi i bashkëmoshatarëve (sidomos adoleshentët) e pranon vandalizmin ose dhunën si normale, individit, për të mos u refuzuar nga grupi, mund t'i pranojë këto modele sjelljeje. Për shembull, një nxënës që nuk do të merrte pjesë kurrë në përleshje fizike mund ta bëjë këtë nën presionin e miqve. **Mungesa e mbështetjes prindërore, neglizhenca dhe dhuna në shtëpi** mund të jenë shkaqe serioze të sjelljes devijuese. Një fëmijë që rritet në mjedis pa dashuri dhe vëmendje dhe ku agresioni është jeta e përditshme, mund të kuptojë se dhuna është mënyrë e pranueshme për të zgjidhur konfliktet.

Nëse dikush **etiketohet vazhdimisht** (quhet vazhdimisht) si problematik ose i keq, ai mund të fillojë të sillet në përputhje me atë etiketë. Për shembull, një nxënës që dikur ka kryer një vepër penale dhe ndëshkohet dhe nënçmohet vazhdimisht, mund të humbasë vetëbesimin dhe të vazhdojë me të njëjtën sjellje. **Ndikimi i medias dhe kulturës bashkëkohore** nuk duhet të anashkalohet gjithashtu. Ndonjëherë media e portretizon dhunën, krimin ose paratë e shpejta në mënyrë tërheqëse. Të rinjtë që nuk mendojnë në mënyrë kritike, mund t'i imitojnë këto modele.

Sjellja devijuese mund të rezultojë edhe nga **krizat personale dhe problemet emocionale** (ndjenjat e vetmisë, vetëvlerësimit të ulët, zemërimit ose frustrimit). Nga e gjithë kjo mund të konkludohet se sjellja devijuese nuk shfaqet papritur dhe pa arsye. Më shpesh është rezultat i një kombinimi faktorësh personalë dhe shoqërorë.

KONFORMIZMI DHE JOKONFORMIZMI SI SHKAQE TË SJELLJES DEVIJUESE

Konformizmi është përshtatja e individit me normat dhe vlerat shoqërore, duke u përpjekur të pranohet nga grupi dhe të shmangë dënimin. Në atë rast sjellja devijuese zakonisht zvogëlohet, sepse frika nga sanksionet dhe dëshira për përkatësi e drejtojnë individin drejt veprimeve të pranueshme shoqërisht. **Jokonformizmi** është mospranimi i rregullave dhe qëndrimeve të pranura përgjithësisht, domethënë individit nuk dëshiron të jetë i njëjtë me të tjerët. Kjo mund të jetë një arsye për sjellje devijuese. Individit shkel me vetëdije normat (rebelohet, nuk pajtohet, dëshiron të dallohet). Megjithatë, jokonformizmi

nuk ka gjithmonë shenjë negative. Ndonjëherë është pikërisht përmes tij që ndryshohen rregullat e vjetruara dhe inkurajohet përparimi shoqëror. Prandaj si konformizmi ashtu edhe jokonformizmi mund të ndikojnë në sjelljen devijuese. Tek adoleshentët konformizmi (dëshira për t'u pranuar nga grupi) shpesh mund të bëhet arsye për sjellje devijuese.



Guximi për të qenë ndryshe është hapi i parë drejt ndryshimit!

SANKSIONET

Sanksionet janë mënyra se si shoqëria reagon ndaj sjelljes së individëve në mënyrë që të ruajë normat dhe të rregullojë sjelljen. Ato mund të jenë **pozitive**: lavdërim ose njohje për sjellje korrekte, ose **negative**: ndëshkim, gjoja ose burgim kur dikush i shkel rregullat. Sanksionet mund të jenë gjithashtu **formale** (të vendosura nga shkolla, gjykata ose shteti) dhe **joformale** (të vendosura nga familja, shokët ose komuniteti përmes dënimit, injorimit ose kritikës).

Mënyra se si përcaktohen sanksionet varet nga disa kritere: **ashpërsia e devijimit** (sa seriozisht shkelet norma), **rëndësia e vlerës që shkelet** (nëse kërcënohen vlerat themelore), **qëllimi i shkelësit** (nëse akti është kryer me dashje apo aksidentalisht) e kështu me radhë. Sanksionet nuk janë arbitrare, por rregullohen nga rregullat dhe ligjet shoqërore dhe përcaktojnë saktësisht se ç'lejohet dhe cilat janë pasojat e sjelljes devijuese.

Aktivitetet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Më poshtë janë disa pohime. Detyra juaj është të shpjegoni se a jeni dakord me to (pse po, pse jo) dhe se a do të vepronit në të njëjtën mënyrë. Në këtë mënyrë do të kuptoni se si konformisti shmang sjelljen devijuese, ndërsa jokonformisti mund ta shkaktojë atë.

1. Nëse shokët/bashkëmoshatarët tuaj thyejnë stola parku ose vizatojnë grafitë në mure, mund të mos e bëni vetë, por do të merrni pjesë në mënyrë që të mos talleni ose përjashtoheni nga grupi.
2. Filloni të pini duhan ose alkool sepse të gjithë në grup e bëjnë këtë. Frika nga të mos qenit „in“ ose „kul“ ju bën të përshtateni me grupin.
3. Shokët e klasës tallen me një nxënës që mban syze me dioptri të lartë. Ju i kundërshtoni ata edhe pse mund të përjashtoheni nga grupi.
4. Shokët tuaj vendosin të mos shkojnë në mësim, ndërsa ju nuk e bëni sepse jeni të vetëdijshëm për pasojat.
5. Ju shpërndani meme ofenduese dhe përhapni thashetheme të turpshme në mediat sociale për të marrë pëlqime dhe miratim nga bashkëmoshatarët tuaj.

AKTIVITETI 2. Analizoni sjelljet e përshkruara devijuese dhe më pas shpjegoni: Cila është arsyeja për secilën sjellje? Cilat vlera kërcënohen nga një sjellje e tillë? Cilat janë pasojat e saj dhe si, sipas mendimit tuaj, duhet të sanksionohet? Debatoni me shokët e klasës: A është më mirë të ndëshkohet apo të punohet për parandalimin dhe si? Kur duhet të përfshihen prindërit dhe kur duhet të përfshihen institucionet? Cilat janë shkaqet më të zakonshme të sjelljes devijuese të rinjtë në Maqedoni? Sugjeroni mënyra për të zvogëluar disa nga devijimet.

SITUATA 1. Një nxënës sulmon qëllimisht një nxënës tjetër dhe e lëndon atë.

SITUATA 2. Shokët e klasës postojnë foto ose mesazhe fyese për një shok klase në rrjetet sociale.

SITUATA 3. Një nxënëse mban një objekt të rrezikshëm me qëllim që të mbrohet.

SITUATA 4. Ju thyni tavolinën e mësimdhënësit, shkatërroni kompjuterët.

SITUATA 5. Një nxënës/e mban dhe shet drogë të paligjshme.



MBANI MEND

Të jeni në gjendje të njihni sjelljen devijuese dhe të vlerësoni pasojat e saj është jashtëzakonisht e rëndësishme, veçanërisht në shoqërinë moderne. Kjo do t'ju mundësojë të keni një zhvillim personal të saktë, të sigurt dhe të suksesshëm. Kur të dini si të dalloni sjelljen e dëmshme, të pasaktë ose të rrezikshme, do të jeni në gjendje të merrni vendime të përgjegjshme dhe të shmangni pasojat që mund të ndikojnë negativisht në të ardhmen tuaj. Të keni një qëndrim të saktë dhe kritik ndaj devijimit nuk do të thotë të keni frikë nga ndëshkimi, por të kuptoni pasojat dhe të zhvilloni një ndjenjë përgjegjësie dhe vetëdisipline. Në këtë mënyrë bëheni më rezistent ndaj presioneve nga ndikimet negative, e kështu anëtar i përgjegjshëm dhe i dobishëm i shoqërisë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cilët faktorë mund të shkaktojnë sjellje devijuese te të rinjtë?
2. Si mund të ndikojnë familja, shkolla dhe bashkëmoshatarët në shfaqjen dhe parandalimin e sjelljes devijuese?
3. Çfarë pasojash mund të ketë sjellja devijuese për individin dhe shoqërinë? Jepni shembuj.
4. Shpjegoni se njerëzit a janë devijues nëse ndonjëherë shkelin normat shoqërore. Jepni shembuj.
5. Shpjegoni përmes shembujve se ndëshkimi a është gjithmonë mënyra më e mirë për të zvogëluar sjelljen devijuese?
6. Pse e njëjta sjellje mund të jetë e pranueshme në shoqëri dhe devijuese në tjetër?

16. LLOJET E SJELLJES DEVIJUESE

„Devijimi nuk është veti e vetë aktit, por pasojë e zbatimit të rregullave dhe sanksioneve nga të tjerët.” – Entoni Gidens (sociolog)

Shumë shpesh, devijimet ose shkeljet barazohen me sjellje devijuese, ndërsa nuk duhet të jenë. Siç e pamë më parë, nëse një devijim do të etiketohet shoqërisht dhe do të trajtohet si devijues varet nëse devijimi kërcënon ndonjë vlerë të rëndësishme siç është siguria, ndershmëria ose drejtësia. Nëse po, atëherë gjasat që dikush të etiketohet si devijues janë shumë më të mëdha.

Në sociologji ekzistojnë disa mënyra për të klasifikuar sjelljen devijuese:

1. Në varësi të fushës në të cilën shkelen normat, mund të jetë: devijues ekonomik, politik, ligjor ose moral. Për shembull, në fushën ekonomike një menaxher fsheh qëllimisht humbjet financiare të kompanisë në mënyrë që të duket se vepron me sukses. Në politikë një politikan pranon një ryshfet për të miratuar një ligj që është në interes të një kompanie të caktuar. Në fushën ligjore një gjyqtar jep padrejtësisht një vendim të favorshëm për një person që ka kryer një krim të rëndë. Në të gjitha këto raste shkelen rregullat dhe shkelet besimi i qytetarëve.

2. Sjellja devijuese mund të dallohet edhe nga ashpërsia e saj. Prandaj ekzistojnë forma më të lehta dhe më të rënda. Për shembull, një nxënës që vonohet vazhdimisht në mësim ose nuk respekton rregullat e shkollës shfaq një formë më të lehtë të sjelljes devijuese. Megjithatë, grabitja e një banke ose shkaktimi i lëndimit serioz ndaj një personi tjetër është formë shumë më e rëndë sepse dëmi është serioz dhe pasojat janë të mëdha.

3. Në varësi të atij që vendos sanksionin, bëjmë dallimin midis **dënimit moral dhe dënimit ligjor**. Ka situata në të cilat pasojat e veprës penale nuk janë aq të rënda dhe për këtë arsye sanksionet janë më të buta. Për shembull, nëse një nxënës kopjon në provim, mësimdhënësi mund të lëshojë një dënim moral (qortim, notë të ulët ose masë pedagogjike). Megjithatë, kur bëhet fjalë për vepra penale më të rënda, siç është vjedhja e një makine ose shkaktimi i një aksidenti trafikës me një këmbësor të lënduar, sanksioni vendoset nga gjykata. Këto vepra penale dënohen me gjobë ose burgim, sepse përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit dhe shkaktojnë dëme të mëdha. Ashpërsia e veprës penale përcakton gjithashtu ashpërsinë e dënimit.

4. Një kriter tjetër i rëndësishëm është autori, d.m.th. nëse vepra penale kryhet nga një person apo nga një grup. Kur vepra penale kryhet nga një person, flasim për **devijim individual**. Për shembull, një nxënës shkatërron gomat e automjeteve të parkuara para shkollës. Megjithatë, kur disa persona marrin pjesë në vepër penale, flasim për **devijim në grup**. Një shembull i tillë është thyerja e stolave dhe skulpturave në park ose përdhosja e busteve dhe gurëve të varreve. Në këto raste përgjegjësia ndahet nga të gjithë pjesëmarrësit. Devijimi në grup shpesh është më i rrezikshëm sepse në grup njerëzit inkurajohen më lehtë

të bëjnë diçka që mund të mos e bëjnë vetë. Prandaj për të kuptuar më mirë sjelljen devijuese, është e rëndësishme të dimë se kush e vendos sanksionin dhe kush e kryen aktin. Këto dallime na ndihmojnë të kuptojmë pse disa veprime sanksionohen me një qortim ose dënim moral, ndërsa të tjerat sanksionohen me një dënim të rreptë ligjor.

Format më të njohura të devijimit janë: **krimi, delinkuenca e të miturve, korrupsioni, nepotizmi, mobingu, bullizmi, vandalizmi dhe lloje të ndryshme të varësisë.**

KRIMI DHE LLOJET E KRIMIT

Krimi është çdo veprim ose mosndërmarrje veprimi që përcaktohet me ligj si vepër penale dhe për të cilën parashikohet një dënim i përshtatshëm. Specifika e krimit si devijim shoqëror është se veprime të tilla shkelin disa vlera themelore shoqërore (siguria, jeta, rendi juridik) dhe interesin publik që lidhet me to. Me fjalë të tjera, **krimi është sjellje devijuese që përcaktohet ligjërisht si vepër penale sepse është e dëmshme për interesin publik të komunitetit.** Për këtë arsye, procedura për vlerësimin dhe ndëshkimin e devijimeve të tilla kryhet nga shteti përmes prokurorit publik (sipas detyrës zyrtare ose me ankesë nga një qytetar).

Ky është përkufizim i pranuar përgjithësisht i përdorur nga juristët dhe sociologët në të gjithë botën.

Emil Dyrkemi e studioi krimin. Për të, ai është sjellje që shkel moralin dhe normat kolektive të shoqërisë, por në të njëjtën kohë ka funksion shoqëror. Sipas Dyrkemit, duke dënuar krimin, shoqëria kontrollon nëse rregullat, normat dhe vlerat ekzistuese duhet të rishikohen dhe nëse ka nevojë për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve për rëndësinë e sjelljes etike. Nga kjo perspektivë krimi gjithashtu është një sinjal se diçka në shoqëri dhe shtet nuk funksionon siç duhet.

KRIMI SHETËROR DHE KRIMI I ORGANIZUAR

Kjo ndarje bëhet sipas bartësit të sjelljes kriminale dhe mënyrës së ekzekutimit të saj. Në **krimin shtetëror** bartësit e sjelljes kriminale janë institucionet shtetërore, funksionarët ose mbajtësit e posteve publike përmes abuzimit të pozicionit zyrtar. Më shpesh ndodh në formën e korrupsionit politik, përgjimit të paligjshëm, zbulimit të sekreteve shtetërore, brutalitetit policor, manipulimit zgjedhor, keqpërdorimit të financave publike, shkeljes së të drejtave të njeriut, etj.

„**Krimi i jakës së bardhë**“ kryhet kryesisht nga biznesmenë, menaxherë dhe nëpunës civilë për të arritur përfitim personal ekonomik. Shembuj të kësaj janë mashtrimet e ndryshme financiare, evazioni fiskal, përvetësimi, etj. Të dyja llojet e krimit kryhen duke abuzuar me pushtetin dhe pozicionin, por ndryshojnë në interesin e kujt kryhen.

Autorët e krimit të organizuar janë grupe të organizuara mirë që veprojnë sistematikisht, në plan afatgjatë dhe me një strategji të menduar mirë për të fituar përfitime materiale. Këto janë rrjete kriminale

si mafia, trafikimi i drogës, trafikimi i armëve ose trafikimi i qenieve njerëzore. Është thelbësore që grupet të veprojnë jashtë institucioneve të qeverisë, por ndonjëherë përpiqen të ndikojnë në shtet përmes korrupsionit.

KORRUPSIONI

Korrupsioni është kur dikush me autoritet ose përgjegjësi zyrtare abuzon me pozicionin e tij për përfitime personale, shpesh përmes ryshfetit, lidhjeve ose favorizimit të padrejtë. Në vend që vendimet të merren sipas ligjit dhe meritës, ato merren sipas interesit personal. Korrupsioni është i dëmshëm sepse krijon padrejtësi. Njerëzit që janë të aftë dhe punëtorë mund të lihen mënjane, ndërsa ata me para ose „lidhje“ mund të fitojnë avantazh. Kjo zvogëlon besimin në gjykata, qeveri dhe institucione arsimore. Kur qytetarët mendojnë se rregullat nuk zbatohen njësoj për të gjithë, lind zhgënjim dhe pasiguri. Pikërisht për këtë arsye korrupsioni ngadalëson zhvillimin e shoqërisë. Paratë që duhet të shkojnë në arsim, shëndetësi ose infrastrukturë përfundojnë në xhepa private.



Korrupsioni është pandershëm

Arsyet e shfaqjes së korrupsionit janë të ndryshme. Më shpesh ndodh për shkak të lakmisë dhe dëshirës për fitim të shpejtë dhe pasurim të lehtë. Por korrupsioni zhvillohet edhe kur nuk ka kontroll të fortë në shtet dhe kur dënimet nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Nëse nuk ka llogaridhënie, disa njerëz inkurajohen të abuzojnë me pozicionin e tyre. Përveç kësaj, korrupsioni ndodh edhe për shkak të disa zakoneve të vjetra në shoqëri, domethënë kur „lidhjet“ konsiderohen si mënyra normale për të zgjidhur problemet. Kur udhëhiqemi nga mendimi „të gjithë e bëjnë, kështu që edhe unë mund ta bëj“, ne në fakt justifikojmë dhe forcojmë padrejtësinë dhe korrupsionin. Korrupsioni nuk është zgjuarsi. Është padrejtësia që dëmton të gjithë shoqërinë dhe prish jetesën së bashku.

Sociologjikisht, korrupsioni si akt kriminal është bashkëveprim specifik shoqëror. Është marrëdhënie shoqërore në të cilën palët e përfshira shkëmbejnë burime, shërbime ose pushtet në mënyrë të paligjshme ose joetike. Për shembull, ryshfeti është marrëdhënie shoqërore midis një ryshfetdhënësi dhe një personi të ryshfetuar. Të dy janë autorë të sjelljes devijuese – jo vetëm ai që merr ryshfetin, por edhe ai që jep.

DELIKUENCA E TË MITURVE

Delikuenca e të miturve është një lloj i veçantë i devijimit në të cilin bartës të sjelljes devijuese janë të miturit. Është një lloj i veçantë sepse më shpesh ndodh gjatë periudhës së adoleshencës, kur të rinjtë janë të prirur ndaj rreziqeve dhe eksperimentimit, kanë emocione më intensive, ekziston dëshira për të provuar veten, kërkojnë pavarësi dhe duan të çlirohen nga autoriteti i prindërve të tyre. Por në të njëjtën kohë ata janë edhe nën ndikimin e fortë të bashkëmoshatarëve të tyre. Me fjalë të tjera,

adoleshenca është „klime e favorshme“ për shfaqjen e sjelljes devijuese. Delikuenca e të miturve mund të manifestohet si vepër penale personale, por shpesh si vepër penale në grup (nga bashkëmoshatarët). Mund të jetë e një lloji më të lehtë: vandalizëm, dhënie informacioni të rremë, vonesë, mosbindje, por edhe e një lloji më serioz: vjedhje, dhunë fizike; përdorim i alkoolit dhe drogës ose pjesëmarrje në grupe kriminale. Pavarësisht nga ashpërsia, këto vepra penale shkelin sigurinë e të rinjve dhe mjedisit të tyre, duke krijuar rreziqe në proceset e socializimit, integritetit dhe kulturizimit. Parandalimi i delikuencës së të miturve bazohet në kombinim masash edukative, sociale dhe ligjore.

Gjatë adoleshencës të rinjtë shpesh përballen me forma të ndryshme të sjelljes devijuese, duke përfshirë bullizmin, mobingun dhe vandalizmin. Edhe pse këto fenomene mund të gjenden edhe të rriturit, ato janë veçanërisht të dukshme në mjedisin shkollor dhe të të rinjve. **Bullizmi** (dhuna nga bashkëmoshatarët) është keqtrajtimi i përsëritur dhe i qëllimshëm i një personi nga një person ose grup tjetër. Mund të jetë fizik (shtyrje, goditje), verbal (fyerje, tallje) ose psikologjik (përrashtim nga shoqëria, përhapje thashethemesh). Sot një formë e zakonshme e dhunës është ngacmimi kibernetik, i cili kryhet nëpërmjet pajisjeve digjitale dhe internetit.

Hulumtoni bullizmin kibernetik dhe shpjegoni se çfarë lloj sjelljeje devijuese është dhe si ta njihni atë. Jepni shembuj.

MOBINGU

Mobingu u përcaktua për herë të parë nga psikologu Hajnc Lajman në vitet 1980. Sipas tij, mobingu është ngacmim psikologjik në vendin e punës që përsëritet gjatë një periudhe të gjatë kohore. Më shpesh shoqërohet me të rritur dhe punonjës, por edhe me të rinj. Për shembull, mobingu konsiderohet nëse disa nxënës qëllimisht injorojnë, poshtërojnë ose tallen vazhdimisht me një shok klase në mënyrë që ta largojnë atë nga grupi. Një karakteristikë kryesore e mobingut është ngacmimi sistematik dhe afatgjatë.



Vandalizmi ka forma të ndryshme

Vandalizmi është shkatërrimi ose dëmtimi i qëllimshëm i pronës së dikujt tjetër. Te të rinjtë kjo mund të manifestohet përmes thyerjes së furnizimeve shkollore, shkrimit të grafitëve në mure, shkatërrimit të bankave dhe rekuizitave të fëmijëve në parqe, dëmtimit të monumenteve. Shpesh ndodh në grup, nën ndikimin e presionit të bashkëmoshatarëve ose dëshirës për të provuar veten. Të gjitha këto fenomene njihen nga fakti se ato shkaktojnë dëme, të cilat mund të jenë fizike, psikologjike ose materiale, ndërsa prishin sigurinë e komunitetit.

NEPOTIZMI DHE KRONIZMI

Nepotizmi dhe kronizmi janë forma të favorizimit (dhënies së përparësisë) ndaj dikujt bazuar në marrëdhënie të vendosur. Ato shpesh shkojnë krah për krah me korrupsionin. Nepotizmi (në latinisht nepos do të thotë nip) është fenomen kur një person në pushtet ose një person me autoritet u jep përparësi të afërmeve ose anëtarëve të familjes, pavarësisht nga kualifikimet e tyre. Nepotizmi ndodh më shpesh në punësim në institucione publike, duke u dhënë funksione ose privilegje. Për shembull, një drejtor i një institucioni publik punëson vëllain ose vajzën e tij, megjithëse ka kandidatë më të kualifikuar. Në këtë rast kriteri nuk është aftësia, por lidhjet familjare.



Keqpërdorimi i pushtetit e ngadalëson
zhvillimin shoqëror

Kronizmi, nga ana tjetër është dhënia e përparësisë jo të afërmeve, por miqve, bashkëpunëtorëve të ngushtë ose njerëzve me të njëjtat mendime politike. Marrëdhënia bazohet në lidhje personale ose miqësi të gjatë. Për shembull, një ministër i jep pozicion të rëndësishëm një miku të ngushtë nga partia, megjithëse ai nuk ka përvojën e duhur. Të dy dukuritë shkelin drejtësinë, mundësitë e barabarta dhe besimin në institucione, sepse vendimet nuk merren në bazë të meritës dhe kompetencës, por në bazë të marrëdhënieve personale.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Analizoni shembujt dhe më pas përcaktoni se cilin lloj sjelljeje devijuese e dalloni në secilin prej tyre:

1. Vozitja e motoçikletës pa patentë dhe kryerja e shkeljeve të rregullave të trafikut.
2. Rrahja midis të miturve me pasoja të rënda.
3. Një nxënës që fyen vazhdimisht një nxënës tjetër për shkak të pamjes ose suksesit të tij.
4. Dikush vizaton grafite në muret e shkollës pa leje.
5. Një mësimdhënës e nënçmon vazhdimisht një nxënës para klasës.
6. Në punë një shef poshtëron sistematikisht një punonjës.
7. Një nxënës bëhet kryetar i klasës vetëm sepse është i afërt me mësimdhënësin.
8. Një nxënës që është nip i një ministri merr një bursë.

PYETJE: Kush dëmtohet në situatat e përmendura? Ku është abuzimi i pushtetit? A është sjellja përsëritëse apo e organizuar? A ka përfitim personal në kurriz të të tjerëve?



MBANI MEND

Jo çdo kundërvajtje është e njëjtë me sjelljen devijuese. Kundërvajtja do të thotë shkelje e ligjit dhe vendosje e penaltetit, ndërsa sjellja devijuese është çdo sjellje që devijon nga rregullat shoqërore, edhe kur nuk është e paligjshme. Çdo kundërvajtje është devijuese, por jo çdo devijuese është kundërvajtje. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të njihni këto terma. Kjo do t'ju ndihmojë të dalloni ç'është e dëmshme ose e padrejtë, të mos i nënshtroheni ndikimeve të këqija dhe të dini si të reagoni në situata bullizmi ose dhune. Duke vepruar kështu, ju kontribuoni në mjedis më të sigurt dhe marrëdhënie më të mira me të tjerët.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Jepni shembuj të secilit prej llojeve të mëposhtme të sjelljes devijuese: krim, varësi, dhunë, vandalizëm dhe shpjegojini ato.
2. Cilat lloje të sjelljes devijuese mendoni se janë më të zakonshme te të rinjtë dhe cilat te të rriturit dhe pse?
3. Çfarë lloj sjelljeje devijuese është delikuenca e të miturve?
4. Cilat lloje të sjelljes devijuese janë krimi dhe korrupsioni?
5. Shpjegoni ngacmimin kibernetik me një shembull.
6. Jepni një shembull në të cilin një sjellje devijuese çon në tjetër.
7. Çfarë pasojash krijohen nga sjellja devijuese tek individit dhe shoqëria?
8. Cilat masa mund të ndihmojnë në parandalimin e sjelljes devijuese?

17. VARËSITË

„Njerëzit me një varësi të caktuar shpesh etiketohen dhe gjykohen nga të tjerët, gjë që e ndërlikon më tej situatën e tyre.”

– Erving Goffman

Ç'DO TË THOTË VARËSI/TË?

Nga pikëpamja mjekësore, varësia përkufizohet si sëmundje kronike neurologjike. Për mjekët është ndryshim në proceset e trurit që bën që një person të ndiejë një nevojë (nxitje) të fortë për të përdorur një substancë të caktuar ose për të përsëritur një sjellje të caktuar, edhe pse e dinë se është e dëmshme për të. Pra, për mjekësinë, varësia është problem shëndetësor që kërkon trajtim. Nga pikëpamja sociologjike varësia konsiderohet si fenomen shoqëror dhe formë e sjelljes devijuese. Sociologët janë të interesuar se si familja, shoqëria, bashkëmoshatarët, statusi social, stresi ose media ndikojnë në shfaqjen e varësive. Ata e shohin varësinë si rezultat të kushteve dhe ndikimeve shoqërore, e jo vetëm si problem personal dhe shëndetësor.

ÇFARË LLOJ VARËSISH KRIJOHEN NË SHOQËRITË E SOTME?

Në shumicën e shoqërive format më të zakonshme të varësisë janë varësitë nga cigaret, alkooli, droga ose bixhozi. Në shoqëritë bashkëkohore, përveç këtyre varësive, flasim gjithnjë e më shumë për varësinë nga interneti, mediat sociale dhe videolujërat. Varësia nga ushqimi i shpejtë ose pijet energjike shfaqet gjithashtu gjithnjë e më shpesh. Këto varësi përhapen shpejt dhe bëhen lehtësisht të arritshme sepse dikush i paraqet ato si normale ose moderne, ndërsa nën presionin e bashkëmoshatarëve dhe medias, disa të rinj i pranojnë ato më lehtë. Adoleshentët janë kategori veçanërisht e prekshme sepse zakonet dhe karakteri formohen në moshën e tyre. Ndërgjegjësimi për pasojat (shëndeti i dëmtuar, problemet në shkollë, konfliktet me familjen dhe humbja e vetëbesimit) i ndihmon të rinjtë ta njohin rrezikun në kohë dhe t'i rezistojnë atij. Informacioni dhe ndërgjegjësimi janë hapat e parë drejt mbrojtjes dhe ndërtimit të një stili jetese të shëndetshëm.

Ç'ËSHTË TOKSIKOMANIA DHE CILAT JANË PASOJAT E TIJ?

Toksikomania është term që përdoret për të përshkruar varësinë nga substancat psikoaktive që ndikojnë në trurin, humorin dhe sjelljen e një personi. Kjo do të thotë se ata kanë nevojë të vazhdueshme për të përdorur një ilaç ose substancë të caktuar kimike, edhe pse e dinë se është e dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre. Me kalimin e kohës trupi mësohet me të, kështu që personi ka nevojë për një sasi gjithnjë e më rritje për të ndjerë të njëjtin efekt. Toksikomania i referohet varësisë nga heroína, kokaina, marihuana ose qetësuesit pa recetën e mjekut. Ky grup mund të përfshijë edhe thithjen e kimikateve të dëmshme (ngjitës, hollues), etj.

Toksikomania ka pasoja të rënda personale dhe sociale. Në nivel personal, pasojat janë: shëndet i dëmtuar fizik dhe mendor, probleme në shkollë ose në punë, e më shumë. Në nivel social ajo çon në konflikte në familje dhe izolim social. Të varurit nga droga stigmatizohen shoqërisht dhe shpesh janë të izoluar nga shoqëria. Prandaj është e rëndësishme që të rinjtë të jenë të informuar dhe të vetëdijshëm për rreziqet dhe të mos lejojnë që kurioziteti ose presioni i bashkëmoshatarëve t'i çojë ata në varësi që është e vështirë për t'u kapërcyer.

ALKOOLIZMI

Alkoolizmi është varësi (dhe sjellje devijuese) e karakterizuar nga një nevojë e vazhdueshme për të konsumuar sasi të mëdha pijesh alkoolike. Zhvillohet gradualisht. E gjitha fillon me përdorimin e rastësishëm të pijeve alkoolike për argëtim dhe relaksim, e më pas përparon në konsum të rregullt dhe të pakontrolluar. Personi i varur nga alkooli ka probleme në familje, në shkollë ose në punë dhe ka vështirësi të lërë pa ndihmën e profesionistëve.

Alkoolizmi është i lidhur ngushtë me fenomenin e quajtur **pirje** (alkool). Ky fenomen është pjesë e disa traditave dhe ritualeve. Megjithatë, është e rëndësishme të dihet se konsumi i tepërt i „pirjes“ së alkoolit çon në probleme shëndetësore dhe shpesh zhvillohet në alkoolizëm.

Nga analizat dhe statistikat e Organizatës Ndërkombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (OECD) të publikuara në vitin 2025, mësojmë se përdorimi i alkoolit te të rinjtë (në botë dhe në vendin tonë) është rritur ndjeshëm. Rreth 60% e të rinjve të moshës pesëmbëdhjetë vjeç e kanë provuar alkoolin një herë. Rreth 38% kanë konsumuar alkool një muaj para anketës, ndërsa rreth 22% janë dehur disa herë, gjë që është shenjë e përdorimit serioz të alkoolit tek adoleshentët.

Hulumtimet në kuadër të disa studimeve ballkanike tregojnë se 50% e adoleshentëve në Maqedoni, të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, kanë provuar alkoolin të paktën një herë, rreth 35% kanë konsumuar alkool një muaj para anketës dhe 13% e djemve dhe 10% e vajzave janë dehur në të njëjtën periudhë. Këto të dhëna nuk do të thotë se të gjithë do të bëhen alkoolikë, por ato tregojnë se përdorimi i alkoolit tek adoleshentët është fenomen i zakonshëm dhe shqetësues.

NIKOTINIZMI

Nikotinizmi është varësi ndaj duhanit dhe nikotinës, e cila manifestohet në pirjen e rregullt të cigareve ose produkteve të tjera të duhanit. Nga një perspektivë sociologjike, nuk është vetëm zgjedhje personale, por një fenomen që lidhet ngushtë me ndikimet dhe presionet shoqërore. Disa pinë duhan për të ulur stresin, të tjerë për kënaqësi dhe disponim, ndërsa të tjerë për shkak të ndikimit të bashkëmoshatarëve, medias, prindërve (duhanpirësve) dhe disponueshmërisë së produkteve të duhanit. Sociologët e shohin nikotinizmin si formë sjelljeje devijuese që tregon ndikimin e mjedisit shoqëror në zgjedhjet dhe zakonet e të rinjve.

Sot pirja e duhanit konsiderohet si një nga rreziqet më të zakonshme shëndetësore në botë, veçanërisht te të rinjtë. Konsumi i alkoolit shkakton probleme personale, familjare dhe shoqërore. Sipas Organizatës Botërore



Konsumi i alkoolit shkakton probleme personale, familjare dhe shoqërore

të Shëndetësisë rreth 10.8% e adoleshentëve të moshës trembëdhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjeç përdorin duhan, që do të thotë se miliona të rinj janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të nikotinës dhe substancave të tjera toksike në cigare. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut situata është shqetësuese: shkalla e pirjes së duhanit te të rinjtë nën tetëmbëdhjetë vjeç arrin rreth 40%, ndërsa një pjesë e madhe e tyre provojnë cigare rreth moshës trembëdhjetë vjeç. Pirja e duhanit nuk është vetëm zakon, por varësi që është vështirë për t'u kapërcyer. Dëmi më i madh nga pirja e duhanit shkaktohet nga nikotina, e cila ka një efekt të dëmshëm në tru dhe rrit rrezikun e sëmundjeve kronike. Për të zvogëluar pirjen e duhanit te të rinjtë, parandalimi është thelbësor dhe përfshin edukimin në shkolla, mbështetjen psikologjike për të krijuar një neveri ndaj pirjes së duhanit, masa dhe kontrollë më të rrepta mbi shitjen e cigareve te të miturit, etj.



Pirja e duhanit: një zakon që shkakton pasoja serioze për shëndetin

VARËSIA NGA TEKNOLOGJIA

Sociologët varësinë moderne ndaj teknologjisë e quajnë **varësi digjitale ose teknologjike**. Kjo do të thotë se dikush ka nevojë të vazhdueshme dhe të pakontrolluar që të jetë në telefonin, kompjuterin ose mediat sociale dhe mezi mund të kalojë një ditë pa to.

Vitet e fundit interneti është bërë pjesë e domosdoshme e jetës së përditshme të të rinjve, si në botë ashtu edhe në vendin tonë. Ai u lejon atyre komunikim më të lehtë, qasje në informacion, të mësuarit përmes platformave digjitale dhe zhvillimin e shkathtësive digjitale. Përmes mediave sociale ata mbajnë kontakte me shokët, ndajnë përvoja dhe marrin pjesë në komunitete të ndryshme digjitale. Për shumë njerëz interneti gjithashtu është një hapësirë për kreativitet, argëtim dhe informacion. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se sot një pjesë e madhe e të rinjve ndiejnë nevojë të vazhdueshme që të jetë në internet dhe se dita e tyre fillon dhe mbaron duke kontrolluar mesazhe, video ose njoftime.

Prandaj lind pyetja se teknologjia a na shërben, apo bëhemi të varur prej saj.

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikave, pothuajse të gjithë të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të moshës pesëmbëdhjetë deri në njëzet e katër vjeç përdorin internetin, ndërsa një pjesë e

madhe e tyre janë të lidhur me internetin çdo ditë. Hulumtimet tregojnë se më shumë se 97% e të rinjve hyjnë në internet disa herë në ditë, që do të thotë se ata janë pothuajse vazhdimisht të lidhur përmes telefonave celularë, tabletave ose kompjuterëve. Një studim i kryer nga Instituti për Kërkime Sociologjike, Politike dhe Ligjore tregon të dhëna shqetësuese, përkatësisht se më shumë se gjysma e nxënësve të shkollave të mesme të anketuara tregojnë shenja të përdorimit problematik të internetit. Ata



Interneti na lidh me të gjithë botën, por na distancon nga ata që ulen pranë nesh

kalojnë shumë kohë të lidhur me internetin, kanë vështirësi në kontrollin e përdorimit të tyre dhe ndihen të shqetësuar kur nuk kanë qasje në internet. Për disa adoleshentë koha e kaluar në mediat sociale dhe duke luajtur lojëra online tejkalon pesë orë në ditë.

Sipas një ankete të vitit 2023 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në 62% e të rinjve ishin pothuajse vazhdimisht në Instagram dhe 17% pothuajse vazhdimisht në TikTok. Rreth 70% përdornin YouTube çdo ditë dhe 47% Snapçat. Mesatarisht adoleshentët kalonin 4.8 deri në 5.3 orë në ditë në mediat sociale. Pothuajse të gjithë kishin një smartphone, që do të thotë se interneti ishte i disponueshëm për ta në çdo kohë. Një studim tjetër i kryer në Angli tregoi se 60% e fëmijëve flenë me telefonat e tyre celularë, nuk i fkin kurrë ose janë vazhdimisht të lidhur me internetin.

Nga kjo mund të konkludohet se të rinjtë janë kryesisht të varur nga pajisjet digjitale. Por ajo që është më e rëndësishme për ta është të kuptojnë se teknologjia në vetvete nuk është e keqe. Ajo lejon të mësuarit, informacionin, kreativitetin dhe lidhjen me njerëz nga e gjithë bota. Problemi lind kur ajo fillon të menaxhojë kohën, humorin dhe vetëbesimin e tyre.

Nëse nuk mund të shkëputeni nga telefoni juaj, nëse ndiheni të shqetësuar kur nuk keni internet, ose nëse i neglizhoni përgjegjësitë tuaja për shkak të mediave sociale, kjo do të thotë se jeni të varur nga ajo digjitale dhe duhet të bëni një pushim. Mesazhi është i qartë: përdorni teknologjinë, por mos e lini t'ju përdorë. Vendosi kufij. Lini mënjane kohë për të mësuar, për t'u çlodhur dhe për t'u shoqëruar personalisht. Kultivoni miqësi të vërteta, bëni ushtrime, lexoni, flisni me familjen tuaj. Koha, vëmendja dhe shëndeti juaj janë më të vlefshme se çdo pëlqim ose ndjekës. Teknologjia duhet të jetë një mjet që ju ndihmon të përparoni, jo një mjet që ju shpërqendron nga jeta reale.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni historinë „Një ditë nga jeta e Sarës” dhe më pas përgjigjuni pyetjeve.

Sara (16 vjeç) ka orarin e mëposhtëm ditor: Në orën 07:00 zgjohet dhe kontrollon rrjetet sociale për 20 minuta; nga ora 08:00 deri në orën 14:00 është në shkollë dhe përdor telefonin gjatë pushimeve (rreth 60 minuta); në orën 15:00 shikon video gjatë drekës (30 minuta);

nga ora 16:00 deri në orën 18:00 mëson dhe shkruan detyrat e shtëpisë, por në të njëjtën kohë kontrollon mesazhet (rreth 40 minuta);

nga ora 19:00 deri në orën 21:30 luan lojëra në internet dhe kontrollon rrjetet sociale (2.5 orë);

në orën 22:30, para se të shkojë në shtrat, qëndron në telefon edhe për 30 minuta.

Pyetje: Sa kohë kalon Sara në pajisjet digjitale? Krahasoni orarin e saj me tuajin. A është kjo kohë reale?; Çfarë aktivitete mund të bënte Sara pa një ekran?

AKTIVITETI 2. Në fletoren tuaj krijoni tabelën tuaj dhe plotësojeni atë, pastaj llogaritni kohën që ju nevojitet për aktivitetet e mëposhtme:

Aktiviteti	Koha (minuta/orë)
Media sociale	
Lojërat	
YouTube/Netflix	
Mesazhet	
Mësimin e kompjuter	

Pyetje: A jeni të befashuar nga numri? Cila pjesë e përdorimit është e nevojshme dhe cila është zakon? A mund të kaloni një ditë me 50% më pak kohë në pajisjet digjitale? Cila do të ishte më e vështira për t'u reduktuar?



MBANI MEND

Në shoqërinë moderne janë shfaqur varësi që prekin të rinjtë gjithnjë e më shpesh. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të rinjtë të dinë se ç'është varësia, si zhvillohet dhe cilat janë pasojat e saj. Ndërgjegjësimi është hapi i parë drejt mbrojtjes. Kur të rinjtë i njohin shenjat e hershme, ata mund të vendosin më lehtë kufij, të kërkojnë ndihmë dhe të marrin vendime të përgjegjshme.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është varësia?
2. Cilat janë llojet më të zakonshme të varësisë?
3. Shpjegoni nëpërmjet shembujve specifikë cilat janë shkaqet e disa varësive?
4. Çfarë llojesh varësie mund të identifikoni në mjedisin tuaj të afërt?
5. Cilat zakone të shëndetshme mund të ndihmojnë në parandalimin ose zvogëlimin e varësive?
6. Shpjegoni nëpërmjet shembujve cilat janë pasojat e varësive?
7. Shpjegoni se si përdorimi i tepërt i telefonave celularë, rrjeteve sociale dhe internetit bëhet varësi.

1. GRUPET SHOQËRORE

RËNDËSIA DHE PËRCAKTIMI I GRUPEVE

Grupet janë një nga dimensionet më të rëndësishme të jetës shoqërore njerëzore. Njeriu nuk mund të jetojë i izoluar – ai është qenie shoqërore që, në fund të fundit, zhvillohet në grupe të ndryshme. Të gjitha ato formojnë qëndrimet, sjelljen dhe identitetin e tij. Grupet janë të rëndësishme jo vetëm për mbijetesën biologjike, por edhe për zhvillimin psikologjik dhe shoqëror. Prandaj disa sociologë e përcaktojnë sociologjinë si studimin e grupeve.

Grupet mund të ndryshojnë në numrin e anëtarëve, shkallën e organizimit, afërsinë ndërpersonale dhe qëndrueshmërinë. Megjithatë, të gjitha grupet shoqërore kanë disa elemente të përbashkëta. Së pari, anëtarët e tyre angazhohen në një lloj aktiviteti të përbashkët. Së dyti, ata bashkëveprojnë dhe kanë krijuar marrëdhënie. Së treti, ata ndajnë vlera dhe norma të caktuara. Përveç kësaj, çdo grup ka një shkallë të caktuar kohezioni, ose lidhjeje, midis anëtarëve të tij. Janë pikërisht këto elemente që dallojnë grup nga grumbullimet e rastësishme të njerëzve, siç është turmë para një dyqani ose një turmë në rrugë.

Grupi nuk është vetëm një grupim individësh, por një komunitet me identitet të përbashkët. Sociologu gjerman Verner Zombart e përshkruan grupin si një tërësi shpirtërore dhe shoqërore, në të cilën anëtarët kanë ndjenjën e përkatësisë. Kjo do të thotë se ata ndihen si „ne” dhe e udhëheqin sjelljen e tyre në përputhje me normat dhe rrethanat.

Ndjenja e përkatësisë është e rëndësishme në marrëdhëniet me grupet e tjera. Çdo grup mbahet i bashkuar nga ndryshimi midis „neve” dhe „atyre”. Sociologët amerikanë Viliam Samner dhe Çarls Kuli prezantuan konceptin e „brenda grupit” (in-group) dhe „jashtë grupit” (out-group). „Brenda grupi” është grupi me të cilin identifikohemi dhe ndihemi të pranuar, siç janë familja ose shokët e ngushtë. „Jashtë grupi” përjetohet

si i ndryshëm ose konkurrues, siç janë ekipet e tjera sportive ose grupet e tjera shkollore.



Grup miqsh – miqtë janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë

LLOJET E GRUPEVE

Grupet në shoqëri mund të dallohen sipas kriterëve të ndryshme, siç janë: madhësia, kohëzgjatja, shkalla e afërsisë ndërmjet anëtarëve dhe shtrirja e tyre. Çdo grup ka karakteristikat e veta dhe ndikohet nga anëtarët e tij në mënyra të ndryshme. **Grupet e hapura** janë ato në të cilat anëtarësimi në grup nuk është i kufizuar në mënyrë strikte. Ato lejojnë

anëtarët e rinj të bashkohen lirisht dhe vullnetarisht dhe të marrin pjesë në aktivitete. Shembuj të grupeve të tilla janë klubet e fitnesit dhe shoqatat sportive. **Grupet e mbyllura** kanë numër të kufizuar anëtarësh dhe kriteret të rrepta për anëtarësim. Anëtarët e rinj rekrutohen vetëm pasi të përmbushin kërkesat ose të marrin miratimin nga grupi. Për shembull, klubet e shahut elitare dhe grupet profesionale (mjekë, avokatë).



Analizoni se çfarë lloj grupi shkollor është klasa shkollore!

Grupet primare janë të vogla, të ngushta dhe grupe intime ku ka lidhje të forta emocionale midis anëtarëve. Familja ose shokët më të ngushtë janë shembuj tipikë. Në këto grupe ekziston besim i ndërsjellë, komunikim dhe respekt për rregullat dhe normat. **Grupet sekondare** janë grupe më të mëdha, formale të krijuara për të arritur qëllime specifike. Anëtarësimi nuk bazohet në lidhje të ngushta, por në detyrat që ka secili anëtar. Grupe të tilla janë parti politike.

Grupet globale përfshijnë njerëz nga vende dhe kultura të ndryshme, të lidhur me interesa dhe qëllime të përbashkëta. Mediat sociale, organizatat ndërkombëtare si OKB-ja, ose shoqatat globale mjedisore janë shembuj të grupeve të tilla. **Grupet e pjesshme** janë të kufizuara në fushë specifike të jetës, siç është shkolla, sporti, puna ose hobi. Anëtarësimi dhe marrëdhëniet në këto grupe ekzistojnë vetëm në atë fushë specifike. Për shembull, një ekip shkollor i mundjes ose një klub libri. **Grupet e përkohshme** formohen për një periudhë të shkurtër kohore dhe për një qëllim specifik. Kur arrijnë qëllimin e tyre, ato zhduken. Shembuj të grupeve të tilla janë grup nxënësish që organizojnë pazar bamirësie shkollor ose një ekip që organizon trajnim/seminar. **Grupet e qëndrueshme** ekzistojnë për një periudhë më të gjatë kohore dhe kanë strukturë të qëndrueshme. Familja, shokët afatgjatë ose shoqatat profesionale janë shembuj të grupeve të qëndrueshme. **Grupet e vogla** kanë numër të vogël anëtarësh dhe lejojnë marrëdhënie të ngushta. Për shembull, një grup prej pesë deri në dhjetë shokë që janë në kontakt çdo ditë. **Grupet e mëdha** kanë shumë anëtarë dhe zakonisht janë formale ose sekondare. Në to lidhjet personale janë më pak të zhvilluara dhe struktura organizative është më e rëndësishme. Shembuj të grupeve të tilla janë klasa jote, ekip i madh sportiv ose kompani.

Grupet shoqërore ndërtojnë të gjithë shoqërinë. Ato janë «tullat ndërtuese» që i mundësojnë shoqërisë të funksionojë, të zhvillohet dhe të krijojë institucione dhe vlera të reja kulturore. Pa grupe njerëzit do të ishin të izoluar dhe shoqëria do të ishte e paqëndrueshme dhe jofunksionale. Grupet ofrojnë bazën për kohezion dhe identitet shoqëror, prandaj ato luajnë një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Përcaktoni se cilave grupe u përkisni! Shpjegoni cilat karakteristika ju bëjnë unikël; Çfarë nevojash plotësoni në grupet ku bëni pjesë? Cilin grup do të veçonit/nëse është veçanërisht i rëndësishëm për ju dhe pse?

AKTIVITETI 2. Përcaktoni se cilit lloj grupi shoqëror i përket secila nga sa vijon dhe shpjegoni cilat karakteristika identifikoni:

1. Kori i shkollës;
2. Publiku në ndeshje futbolli;
3. Njerëzit që presin autobusin;
4. Të rinjtë në diskotekë;
5. Ekipi i punës në kompani;
6. Një grup i vogël miqsh dhe
7. Ekipi për organizimin e argëtimit shkollor.



MBANI MEND

Njeriu, si qenie shoqërore, nuk mund të jetojë i izoluar, prandaj ai zhvillohet dhe vepron në grupe të ndryshme që formësojnë identitetin, sjelljen dhe qëndrimet e tij. Grupet nuk janë vetëm një tërësi individësh, por komunitete me vlera, norma dhe ndjenja të përbashkëta përkatësie. Ato ofrojnë komunikim, besim dhe bashkëpunim. Ato mund të jenë të madhësive, kohëzgjatjes dhe afërsisë së ndryshme, e për këtë arsye janë funksionale: parësore dhe dytësore, të përkohshme dhe të përhershme, të hapura dhe të mbyllura. Përmes grupeve njeriu mëson, bashkëpunon dhe integrohet në shoqëri, dhe, nga ana tjetër është baza për strukturën shoqërore dhe stabilitetin e shoqërisë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cilat janë karakteristikat kryesore të një grupi shoqëror?
2. Si ndryshon një grup shoqëror nga një grup i rastësishëm njerëzish?
3. Pse njerëzit duhet t'u përkasin grupeve shoqërore?
4. Ç'do të ndodhte nëse njerëzit nuk do t'i përkisnin asnjë grupi shoqëror?
5. Shpjegoni pse grupet shoqërore janë të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë?
6. Cilat grupe shoqërore kanë ndikimin më të madh te të rinjtë sot?

2. ORGANIZATAT

KONCEPTI I ORGANIZATËS

Koncepti organizatë mund të kuptohet duke kuptuar origjinën e tij etimologjike. Fjala organizatë vjen nga fjala e lashtë greke organon, që do të thotë mjet, instrument, ndihmë. Kjo i referohet thelbit të organizatës: është mjet me të cilin njerëzit arrijnë qëllimet e tyre të përbashkëta. Në kuptimin sociologjik, organizatat janë sisteme të veçanta shoqërore dhe përfaqësojnë dimension specifik të grupeve shoqërore.

Ndërsa koncepti grup i referohet numrit të njerëzve dhe ndërveprimeve midis tyre, organizatë që përqendrohet në koordinimin e roleve, sjelljeve dhe veprimeve. Ajo mundëson koordinimin. Prandaj organizata mund të kuptohet si instrument që lidh individët për veprim të përbashkët dhe të drejtuar. Ky dimension i veprimit në grup është veçanërisht i dukshëm në ceremoni dhe ngjarje të ndryshme publike: dasma, seanca parlamentare, procedura gjyqësore, takime sindikale. Në to ekziston një shpërndarje e qartë e roleve dhe modeleve të paracaktuara të sjelljes.

Sociologu francez Zhorzh Gurviç i përcakton organizatat si sjellje kolektive të paracaktuara, të rregulluara në mënyrë hierarkike dhe qendrore, sipas skemave pak a shumë të përafërta. Ky përkufizim tregon se organizimi nuk është i rastësishëm, por i strukturuar nga rregulla të përcaktuara qartë. Edhe pse duket si një dimension abstrakt, organizimi është një fenomen konkret shoqëror. Ai bëhet real përmes roleve dhe detyrave të organizatorëve.

Organizata nganjëherë përfaqësohet nga njerëz specifikë – organizatorë ose koordinatorë. Ata kanë detyrën e udhëheqjes së grupit, shpërndarjes së përgjegjësisë dhe sigurimit që gjërat të shkojnë sipas planit. Ky lloj

quhet **organizatë formale** sepse ka role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë. Në raste të tjera nuk ka udhëheqës të veçantë. Të gjithë anëtarët marrin pjesë së bashku dhe marrin përsipër detyra të ndryshme sipas nevojës. Në këtë rast është **organizatë joformale** ku marrëdhëniet janë më të relaksuara dhe nuk ka ndarje të rreptë të roleve.

Organizimi është parakusht i domosdoshëm për veprim efektiv kolektiv. Nevoja për organizim lind nga disa faktorë. Së pari, çdo veprim kolektiv kërkon ndarjen në role. Së dyti, një nga këto role është udhëheqja ose



Çdo individ ka rolin e vet në organizatë

menaxhimi i të tjerëve. Së treti, menaxhimi kërkon njohuri dhe aftësi specifike që zotërohen nga një numër i vogël njerëzish. Paralelisht me këtë, anëtarët e mbetur mund të bëhen gradualisht pasivë dhe të krijojnë kulturë të veçantë organizative me vlerat dhe normat e tyre. Organizimi është instrument i domosdoshëm i shoqërisë moderne. Ai mundëson rendin, koordinimin dhe arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Megjithatë, analizat kritike tregojnë se, nëse lihet pa u kontrolluar, vetë organizata tenton të distancohet nga anëtarët e grupit ose nga shoqëria. Këtë fenomen, sociologu i njohur Robert Mihels e quajti „ligji i hekurt i oligarkisë“. Sipas tij, *çdo organizatë në mënyrë të pashmangshme shndërrohet në oligarki (pushtet për pak njerëz që nuk kanë interesa të caktuara) me kalimin e kohës.*

LLOJET E ORGANIZATAVE

Në sociologji, ekzistojnë ndarje të ndryshme të organizatave, ndërsa një nga kryesoret është ndarja në organizata formale dhe joformale. Shkollat, spitalet, ushtria ose kompanitë shpesh citohen si shembuj të **organizatave formale**. Megjithatë, një organizatë nuk duhet të kuptohet si ndërtesë ose si objekt material. Ajo përfaqëson një aspekt specifik të një grupi – mënyrën se si anëtarët e saj janë të lidhur, të koordinuar dhe të drejtuar drejt qëllimeve të përbashkëta.

Kur një shkollë referohet si organizatë formale, ajo kuptohet si model sipas të cilit organizohen faktorët: nxënësit, mësimdhënësit, drejtori, shërbimet profesionale dhe personeli tjetër. Ky model nënkupton qëllime të përcaktuara saktësisht, rregulla të përcaktuara qartë dhe ndarje hierarkike të roleve. Të gjithë e dinë se ç'është përgjegjëse dhe kush është përgjegjës për çfarë.

Për shkak të kësaj strukture marrëdhëniet në organizatën formale janë formale dhe racionale. Ato bazohen në ekspertizë, profesionalizëm, respekt për rregullat dhe marrëdhënie jopersonale. Kështu, organizata shfaqet si sistem i rregullt që mundëson arritjen efikase të qëllimeve të përbashkëta.

E gjithë kjo tregon se zhvillimi teknologjik sjell përparim ekonomik, por në të njëjtën kohë krijon presione të reja mbi punëtorët. Për të zvogëluar këto rreziqe është i nevojshëm arsim cilësor, rikualifikim i vazhdueshëm dhe ligje të qarta që do të mbrojnë të drejtat e punëtorëve në epokën digjitale.

KONFLIKTET EKONOMIKE

Ekonomia e tregut dhe kapitaliste nga vetë natyra e tyre krijojnë konkurrencë. Në ekonomi burimet – paratë, vendet e punës, toka dhe kapitali – janë të kufizuara, por ato kërkohen ose përdoren. Kjo krijon dallime midis njerëzve: disa fitojnë më shumë, të tjerët më pak; disa kanë vende pune të sigurta, të tjerët jo. Këto pabarazi mund të çojnë në **konflikte ekonomike**.

Më të zakonshmet janë konfliktet në vendin e punës. Ato lindin kur punëtorët dhe punëdhënësit kanë interesa kontradiktore. Punëtorët duan paga më të larta, kushte më të mira pune dhe siguri, ndërsa punëdhënësit përpiqen të ulin kostot dhe të fitojnë më shumë fitim. Për shembull, nëse një kompani vendos të rrisë pagat përveç rritjes së fitimeve, punëtorët mund të organizojnë protestë ose grevë. Në mënyrë të ngjashme futja e teknologjive të reja që zëvendësojnë punëtorët manualë mund të shkaktojë pakënaqësi dhe frikë nga humbja e vendeve të punës.



Marshim protestues për Ditën e Punës në Shkup

Kur ndodhin konflikte të mëdha, sindikatat luajnë një rol të rëndësishëm. **Sindikatat** janë organizata punëtorësh që përfaqësojnë interesat e tyre para punëdhënësve dhe shtetit. Sindikatat u shfaqën për herë të parë në Britaninë e Madhe gjatë Revolucionit Industrial, kur punëtorët punonin në kushte të vështira dhe të pasigurta. Duke u bashkuar, ato u bënë më të fuqishme në negociata.

Sot sindikatat negociojnë pagat dhe kushtet e punës përmes marrëveshjeve kolektive, mbrojnë të drejtat e punëtorëve dhe organizojnë greva kur është e nevojshme. Për shembull, nëse punëtorët nuk i marrin pagat e tyre në kohë ose punojnë jashtë orarit pa kompensim, sindikata mund të ngrëjë padi ose të organizojë protestë. Kjo ushtron presion mbi punëdhënësin që të respektojë rregullat e rëna dakord.

Nga ana tjetër punëdhënësit organizohen gjithashtu në odat e tregtisë ose shoqatat e biznesit për të përfaqësuar interesat e tyre. Në shumë vende evropiane çështjet e rëndësishme ekonomike (paga minimale ose të drejtat e punëtorëve) zgjidhen përmes dialogut social. Ai përfshin sindikatat (si përfaqësues të punëtorëve), odat e tregtisë (si përfaqësues të punëdhënësve) dhe qeverinë. Ky sistem trepalësh ndihmon që konfliktet të zgjidhen përmes diskutimit, në vend që të zgjidhen përmes grevave të zgjatura ose paqëndrueshmërisë.

Në kohë ndryshimesh të shpejta teknologjike, kur shfaqen profesione të reja dhe disa zhduken, dialogu social bëhet edhe më i rëndësishëm. U mundëson punëtorëve të marrin mbështetje, rikualifikim dhe mbrojtje më të mirë, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin ekonomik. Prandaj konfliktet ekonomike janë pjesë normale e ekonomisë moderne dhe zgjidhja e tyre e suksesshme varet nga sindikatat e forta, punëdhënësit përgjegjës dhe një rol aktiv i shtetit.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni me kujdes tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve:

„Puna në shtëpi mode, moda e shpejtë dhe konsumizmi“

Një shtëpi mode që është markë globale dhe një nga përfaqësueset kryesore të modës së shpejtë është bërë sinonim i një kulture „bli dhe hidh“, duke krijuar sasi të mëdha tekstilësh që ushtrojnë presion të konsiderueshëm mbi mjedisin. Prodhimi kërkon sasi të mëdha uji dhe energjie, ndërsa materialet konvencionale kontribuojnë në degradimin e ekosistemeve dhe ndryshimet klimatike. Përveç kësaj, fabrikat furnizuese shpesh punësojnë grupe të cenueshme punëtorësh, veçanërisht gra dhe fëmijë, me paga të ulëta dhe kushte të pasigurta.

PYETJE: Si e inkurajon ndryshimi i shpejtë i koleksioneve një kulturë „bli dhe hidh“ dhe konsumin e tepërt? Cila është kostoja e vërtetë ekologjike e prodhimit masiv të veshjeve dhe mbetjeve tekstile që përfundojnë në natyrë? Si i dëmton industria e modës së shpejtë grupet e cenueshme, veçanërisht gratë dhe fëmijët në fabrikat e furnizuesve të saj? A mund t'i zvogëlojnë koleksionet „e qëndrueshme“ dhe përdorimi i materialeve të ricikluara dëmet themelore mjedisore dhe sociale të modës së shpejtë? Sa ndikon ky informacion në vendimin tuaj të ardhshëm për të blerë një veshje të re?

AKTIVITETI 2. Analizoni zakonet tuaja si konsumator! Sa shpesh blini rroba? A mendoni se një veshje e re ose një mbulesë telefoni, një palë këpucë të reja ose një model i ri iPhone ose kufjesh është i nevojshëm? Vlerësoni zakonet tuaja si konsumatorë? Mendoni se cilat zakone ndikojnë në mjedis?



MBANI MEND

Ekonomitë moderne përballen me ndryshime teknologjike dhe digjitale që rrisin produktivitetin, por krijojnë sfida të reja për punëtorët, siç janë papunësia, trajnimi i tepërt dhe pasiguria. Automatizimi dhe inteligjenca artificiale i ndryshojnë vendet e punës tradicionale, ndërsa zhvillimi i qëndrueshëm dhe konsumi i përgjegjshëm janë çelësi për mbrojtjen e mjedisit. Konfliktet ekonomike janë rezultat i pabarazive dhe interesave të ndryshme të punëtorëve dhe punëdhënësve, ndërsa zgjidhja e tyre varet nga sindikatat, organizatat e biznesit dhe dialogu social.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cilat janë sfidat me të cilat përballen ekonomitë moderne?
2. Si mund të ndikojë zhvillimi ekonomik në mjedis? Jepni shembuj të problemeve mjedisore.
3. Pse teknologjitë moderne krijojnë nevojë për njohuri dhe aftësi, nevojë për të mësuar gjatë gjithë jetës?
4. Hulumtoni se si inteligjenca artificiale dhe automatizimi ndikojnë në punësim dhe standardet e jetesës?
5. Cili është roli i të rinjve në kapërcimin e sfidave të ekonomisë moderne?

8. POLITIKA

POLITIKA: KONCEPTI

Shpesh e dëgjojmë fjalën **politikë** në jetën e përditshme. Flasim për politikën e një qeverie, politikën e një partie politike, shëndetësinë, arsimin ose politikën ekonomike. Përmenden edhe konfliktet politike, krizat politike, sjellja politike. Megjithatë, në shkencë përdoren shprehje siç janë sistemi politik, pushteti politik, procesi politik ose elita politike. Të gjitha këto shprehje tregojnë se politika lidhet me menaxhimin dhe organizimin e shoqërisë.

Fjala politikë është me origjinë të lashtë greke. Në thelb, ajo i referohet menaxhimit ose qeverisjes së një komuniteti. Kjo do të thotë se politika është procesi me të cilin merren vendime se si do të funksionojë një shoqëri – si do të ndahen burimet, cilat rregulla do të zbatohen, si do të zgjidhen problemet. Politika, pra, është mënyrë për të qeverisur shoqërinë ose pjesët e saj individuale, siç janë komunat, rajonet ose shtetet.

Megjithatë, jo çdo grup njerëzor mund të thuhet se ka politikë. Për shembull, në familje, marrëdhëniet më shpesh bazohen në afërsi dhe lidhje natyrore, sesa në qeverisje joformale. Politika lind aty ku shoqëria është më e madhe, më komplekse dhe e përbërë nga njerëz të ndryshëm me interesa të ndryshme. Atëherë nevojitet një sistem rregullash, institucionesh dhe autoriteti për të koordinuar këto dallime.

Në kuptim historik politika lind kur njerëzit ndalojnë së jetuari në bashkësi të vogla farefisnore, siç janë klanet dhe fiset, ndërsa fillojnë të krijojnë shoqëri më të mëdha dhe më komplekse. Me fjalë të tjera, politika fillon aty ku nuk ka unitet të plotë në rastet kur është e nevojshme të menaxhohen dallimet.

Edhe pse shpesh themi se gjithçka është politikë, është e rëndësishme të kuptojmë se politika është vetëm pjesë e jetës sonë. Ajo lidhet me menaxhimin e komunitetit dhe marrjen e vendimeve që prekin të gjithë, por përfshin të gjithë përvojën njerëzore.

FUQIA DHE PUSHTETI SI MJETE TË POLITIKËS

Politika qeveris shoqërinë përmes **fuqisë dhe pushtetit**. Me ndihmën e tyre merren vendime, vendosen rregulla dhe sigurohet zbatimi i tyre. Pa fuqinë dhe pushtetin politika nuk do të mund të funksiononte.



Votim në zgjedhjet politike



Kryetar i grupit të nxënësve

Fuqia është e pranishme në të gjitha sferat e shoqërisë – jo vetëm në politikë, por edhe në ekonomi, media, kulturë dhe në marrëdhëniet e përditshme mes njerëzve. Sipas sociologut Maks Veber, fuqia është mundësia që dikush (një individ ose një grup) ta imponojë vullnetin e vet mbi të tjerët, edhe kur ata i kundërshtojnë. Kjo do të thotë se fuqia nënkupton epërsi – aftësinë që urdhri të zbatohet pavarësisht rezistencës.

Fuqia mund të ushtrohet në mënyra të ndryshme, por është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet forcës dhe pushtetit. Forca është forma më e ashpër e fuqisë. Ajo nënkupton që dikush të detyrohet të bëjë diçka pa shpjegim ose arsyetim – thjesht sepse „ashtu i është urdhëruar“.

Ndryshe nga forca, pushteti është fuqi legjitime. Kjo do të thotë se njerëzit e pranojnë pushtetin si të justifikuar dhe ndiejnë se është e drejtë ta respektojnë atë. Elementi kyç i pushtetit është legjitimiteti – pranimi se dikush ka të drejtë të urdhërojë. Për shembull, nxënësit e pranojnë që mësuesi të japë detyra, sepse ajo ka autorizim ligjor; fëmijët u binden prindërve, sepse kjo është pjesë e traditës dhe e përgjegjësisë ligjore; ndërsa një grup të rinjsh mund të ndjekë një udhëheqës, sepse ai ka autoritet personal dhe karizëm.

Sipas bazës mbi të cilën njerëzit e pranojnë, pushteti mund të jetë **ligjor, tradicional dhe karizmatik**. Këto tre lloje tregojnë pse dikush ka të drejtë të urdhërojë, ndërsa të tjerët ta dëgjojnë.

Pushteti ligjor mbështetet në rregulla dhe ligje. Ai është më i zakonshmi në shoqëritë bashkëkohore, ku marrëdhëniet rregullohen me kushtetuta, ligje dhe rregullore. Për shembull, drejtori i shkollës ka të drejtë të marrë vendime, sepse këtë ia lejon ligji. Një polic mund të shqiptojë gjobë, sepse vepron në bazë të autorizimeve ligjore. Qeveria merr vendime në kuadër të kushtetutës. Në të gjitha këto raste, njerëzit e pranojnë pushtetin sepse ai është i justifikuar juridikisht dhe i përcaktuar zyrtarisht.

Pushteti tradicional bazohet në zakone dhe rregulla të trashëguara. Ai pranohet sepse „kështu ka qenë gjithmonë“. Në disa familje, për shembull, anëtarë më të moshuar kanë autoritet të veçantë në marrjen e vendimeve. Në monarki mbreti ose mbretëresha sundojnë me trashëgimi mbi bazën e një tradite të gjatë historike. Këtu pushteti nuk buron nga një ligj bashkëkohor, por nga respektimi i së kaluarës dhe i zakoneve.

Pushteti karizmatik, nga ana tjetër, buron nga cilësitë personale të udhëheqësit. Njerëzit e ndjekin atë sepse i frymëzon, i motivon ose u ngjall besim. Për shembull, dikush mund të pranohet si udhëheqës i një grupi nxënësish sepse është i vendosur, komunikues dhe ka vizion të qartë. Në histori shumë udhëheqës kanë fituar mbështetje falë karizmës së tyre dhe aftësisë për t'i bindur të tjerët. Në këtë rast pushteti pranohet për shkak të autoritetit personal dhe jo për shkak të ligjit ose traditës.

Megjithatë këto tre lloje pushteti dallohen nga njëri-tjetri, në praktikë ato shpesh ndërthuren. Megjithatë, në shoqëritë demokratike bashkëkohore mbizotëron pushteti ligjor, sepse konsiderohet se qeverisja sipas rregullave dhe ligjeve është mënyra më e drejtë dhe më e qëndrueshme e ushtrimit të pushtetit.

Në shoqëritë bashkëkohore demokratike më i rëndësishmi është pushteti ligjor. Ai është i vendosur në kushtetutë dhe ligje dhe buron nga qytetarët. Prandaj rrjedh se sot sundimi i ligjit bazohet në pushtetin politik. Shteti, si organizata më e rëndësishme politike, ushtron pushtetin e tij në emër të qytetarëve dhe brenda kornizës së ligjit.

FORMA E FUQISË	SI REALIZOHET
Forca	I fuqishmi nuk i lë të pafuqishmit mundësinë të zgjedhin nëse do të binden apo jo.
Detyrimi	I fuqishmi kërcënon të pafuqishmit me diçka.
Ndikimi	I fuqishmi i kushtëzon të pafuqishmit.
Manipulimi	I fuqishmi e mashtron të pafuqishmit.
Pushteti	I fuqishmi ka të drejtën legjitime për të komanduar.

Shteti është organizata më e fuqishme shoqërore, sepse ka monopol mbi mjetet më të rëndësishme të fuqisë – miratimin e ligjeve, përdorimin e forcës dhe mbledhjen e taksave. Pikërisht për shkak të këtij përqendrimi të fuqisë, historia ka treguar se çdo pushtet mund të keqpërdoret nëse nuk kufizohet dhe nuk kontrollohet. Prandaj, shtetet demokratike bashkëkohore organizohen sipas parimit të ndarjes së pushteteve.

Ndarja e pushteteve do të thotë se fuqia shtetërore nuk është e përqendruar në duart e një institucioni ose të një personi, por ndahet në tri degë të veçanta: **pushtetin ligjvënës, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor**. Këto kontrollojnë dhe balancojnë njëra-tjetrën, me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi i pushtetit.

Pushteti ligjvënës ka për detyrë të **miratojë** ligje. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut këtë rol e ushtron Kuvendi. Në nivel lokal, në komuna, funksionin ligjvënës e kanë këshillat komunalë, të cilët miratojnë vendime të rëndësishme për bashkësinë lokale.

Pushteti ekzekutiv zbaton ligjet në praktikë. Në nivel shtetëror këtë detyrë e kryen Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila drejton institucionet dhe udhëheq politikën e shtetit. Në nivel lokal pushtetin ekzekutiv e ushtrojnë kryetarët e komunave, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e vendimeve në komuna.



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pushteti gjyqësor, nga ana tjetër, ka për detyrë të zbatojë ligjet në situata konkrete të jetës. Gjykatat janë të pavarura nga pushteti ligjvënës dhe ai ekzekutiv, që do të thotë se duhet të vendosin në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me ligjin.

Me këtë ndarje të tre pushteteve sigurohet ekuilibri dhe kontrolli në shtet. Në këtë mënyrë zvogëlohet rreziku i keqpërdorimit të pushtetit dhe forcohen demokracia dhe sundimi i ligjit.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Hulumtoni Ligjin për ndalimin e pirjes së cigareve në vende publike dhe ndiqeni atë përmes të tri degëve të pushtetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut! Çfarë roli kanë pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në miratimin dhe zbatimin e këtij ligji? Pse është miratuar ligji dhe çfarë duhet të parandalojë? Hulumtoni një ligj të ngjashëm të ndonjë shteti evropian dhe bëni krahasimin!

AKTIVITETI 2. Hulumtoni procesin arsimor, pjesë e të cilit jeni edhe ju, dhe vëreni në cilat pjesë të tij shfaqen politika, fuqia dhe pushteti! Si pasqyrohen ato në shkollë dhe në procesin mësimor? Ndaji njohuritë dhe përfundimet me shokët e klasës!



MBANI MEND

Politika është menaxhimi i shoqërisë dhe marrja e vendimeve për shpërndarjen e burimeve dhe zgjidhjen e problemeve. Ajo realizohet përmes fuqisë dhe pushtetit, ku fuqia mund të jetë forcë, detyrim, ndikim ose manipulim, ndërsa pushteti është legjitim dhe bazohet në ligj, traditë ose karizëm. Shteti është organizata më e fuqishme dhe e përqendron fuqinë përmes ligjeve, mbledhjes së taksave dhe përdorimit të forcës. Demokracitë moderne e kufizojnë këtë fuqi përmes ndarjes së pushtetit në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është politika, fuqia dhe pushteti?
2. Çfarë llojesh pushteti ekzistojnë sipas mënyrës së qeverisjes?
3. Si ndahet pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
4. Pse politika dhe pushteti janë të nevojshme për një shoqëri?
5. Pse qytetarët duhet të kontrollojnë punën e atyre që janë në pushtet?
6. Çfarë cilësish mendoni se duhet të ketë një mbajtës i mirë i pushtetit? Shpjegoni.

9. SHTETI

ZHVILLIMI I SHTETIT

„Shteti nuk lind papritur, por gradualisht përmes praktikës së disiplinës, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të popullsisë.“ – Mishel Fuko

Njerëzit që nga periudhat më të hershme janë organizuar në bashkësi. Këto bashkësi zakonisht udhëhiqeshin nga pleqtë ose nga persona që dalloheshin për moshën, guximin ose aftësitë e tyre. Të tillë ishin udhëheqësit më të mirë ushtarakë ose gjuetarët më të zotë. Me shndërrimin e bashkësive në shoqëri politike më të ndërlikuara, lindi nevoja për një mënyrë tjetër të qeverisjes, me pushtet dhe organizim të caktuar. Këtë rol e merr shteti si organizatë politike që drejton shoqërinë.



Ndërtesa e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nocioni shtet nënkupton qeverisjen dhe ruajtjen e rendit shoqëror. Gjatë historisë shtetet e kanë ndryshuar rolin dhe mënyrën e organizimit të tyre. Në fillim ato mbronin interesat e shtresave të larta shoqërore. Në këtë mënyrë ato ushtronin pushtet të pakufizuar. Me kalimin e kohës, përmes revolucioneve dhe luftërave për të drejtat e njeriut, qytetarët e ndryshuan pozitën e tyre të nënshtruar, gjë që çoi në demokratizimin e shteteve.

Kështu, në vend të shteteve tradicionale absolutiste, ku pushteti politik ishte i përqendruar te mbretërit, feudalët dhe kisha, u shfaqën shtetet moderne. Ato filluan procesin e realizimit të të drejtave qytetare, lirive dhe barazisë, duke vendosur kështu themelet e demokracisë. Në shtetet

bashkëkohore pushteti kontrollohet dhe buron nga vullneti i qytetarëve, ndërsa shteti përfaqëson dhe mbron interesat e të gjithëve në mënyrë të barabartë.

SHTETI NË ROLIN E MBROJTËSIT TË TË DREJTAVE DHE NEVOJAVE TË QYTETARËVE

„Shteti është sistem shoqëror që funksionon për të arritur qëllime kolektive dhe për të ruajtur stabilitetin.“ – Talkot Parsons

Shteti modern bazohet në kushtetuta dhe ligje që përcaktojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe rolin e shtetit në jetën shoqërore. Detyrat e tij janë të mundësujë dhe të mbrojnë këto të drejta në jetën e

përditshme dhe të krijojë kushte në të cilat qytetarët ndihen të sigurt, të lirë dhe të barabartë para ligjit. Përmes miratimit të ligjeve ai garanton të drejtat, liritë dhe detyrimet themelore të qytetarëve.

Përveç miratimit të tyre, shteti gjithashtu është përgjegjës për zbatimin e ligjeve përmes institucioneve specifike shtetërore si policia, gjykatat dhe zyrat e prokurorive publike. Ligjet zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga gjinia, mosha, raca, etnia ose feja, ndërsa shteti garanton liritë demokratike, duke përfshirë pjesëmarrjen në jetën civile dhe politike.

Shteti modern ka detyrimin të përmbushë disa nevoja themelore të qytetarëve të tij. Kujdeset dhe menaxhon të mirat publike (burimet natyrore, infrastrukturën dhe trashëgiminë kulturore) dhe ofron shërbime publike (arsim, shëndetësi, transport publik, shërbime komunale dhe siguri). Përveç kësaj, ofron mbrojtje sociale për kategoritë e cënueshme të popullsisë dhe, nëpërmjet promovimit të investimeve dhe ndërtimit të infrastrukturës, shkollave dhe institucioneve shëndetësore, zhvillon politikë ekonomike që synon zhvillimin.

SI I RREGULLON SHTETI MARRËDHËNIET NDËRMJET QYTETARËVE TË TIJ

Shoqëritë bashkëkohore janë multikulturore dhe multietnike. Në to jetojnë qytetarë me prejardhje, kultura, fe, identitete dhe mendim të lirë të ndryshme, nëpërmjet të cilave i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre shoqërore dhe politike. Për këto arsye multikulturalizmi përfaqëson pasuri për shoqërinë, por në të njëjtën kohë paraqet edhe sfida dhe rreziqe për stabilitetin (kohezionin) e saj. Prandaj është e nevojshme që këto dallime të pajtohen nëpërmjet rregullave të përbashkëta që do të zbatohen për të gjithë. Ky pajtim kryhet nga shteti. Shteti miraton ligje që qytetarët të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre, por në të njëjtën kohë u imponon atyre detyrimin për të respektuar normat shoqërore pavarësisht nga bindjet dhe dallimet personale. Ai rregullon marrëdhëniet midis individëve dhe grupeve shoqërore me rregulla dhe norma të detyrueshme. Kur të gjithë i respektojnë dhe i zbatojnë këto rregulla në mënyrë të barabartë, konsiderohet se shoqëria drejtohet nga ligji. Prandaj **sundimi i ligjit** nënkupton respekt të ndërsjellë për të drejtat dhe liritë e qytetarëve, por edhe detyrim të shtetit dhe qytetarëve për të respektuar këto të drejta.

Ligji përcakton qartë sjelljen e lejuar dhe të palejueshme, si dhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. Për shembull, një person mbi 18 vjeç lejohet të blejë alkool dhe cigare, por jo një person nën 18 vjeç. Ligji rregullon: të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, ofron mënyra institucionale dhe paqësore për zgjidhjen e konflikteve midis individëve dhe grupeve, ndërsa parandalon veprimet arbitrare dhe të



Slogan politik

dhunshme. Për shembull, përmes ligjit, çdo qytetar gëzon të drejtën e pronës, por ka edhe detyrimin të paguajë taksat. Përmes zbatimit të barabartë të ligjeve, ligji siguron drejtësi dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga statusi i tyre shoqëror. Falë ligjit, mosmarrëveshjet midis punonjësve dhe punëdhënësve, si dhe konfliktet midis grupeve mbështetëse, nuk zgjidhen spontanisht dhe në mënyrë të pakontrolluar, por sipas ligjit. Në këtë mënyrë ligji përfaqëson mekanizëm themelor për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore për të siguruar jetë të qetë, rend, siguri dhe drejtësi në shtet. Sundimi i ligjit është parakusht themelor për paqen, drejtësinë, zhvillimin ekonomik dhe politik të shoqërisë, por edhe për zgjedhjet demokratike, të cilat pa sundimin e ligjit nuk mund të jenë ato që duhet të jenë – të drejta dhe demokratike.

SI I ZBATON SHTETI POLITIKAT E TIJ

„Politikat shtetërore janë të suksesshme vetëm nëse qytetarët e njohin legjitimitetin e qeverisë.” – Maks Veber

Sot jeta e popullsisë së botës, e cila numëron rreth tetë miliardë njerëz, është e organizuar në 195 shtete. Nga këto, 193 janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Qeveria e secilit shtet është e kufizuar në territorin dhe popullsinë e tij, domethënë ai jeton brenda kornizës së kufijve të tij të njohur ndërkombëtarisht. Brenda këtyre kornizave shtetet zhvillojnë politikat e tyre që rregullojnë marrëdhëniet midis qytetarëve, miratojnë ligje dhe sigurojnë paqen dhe stabilitetin.

Shumica e shteteve moderne zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e tyre në mënyrë demokratike qeverisjeje. Kjo do të thotë se pushteti vjen nga demos (populli) përmes **zgjedhjeve** të lira. Populli zgjedh përfaqësuesit e tij dhe i autorizon ata të qeverisin në emrin e tij. Zgjedhjet janë themeli i procesit demokratik. Prandaj shtetet, veçanërisht shtetet anëtare ose shtetet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, janë të detyruara të sigurojnë zgjedhje demokratike. Zgjedhjet janë demokratike nëse zhvillohen duke marrë parasysh:

- të drejtën universale për të votuar (pa diskriminim sipas përkatësisë politike, etnisë, fesë, pasurisë ose arsimit);
- votën e barabartë (vota e të gjithëve vlen njësoj – „një person, një votë“);



Paraqitje konceptuale e një kandidati në një fushatë zgjedhore

- lirinë e zgjedhjes (pa presion, kërcënime ose shtrëngim dhe lirinë e shprehjes dhe organizimit politik);
- votimin e fshehtë (të gjithë votojnë sipas bindjeve të tyre, vetëm, në kabina);
- sistemin shumëpartiak (me kandidatë të shumtë);
- zgjedhjet e rregullta (në intervale të paracaktuara);
- kushtet e drejta të konkurrencës (të gjitha partitë dhe kandidatët kanë mundësi afërsisht të barabarta për fushatë, mbulim mediatik dhe qasje te votuesit);
- transparencën dhe kontrollin (vëzhgimin e procesit zgjedhor);
- rezultatet (pjesëmarrësit i pranojnë rezultatet e zgjedhjeve si të drejta).



Kuti votimi

Këto parime garantojnë shprehjen e lirë të vullnetit të qytetarëve dhe legjitimitetin e autoriteteve të zgjedhura. Prandaj partitë politike luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm.

Partitë politike janë subjekte të organizuara, qëllimi kryesor i të cilave është të fitojnë dhe të ushtrojnë pushtetin shtetëror përmes mbështetje zgjedhore nga votuesit. Çdo parti politike ka programin e vet politik. Programet përmbajnë ide, qëndrime dhe plane për qeverisjen e vendit, duke përfshirë

çështjet e arsimit, ekonomisë, shëndetësisë, infrastrukturës dhe politikës së jashtme. Në sistemin tonë politik fiton partia që ka marrë mbështetjen më të madhe nga qytetarët në zgjedhje. Partitë që kanë shumicën në parlament ose në këshillat komunale, oftojnë vetëm ose së bashku me parti të tjera, fitojnë të drejtën legjitime për të qeverisur shtetin ose komunat. Duke vepruar kështu, ato kanë detyrim politik t'i përmbahen programeve dhe premtimeve dhe të zbatojnë programet zgjedhore për të cilat voton shumica e qytetarëve. Megjithatë, qytetarët si votues kanë detyrim të informohen për programet e partive dhe të votojnë për ato që, bazuar në analizën dhe bindjet e tyre krahasuese, ofrojnë zgjidhjet më të përshtatshme. Sistemi shumëpartiak në demokracitë moderne i rrit zgjedhjet dhe e inkurajon konkurrencën politike.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Lexoni me kujdes dhe shpjegoni përkufizimet e ofruara. Ç'është e ndryshme, ç'është e përbashkët në këtë? Me cilin përkufizim jeni më dakord? Shpjegoni pse!

1. „Shteti është bashkësi që ka monopolin mbi përdorimin legjitim të forcës fizike në territor të caktuar.” – Maks Veber

2. „Shteti është instrument i klasës sunduese.” – Karl Marks
3. „Shteti është organi moral i shoqërisë.” – Emil Dyrkem
4. „Shteti duhet të shprehë vullnetin e përgjithshëm të popullit.” – Zhan-Zhak Ruso



MBANI MEND

Shteti është organizatë politike që qeveris shoqërinë dhe siguron rendin, stabilitetin dhe arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Gjatë historisë ai është zhvilluar nga format absolutiste të qeverisjes, në të cilat pushteti ishte i përqendruar në numër të vogël sundimtarësh, kah shtetet moderne demokratike, në të cilat pushteti buron nga qytetarët. Shteti modern mbështetet në kushtetutë dhe ligje që përcaktojnë të drejtat, liritë dhe detyrimet e qytetarëve, ndërsa baza e tij është mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave. Mbisundimi i ligjit do të thotë se ligjet zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe se qytetarët dhe autoritetet shtetërore janë të detyruara t'i respektojnë ato. Shteti ofron shërbime publike si arsimi, shëndetësia, siguria dhe infrastruktura, si dhe mbrojtja sociale për kategoritë e cënueshme. Në sistem demokratik qeveria konstituohet përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, ndërsa partitë politike ofrojnë programe për qeverisjen e shtetit. Pjesëmarrja aktive dhe e informuar e qytetarëve është thelbësore për legjitimitetin dhe funksionimin e suksesshëm të një shteti demokratik.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është shteti?
2. Cilat janë karakteristikat e shteteve moderne demokratike?
3. Cilat interesa të qytetarëve i mbron shteti?
4. Cilat nevoja të qytetarëve të tij i plotëson shteti?
5. Ç'është ligji?
6. Çfarë rregullohet nga ligji i një shteti?
7. Ç'janë zgjedhjet?
8. Cilat janë karakteristikat e zgjedhjeve demokratike? Shpjegojini ato!
9. Ç'janë partitë politike?
10. Cili është qëllimi kryesor i partive politike?

10. DEMOKRACIA

DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

„Demokracia bazohet në debatin publik racional, ku të drejtat e njeriut janë parakusht për komunikim të lirë.” – Jurgen Habermas

Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme, sepse njëra nuk mund të ekzistojë pa tjetrën. Demokracia është sistem në të cilin pushteti buron nga populli, ndërsa të drejtat dhe liritë e njeriut mbrojnë dinjitetin, lirinë dhe barazinë e çdo individi – pavarësisht nga etnia, feja, gjinia, përkatësia politike, racore ose sociale. Janë pikërisht këto të drejta që u mundësojnë qytetarëve të marrin pjesë aktive në jetën publike, ndërsa qytetaria aktive është themeli i një shoqërie demokratike. Të drejtat e njeriut ndahen në disa kategori:

- të drejtat civile ose personale, të cilat përfshijnë të drejtën për jetë, barazinë para ligjit, privatësinë dhe lirinë e shoqërimit, si dhe mosdiskriminimin;
- të drejtat politike, siç janë e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur, pjesëmarrja në jetën ushtarake dhe e drejta për protestë paqësore dhe shoqërim në parti politike;
- të drejtat shoqëro-ekonomike, të cilat përfshijnë të drejtën për punë, paga të drejta, pronë, arsim dhe sigurime shoqërore;

- të drejtat kulturore, duke përfshirë përdorimin e gjuhës amtare, mbrojtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor, qasjen në vlerat kulturore dhe pjesëmarrjen në jetën kulturore.

Të gjitha këto të drejta janë të ndërlidhura dhe të pandashme – pasi shkelja e një të drejte çon në mënyrë të pashmangshme në shkelje të të drejtave të qytetarit. Të drejtat e njeriut janë të përcaktuara dhe të mbrojtura nga dokumente ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ato garantohen nga Kushtetuta, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare të OKB-së dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



Të drejtat janë të barabarta për të gjithë

TË DREJTA, POR EDHE DETYRIME!

„Të drejtat dhe detyrimet janë pjesë e moralit kolektiv. Të drejtat e individit ekzistojnë vetëm nëse ai i respekton detyrimet e tij ndaj shoqërisë.”

– Emil Dyrkem

Në shoqëritë demokratike qytetarët gëzojnë të drejta dhe liri të garantuara. Gëzimi i këtyre të drejtave do të thotë mundësia e të jetuarit në shoqëri në të cilën respektohet dinjiteti dhe liria e individit. Megjithatë, një rend demokratik nuk mund të funksionojë pa qytetarë të përgjegjshëm. Ne kemi nevojë për qytetarë që janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe liritë e tyre, por janë gjithashtu qytetarë që dinë të përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre. Çdo e drejtë shoqërohet me një detyrim përkatës, ndërsa detyra themelore e qytetarëve është të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet. Kjo do të thotë se qytetarët duhet të mësojnë se si të respektojnë të drejtat e të tjerëve në jetën e tyre të përditshme dhe si të kujdesen për të mirën e përbashkët (si të mbrojnë natyrën, pastërtinë publike, trashëgiminë kulturore dhe shëndetin publik).

Edhe pse njohuritë dhe zhvillimi personal konsiderohen sukses individual, ato janë gjithashtu detyrë dhe virtyt i rëndësishëm qytetar. Shoqëria përparon më shpejt kur qytetarët janë të arsimuar, të përgjegjshëm, me mendje kritike dhe kontribuojnë në mënyrë aktive njohuritë dhe aftësitë e tyre në të mirën e komunitetit.

Mendoni se si mund të kontribuoni në zhvillimin e përsheptuar dhe më cilësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga tabela mund të shihni se cilat të drejta dhe detyrime qytetare rrjedhin prej tyre.

Të drejtat e qytetarëve	Detyrimet që lidhen me këtë të drejtë
E drejta për jetë dhe siguri	Detyrimi për të mos rrezikuar jetën dhe sigurinë e të tjerëve
E drejta për liri dhe siguri personale	Detyrimi për të respektuar ligjet dhe liritë e të tjerëve
E drejta për barazi para ligjit	Detyrimi për të mos diskriminuar dhe për të respektuar diversitetin
E drejta për arsim	Detyrimi për të ndjekur mësimet rregullisht dhe për të respektuar rregullat e shkollës
E drejta për lirinë e mendimit dhe shprehjes	Detyrimi për të shprehur mendime pa fyerje, urrejtje ose gjuhë urrejtjeje
E drejta për privatësi	Detyrimi për të respektuar privatësinë e të tjerëve
E drejta për mbrojtje të shëndetit	Detyrimi për t'u kujdesur për shëndetin e vet dhe publik
E drejta për mjedis të pastër	Detyrimi për të mbrojtur natyrën dhe hapësirën publike
E drejta për pjesëmarrje në jetën shoqërore	Detyrimi për të marrë pjesë aktive dhe me përgjegjësi në komunitet
E drejta për pronë	Detyrimi për të qenë i vetëdijshëm për pronën e të tjerëve dhe të ekipit
E drejta për punë	Detyrimi për të kryer detyrat e punës me ndershmëri dhe përgjegjësi
E drejta për drejtësi dhe mbrojtje juridike	Detyrimi për të respektuar vendimet gjyqësore dhe rendin ligjor

AKTIVIZMI QYTETAR, QYTETARËT AKTIVË

Demokracia nuk do të thotë vetëm të kesh të drejta dhe liri dhe pjesëmarrja në zgjedhje, por edhe përfshirja e përditshme në proceset shoqërore. Përmes pjesëmarrjes aktive qytetarët ndikojnë në vendimet e pushtetit dhe inkurajojnë ndryshimin. Aktivizmi qytetar do të thotë ushtrim aktiv i të drejtës së mendimit, angazhim për drejtësi dhe barazi, mbrojtje e lirive të veta dhe respektim i të drejtave të të tjerëve.

„Demokracia mbijeton përmes qytetarëve aktivë, të cilët bashkohen dhe marrin pjesë në jetën publike.“ – Aleksis de Tokvil

Qytetarët aktivë janë një lloj kontrolli mbi qeverinë. Duke parashtruar pyetje, duke vënë në dukje padrejtësitë dhe duke kritikuar korrupsionin ose nepotizmin, ata ndihmojnë institucionet të bëhen më të përgjegjshme dhe efikase. Një sjellje e tillë tregon shqetësim për komunitetin dhe angazhim për të mirën e përbashkët, e cila është thelbësore për një demokraci të shëndetshme. **Aktivizmi civil** nënkupton shoqërimin rreth një qëllimi të përbashkët që forcon solidaritetin, empatinë dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. Prandaj është e rëndësishme që të rinjtë të marrin pjesë në aktivizmin civil që në moshë të re. Ky proces fillon në shkollë dhe përmes pjesëmarrjes në bashkësitë e nxënësve, parlamentet, debatet dhe aktivitetet vullnetare. Në këtë mënyrë zhvillohet një ndjenjë përgjegjësie dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e qytetarisë aktive.

Qytetaria aktive është e lidhur pazgjidhshmërisht me përgjegjësinë. Qytetarët aktivë punojnë për ndryshim, duke respektuar ligjet, të drejtat e të tjerëve dhe parimet e veprimit jo të dhunshëm. Dialogu, toleranca dhe respekti për mendimet e ndryshme janë baza e veprimeve të tyre.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktivizmi qytetar që synon zgjidhjen e problemeve specifike

vërehet gjithnjë e më shumë. Të tilla janë aktivitetet e iniciativës „Ajri im“, e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të aktualizojë problemin e cilësisë së ajrit në Shkup dhe qytete të tjera të mëdha në vend. Aktivistët e kësaj iniciative, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, përdorin teknologji (aplikacione për matjen e cilësisë së ajrit) dhe shfaqje vizuale mediatike të shkallës së ndotjes së ajrit. Përfitimet e kësaj iniciative janë të mëdha. Është ngritur ndërgjegjësimi të qytetarëve për rëndësinë e cilësisë së ajrit, duke shkaktuar ndryshime



Nxënës vullnetarë në aksion duke mbjellë pemë

në ngrohjen e familjeve, transportin, etj. Një shembull tjetër është iniciativa e një grupi qytetarësh, „Në biçikletë“, të cilët si përdorues të biçikletave si mjet transporti ndihen të pasigurt në trafik. Kjo iniciativë u pasua nga shëtitje masive nëpër qytet, kërkesa drejtuar institucioneve përkatëse për ndërtimin e shtigjeve për biçikleta, informim të qytetarëve nëpërmjet mediave sociale, etj. Përfitimet e aktiviteteve të tyre janë të dukshme. Shtigjet e biçikletave janë përmirësuar, janë instaluar sinjalistika rrugore për çiklistët dhe biçikletat janë përfshirë më gjerësisht në planet e trafikut dhe infrastrukturës.

Dy shembujt e aktivizmit qytetar të përmendur më sipër lidhen me aktivitetet jopartiake. Ato tregojnë se qytetarët janë të fuqishëm jo vetëm gjatë zgjedhjeve, por edhe në drejtimin e vetëdijshëm të iniciativave të tyre aktive qytetare drejt ndryshimeve të përhershme.



Ngjarje nga iniciativa qytetare „Me biçikletë“



Mesazh qytetar

Aktivizmi qytetar përfshin veprime nga qytetarët ose shoqatat civile që synojnë të ndikojnë në vendimet mjedisore, sociale, kulturore dhe politike të pushtetit. Megjithatë, ai mund të kryhet edhe nga kompanitë.

Llojet më të zakonshme të aktiviteteve të ndërmarra nga aktivistët civilë janë protestat, grevat, bllokimet e vendeve të caktuara publike, peticionet, bojkotet e të tjera. Sot organizimi i këtij lloji aktiviteti është më efektiv falë mediave sociale. Ato janë mjete të rëndësishme për ndarjen e shpejtë të informacionit dhe mobilizimin e qytetarëve.

SI NDIKON POLITIKA TE QYTETARËT?

„Politika ndikon te qytetarët përmes pushtetit legjitim, ligjeve dhe institucioneve që rregullojnë jetën e tyre të përditshme.” – Maks Veber

Kur njerëzve u bëhen pyetje rreth çështjeve politike, ata shpesh thonë se nuk janë të interesuar për politikën. Sot në kohë kur politika është gjithçka, mosinteresi në politikë dhe indiferenca politike zvogëlojnë ambiciet e qytetarëve për progres dhe kështu zvogëlojnë kapacitetet e komunitetit – veçanërisht nëse marrim parasysh se përmes aktivizmit qytetar krijohet kapital i rëndësishëm shoqëror (njerëzit mësojnë të punojnë si ekip, fitojnë shkathtësi, besim, etj.).

Politika është e pranishme në jetën e përditshme të çdo individi. Nuk është diçka e largët dhe abstrakte që ndodh vetëm në parlamente, zyra ose samite ndërkombëtare, por ka një ndikim konkret në të gjitha segmentet e shoqërisë. Ne themi se politika formëson mënyrën se si jetojnë njerëzit, sepse përmes rregullave dhe normave përcakton se si do të funksionojë shoqëria dhe si do të zgjidhen çështjet e përbashkëta. Zhvillimi i ekonomisë, shëndetësisë, arsimit, kulturës, infrastrukturës, shkencës, ekologjisë varet prej saj.

Për shembull, në ekonomi ndikimi politik i shtetit ndihet nëpërmjet miratimit të ligjeve, taksave, pagave dhe subvencioneve. Në këtë mënyrë politika ndikon në vendimet e qytetarëve për të kursyer, investuar ose blerë pasuri të paluajtshme. Politika ekziston edhe në arsim. Cilësia e arsimit varet nga politikat dhe investimet shtetërore, pasi ato përcaktojnë kushtet në të cilat kryhet procesi arsimor, trajnimi i stafit mësimdhënës, programet mësimore etj. Politikat e mira në shëndetësi shihen nëpërmjet shërbimeve shëndetësore cilësore dhe besimit të qytetarëve se shteti kujdeset për mirëqenien e tyre.



Politika ndërton infrastrukturë për qytetarët



Vendimet politike ndikojnë edhe në zhvillimin e shkencës

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Analizoni shembullin, pastaj përgjigjuni pyetjeve.

„Politika arsimore cilësore – arsim cilësor“

Shteti A investon fonde të konsiderueshme në arsim. Mësimdhënia në shkolla është plotësisht e digjitalizuar dhe zhvillohet sipas programeve mësimore moderne, të cilat zhvillojnë të menduarit kritik, kërkimin dhe punën në grup te nxënësit. Mësimdhënësit janë të trajnuar mirë për të punuar me nxënës të talentuar. Ekzistojnë ekipe mbështetëse për nxënësit me vështirësi, si dhe programe për nxënësit e talentuar. Mungesat e paarsyeshme të nxënësve reduktohen në minimum.

Në shtetin B arsimi nuk është përparësi. Buxheti për arsimin është i ulët, shkollat nuk janë të pajisura mjaftueshëm dhe mësimdhënësit kanë mundësi të kufizuara për zhvillim profesional. Programet mësimore janë të vjetruara dhe përqendrohen në të mësuarit përmendësh. Nuk ka mbështetje të mjaftueshme për nxënësit me nevojë të ndryshme. Si rezultat, arritjet e nxënësve janë të ulëta, motivimi është i ulët dhe një numër i madh i të rinjve e braktisin arsimin herët.

PYETJE: Cilat janë ndryshimet kryesore në politikat arsimore midis vendit A dhe vendit B? Si ndikon investimi në mësimdhënësin në cilësinë e arsimit? Çfarë pasojash mund të ketë cilësia e dobët e arsimit në zhvillimin ekonomik dhe social? Cilat të drejta të nxënësve mund të jenë në rrezik në vendin B? Çfarë roli luajnë qytetarët në kërkimin e politikave më të mira arsimore? Çfarë masash do të sugjeronit për të përmirësuar sistemin arsimor në vendin B?

AKTIVITETI 2. Lexoni me kujdes tekstin më poshtë dhe përgjigjuni pyetjeve më poshtë!

„Zëri i Pjetrit“

Pjetri (17 vjeç) luan futboll për klubin e tij lokal, por vëren se menaxhmenti i klubit merr vendime të padrejta dhe «rregullon» ndeshjet. Ai regjistron një bisedë video në telefonin e tij celular në të cilën mëson se ekipi i tij është gati të humbasë ndeshjen. Edhe pse është i vetëdijshëm për rreziqet, ai vendos të mos heshtë. Videoja është postuar në mediat sociale, duke bërë thirrje për sporte të ndershme dhe mosndërrhyrje të politikës në sport. Pjetri përjashtohet nga ekipi dhe bëhet shënjestër e thashethemeve dhe kërcënimeve.

PYETJE: Cilat të drejta njerëzore të Pjetrit janë shkelur? A mund të konsiderohet përjashtimi i Pjetrit nga ekipi si hakmarrje? Çfarë roli luajnë institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në raste të tilla? Ç'do të bënit nëse do të ndodheshit në situatë të ngjashme? Si mund të jenë mediat sociale njëkohësisht kërcënim për demokracinë dhe kërcënim për të drejtat e njeriut? A kanë të rinjtë hapësira të mjaftueshme për të shprehur mendimet e tyre në shoqëri?



MBANI MEND

Demokracia nuk mund të ekzistojë vetëm përmes zgjedhjeve dhe institucioneve, por ajo jeton përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Të drejtat e njeriut mbrohen vetëm kur qytetarët i njohin, i respektojnë dhe i zbatojnë në mënyrë aktive ato. Nëse qytetarët janë pasivë, institucionet mund të marrin vendime pa kontrollin e tyre dhe interesat e komunitetit nuk do të mbrohen mjaftueshëm. Aktivizmi qytetar i përshkruar në shembujt „Ajri im“ dhe „Në biçikletë“ vërteton se kur njerëzit organizohen dhe shprehin pikëpamjet e tyre, ata mund të shkaktojnë ndryshime të vërteta.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Cila është lidhja midis demokracisë dhe të drejtave të njeriut?
2. Sa kategori të të drejtave të njeriut ekzistojnë!
3. Pse të drejtat e qytetarëve sjellin detyrime?
4. Ç'është aktivizmi qytetar?
5. Pse është e rëndësishme të ketë qytetarë aktivë në shoqëri? Cili është roli i tyre?
6. Jepni shembuj të aktivizmit qytetar në Republikën e Maqedonisë së Veriut!
7. Në cilën sferë të jetës së përditshme e ndjeni ndikimin e politikës? Shpjegoni si!

11. ARSIMI DHE SHKENCA

„Arsimi dhe shkenca kontribuojnë në racionalizimin e shoqërisë dhe krijimin e fuqisë punëtore profesionale dhe të kualifikuar.”

– Maks Veber


Sociologët më shpesh e konsiderojnë arsimin si proces përmes të cilit individët marrin pjesë në bërjen anëtarë aktivë të shoqërisë në mënyrë të organizuar – përmes shkollave dhe universiteteve. Ata fitojnë njohuri, vlera, norma dhe modele kulturore të dobishme për jetën në komunitet. Ky përkufizim i arsimit është më i afërt me përkufizimin e Dyrkemit, sipas të cilit arsimi është ndikimi që brezat e vjetër kanë tek ata që nuk janë ende të përgatitur për jetën shoqërore.

Pra, nga një këndvështrim sociologjik, arsimi nuk është vetëm përvetësim i njohurive, por edhe proces i formimit të personalitetit. Prandaj arsimi ka role/funksione kyçe në zhvillimin e individit:

- funksion socializues (individi përvetëson vlera dhe modele kulturore përmes të cilave ai ose ajo përgatitet për jetën në bashkësi);
- funksion integruues (përmes vlerave të përbashkëta, ai lidh grupe të ndryshme dhe krijon ndjenjë përkatësie);
- funksion ekonomik (ofron njohuri dhe aftësi profesionale të nevojshme për kryerjen e profesioneve të caktuara);
- funksion selektiv (udhëzon individët të zgjedhin profesionet në të cilat janë më të suksesshëm) dhe
- funksion kulturor (transmeton trashëgiminë kulturore nga një brez në tjetrin përmes gjuhës).

Me fjalë të tjera, arsimi është mjet nga i cili varet zhvillimi i individit. Individi i cili fiton njohuri është në gjendje të mendojë në mënyrë kritike, të përvetësojë vlera pozitive, të bashkëpunojë dhe të arrijë atë që dëshiron në jetë si anëtar i dobishëm i shoqërisë. Për këto arsye është e rëndësishme që të gjithë të kenë qasje në arsim cilësor.

Ndryshe nga arsimi, i cili është proces, shkenca është institucion shoqëror për krijimin e njohurive të



Arsimi është shkallë drejt suksesit

organizuar, sistematike dhe të verifikueshme rreth natyrës dhe shoqërisë. Ajo krijon njohuri sipas normave, vlerave dhe rregullave të përcaktuara, ndërsa roli i saj është të mundësojë zhvillimin shoqëror dhe teknologjik.

CILA ËSHTË LIDHJA MIDIS ARSIMIT DHE SHKENCËS?

Për të shpjeguar këtë lidhje, do të përdorim mendimet e Veberit, të dhëna në hyrje të këtij mësimi. Me këtë mendim Veberi përpiqet të shpjegojë se si shkenca e formëson shoqërinë (e bën atë më të organizuar dhe efikase) dhe si ndihmon arsimi në këtë.



Nxënësit krijojnë modele në një printer 3D

Veberi mendon se në shoqërinë moderne mënyra tradicionale e të menduarit zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga mënyra racionale. Njerëzit nuk interesohen për traditën dhe zakonet dhe e organizojnë jetën e tyre në mënyrë logjike (racionale). Në shoqëri të tillë, institucionet funksionojnë në përputhje me ligje të qarta, jo sipas vullnetit të dikujt.

Në këtë kalim nga një mënyrë tradicionale në mënyrë racionale të organizimit të jetës, Veberi mendon se shkenca luan një

rol kyç. Ajo ofron njohuri të sakta dhe të provuara që mundësojnë kuptim më të mirë të natyrës dhe shoqërisë. Falë zbulimeve shkencore, në mjekësi bëhen diagnoza të sakta, në inxhinieri ndërtohen objekte të qëndrueshme dhe të forta, ndërsa zhvillimi ekonomik planifikohet bazuar në analiza dhe të dhëna.

Por për Veberin vetëm njohuria nuk ishte e mjaftueshme. Nevojiten njerëz që mund ta zbatonin atë njohuri. Veberi mendonte se vetëm arsimi mund të krijonte njerëz të aftë (profesionistë), domethënë mjekë, mësimdhënës, avokatë ose inxhinierë, të cilët mund të punonin në bazë të parimeve dhe rregullave shkencore. Në këtë mënyrë Veberi theksoi varësinë e shkencave nga arsimi.

Prandaj, kush do të bëhet shkencëtar varet në masë të madhe nga cilësia e njohurive dhe aftësive të fituara në procesin arsimor.

Mendoni se sa kohë iu desh Lui Pasterit të mësonte, të realizonte dhe të eksperimentonte për të zbuluar vaksinën kundër tërbimit, Maria Kiri të zbulonte radioaktivitetin, ndërsa Nikola Tesla – energjinë elektrike.

SI E BËJNË SHKENCAT JETËN E NJERËZVE MË TË LEHTË PËRMES ARSIMIT

Sociologu amerikan Dejvid Beker hulumtoi se si arsimi ndikon në shoqëri. Ai arriti në përfundimin se arsimi krijon një numër të madh njerëzish me arsim të lartë, të cilët me njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale zhvillojnë teknologji të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në ekonomi, politikë dhe shkencë. Pra, arsimi jo vetëm që transmeton njohuri shkencore dhe kulturore, por bëhet edhe institucion i madh që transformon kulturën. Ndryshon mënyrën e të menduarit, punën, vlerat dhe të gjithë mënyrën e funksionimit të shoqërisë.

Nga kjo mund të konkludojmë se shkenca krijon njohuri dhe arsimi ua transmeton atë brezave të rinj, të cilët nga ana tjetër e perceptojnë botën, fitojnë aftësi dhe e zbatojnë shkencën në jetën e përditshme. Arsimi e bën njohurinë shkencore praktike dhe të arritshme për ta.

Paniku është sjellje e nxitur nga emocione të forta, më shpesh e shkaktuar nga një situatë e zakonshme ose kërcënuese. Ai bëhet më intensiv kur individë është në grup, sepse ndikimi i njerëzve të tjerë intensifikon ndjenjën e pasigurisë. Në rrethana të tilla, të menduarit racional zvogëlohet ndjeshëm dhe shpesh zëvendësohet nga veprime kaotike dhe impulsive. Paniku vërehet më shpesh në situata të evakuimit kolektiv ose në mes të rrezikut, kur individë vëzhgon reagimet e njerëzve përreth tij dhe vepron në përputhje me rrethanat, pa vlerësuar në mënyrë të pavarur situatën. Një sjellje e tillë është e vështirë për t'u kontrolluar. Prandaj është me rëndësi të madhe që individë të përpiqet të qëndrojë i qetë dhe i mbledhur në veprimet e tij. Për shembull, derisa udhëtojnë me tren, pasagjerët marrin informacion në lidhje me një bllokim trafiku ose një tren që afrohet me shpejtësi një nga drejtimi i kundërt. Pa kontrolluar saktësinë e informacionit, ata që preken nga frika reagojnë në mënyrë të panikuar dhe të çorganizuar dhe e braktisin trenin në turmë.

Thashethemet janë informacione të paverifikuara dhe shpesh të pasakta në lidhje me një incident, ngjarje ose person të caktuar. Ato kanë ndikim të fortë në të menduarit dhe sjelljen e njerëzve, veçanërisht kur përhapen në kushte pasigurie. Ana negative e thashethemeve është se ato mund të shkaktojnë ankth kolektiv, frikë, pasiguri dhe reagime të gabuara në komunitetin e gjerë. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që individët të zhvillojnë të menduarit kritik dhe zakonet e kontrollit të informacionit që qarkullojnë në publik. Për shembull, gjatë pandemisë së koronavirusit u përhapën thashetheme se do të kishte mungesë të produkteve bazë ushqimore. Të inkurajuar nga ky informacion, qytetarët zbrazën masivisht raftet e supermarketeve, pavarësisht faktit se institucionet kompetente informonin vazhdimisht se nuk kishte rrezik për një mungesë të tillë.

LËVIZJET SHOQËRORE

*„Kur njerëzit bashkohen, lind një forcë më e madhe se çdo individ.“
– Emil Dyrkem*

Njerëzit janë në kërkim të vazhdueshëm për diçka të re, të ndryshme, moderne, tjetërfarë, me dëshirën për ta bërë ekzistuesen më të mirë. Kur dëshira për ndryshim merr një dimension kolektiv (të përbashkët) dhe njerëzit bashkohen për të arritur dhe vepruar mbi ndonjë nevojë shoqërore, thuhet se lindin **lëvizje shoqërore**. Lëvizjet shoqërore janë aktivitete të organizuara kolektive të njerëzve që kanë qëllime të përbashkëta dhe përpiqen të sfidojnë ose parandalojnë ndonjë fenomen shoqëror. Këto aktivitete më së shpeshti synojnë nevojat e përditshme të njerëzve, siç janë drejtësia, ekologjia, barazia, etj.



Marsh proteste për ajër të pastër në Shkup

Lëvizjet shoqërore lindin kur një komunitet përballet me një problem që prek të gjithë vendbanimin. Për shembull, vandalizmi nga një grup të rinjsh ose një njoftim për ndërtimin e një pallati apartamentesh në park që do të priste pemët dhe do të shkatërronte hapësirën e gjelbër publike.

Në fillim banorët reagojnë individualisht, por me kalimin e kohës ata e kuptojnë se është bërë problem kolektiv sepse sjellja e të rinjve ose shkatërrimi i parkut ndikon në sigurinë, qetësinë dhe cilësinë e jetës së të gjithë komunitetit.

Më pas shfaqen **iniciatorët dhe udhëheqësit**, të cilët informojnë fqinjët e tyre dhe organizojnë komunitetin. Pasojnë **aktivitete konkrete**: takime midis banorëve, biseda me të rinjtë dhe prindërit e tyre, paraqitja e peticioneve, protesta paqësore, adresimi i autoriteteve lokale dhe përdorimi i medias dhe rrjeteve sociale.

Përmes **veprimit të tillë të organizuar dhe kolektiv** qytetarët përpiqen të zgjidhin problemin, të vendosin rendin publik ose të ruajnë hapësirën e gjelbër publike.

LËVIZJET MË TË NJOHURA SHOQËRORE

„Progresi në liri dhe drejtësi nuk është arritur kurrë pa vetëdijen kolektive dhe veprimin e bashkuar të atyre që përpiqen të ndryshojnë shoqërinë.”

– Xhon Stujart Mil

Lëvizjet mjedisore tentojnë për mbrojtjen e natyrës nga ndotja e tepërt dhe urbanizimi. Ato lindin kur qytetarët bëhen të vetëdijshëm për pasojat e ndotjes, e cila nuk është vetëm rrezik për të tashmen, por mbetet problem serioz për brezat e rinj. Ato përpiqen të ndikojnë në politikat që lidhen drejtpërdrejt me problemet mjedisore. Sot aktiviteti i tyre synon kryesisht rritjen e ndërgjegjësimit të njerëzve për problemet dhe pasojat mjedisore.

Lëvizjet feministe u shfaqën në shekullin XIX me qëllimin e luftës për barazinë gjinore midis burrave dhe grave. Lufta për të drejtat e grave u zhvillua përmes formave të ndryshme të aktivizmit: protesta, fushata, peticione, programe edukative, ndikim në legjislacion e të tjera. Kërkesat kryesore që u bënë ishin të drejtat politike për gratë, qasja e barabartë në arsim, mbrojtja nga dhuna gjinore, të drejtat riprodhuese e kështu me radhë. Sot ato janë aktive në luftën për të përmbysur stereotipet kombëtare dhe diskriminimin gjinor në të gjitha sferat shoqërore.

Lëvizjet paqësore synojnë zgjidhjen paqësore të konflikteve – me aktivitete të bazuara në veprime jo të dhunshme, protesta paqësore, marshime paqeje, promovimin e dialogëve, etj. Ato lindin si reagim i qytetarëve që bëhen të vetëdijshëm për dëmet e luftës: humbjet e pakthyeshme, pasojat njerëzore dhe materiale, paqëndrueshmëria e shoqërive që zgjat shumë kohë pas luftës, etj. Ato luajnë një rol të madh në futjen e një kulture paqeje te popullsia.

Lëvizjet antiraciste mbështesin barazinë midis njerëzve dhe parandalimin e çdo lloji diskriminimi në bazë të racës. Ato shfaqen si përgjigje ndaj ndarjes dhe diskriminimit racor,



Aksion pastrimi ekologjik



Marsh protestues feministe



Marsh kundër luftës

ku mjetet kryesore të aktivitetit janë përmes: protestave, fushatave publike, programeve edukative, thyerjes së paragjykimeve dhe ndikimit në politika dhe ligje. Qëllimi i tyre është të ndërtojnë shoqëri në të cilat të gjithë kanë të drejta, liri dhe mundësi të barabarta.

Lëvizjet shoqërore i ndërpresin aktivitetet e tyre kur zgjidhet problemi për të cilin shqetësohen.



Slogani antiracist “Jeta e të zinjve ka rëndësi”

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Bëni një analizë të stileve të modës që i vëreni në mjedisin përreth bashkëmoshatarëve tuaj! Analizoni se si merrni vendime në lidhje me gardërobën tuaj! Ç’është vendimtare: a është modeli i këpucëve i rehatshëm dhe me cilësi të mirë apo është aktual dhe blihet më shpesh nga bashkëmoshatarët tuaj?

AKTIVITETI 2. Imagjinoni të jeni pjesë e një turme të madhe njerëzish në ngjarje publike, siç është koncert, protestë ose ndeshje sportive. Përshkruani se si ndryshojnë mendimet, emocionet dhe sjellja juaj kur jeni në grup. A ndiheni më emocionalë, të ndikuar nga të tjerët apo të motivuar për të marrë pjesë në veprim të përbashkët? A do të vepronit njësoj nëse do të ishit vetëm?

AKTIVITETI 3. Veçoni një problem që mendoni se është aktualisht problem i pjesës tjetër të mjedisit tuaj (shkollë, lagje, pallat apartamentesh, etj.), përpiquni të gjeni një zgjidhje për problemin dhe inkurajoni ata që janë më afër jush ta zbatojnë atë në mënyrë aktive! Për shembull: parku ujqor i fëmijëve përpara ndërtesës nuk pastrohet nga mbeturinat. Takohuni me banorët e ndërtesave përreth dhe reagoni në komunë për të zgjidhur problemin! Ç’do të bëni së pari? Si do t’i inkurajoni bashkëqytetarët tuaj të bëhen aktivë në zgjidhjen e problemit? Si do ta „zgjoni“ vetëdijen e tyre kolektive?

AKTIVITETI 4. Mendoni për mendimin e Martin Niemlerit të dhënë në fillim të mësimi. Ç’do të ndodhte nëse njerëzit do të reagonin për të mbrojtur bashkëqytetarët e tyre? Ç’do të ndryshonte? Zbuloni në çfarë rrethanash u shpreh ky mendim!

AKTIVITETI 5. Inkurajoni nxënësit tuaj të luajnë lojën e telefonit të prishur. Jepuni atyre një fjali më të gjatë dhe kalojani atë njëri-tjetrit. Së fundmi, kur i fundit të thotë atë që dëgjoi, do të vini re se sa shumë do të ndryshojë fjalia përfundimtare nga ajo fillestare, origjinale. Ky është shembull i vërtetë se si përhapen thashethemet!



MBANI MEND

Njeriu është individ, por jeton dhe formohet në një kolektiv, ku ekziston ndikim i ndërsjellë ndërmjet individit dhe grupit. Sjellja kolektive shfaqet në forma të ndryshme, si turma, publiku, paniku dhe thashethemet. Në situata të caktuara vetëdija individuale mund të shtypet nga vetëdija kolektive, siç shpjegon Emil Dyrkemi. Kur një problem i përbashkët nxit një veprimtari të organizuar dhe të drejtuar për ndryshim shoqëror, lindin lëvizjet shoqërore. Ato synojnë zgjidhjen e çështjeve që lidhen me ekologjinë, barazinë gjinore, paqen dhe antirasizmin, duke përdorur protesta, peticione dhe fushata publike. Lëvizjet shoqërore ekzistojnë derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë krijuar.




KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është sjellja kolektive?
2. Çfarë vetëdije dominon individin sipas Emil Dyrkemit?
3. Ç'është turma, ç'është publiku?
4. Si lindin lëvizjet shoqërore?
5. Cili është qëllimi kryesor i lëvizjeve shoqërore?
6. Kur pushon së ekzistuari një lëvizje shoqërore?
7. Cilat janë lëvizjet më të njohura shoqërore? Cilat janë qëllimet e tyre dhe si funksionojnë ato?

4. GLOBALIZIMI

„Globalizimi do të thotë se lokalja dhe globalja janë të lidhura në mënyra që ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve.“ – Entoni Gidens

Në jetën e përditshme shumë shpesh e hasim termin global në kontekste të ndryshme: bota është fshat global, ngrohja globale, problem global, kapital global, politikë globale, globalizim. Shtrohet pyetja: cili është kuptimi i këtij termi që mund të përdoret në kaq shumë fusha dhe situata të ndryshme?



Globalizimi i lidh njerëzit në mbarë botën

Fjala *globus* është fjalë latine dhe do të thotë top, sferë, tërësi. Në përkthim të drejtpërdrejtë, fjala **globalizim** nënkupton procesin e lidhjes dhe përfshirjes së botës si tërësi e vetme. Ç'do të thotë ky proces në realitet, në jetën tonë të përditshme?

Sot është shumë më lehtë të vizitosh një qytet në ndonjë vend evropian ose një shtet në një kontinent tjetër, sesa të arrish në një fshat të largët malor në Maqedoni, veçanërisht nëse nuk ke transportin tënd. Lidhjet me botën janë zhvilluar dhe janë bërë aq të arritshme,

saqë ajo që në të kaluarën paraqiste largësi, sot është vetëm një fluturim prej disa orësh. Vendet e largëta përtej oqeanëve dikur ishin objekt i ëndrrave dhe tregimeve, ndërsa sot mund të “vizitohen” virtualisht me vetëm një klikim në internet. Informacionet për trendet e modës, kënga e re e këngëtarit të preferuar, reklama e filmit më të ri, nata e ndarjes së çmimeve Oskar ose garat sportive të ekipeve më të njohura janë të disponueshme për ne në të njëjtin moment kur janë të disponueshme edhe për të gjithë botën. Ne jemi të pranishëm edhe atje ku nuk jemi fizikisht; nga larg ndjekim ngjarje që ndodhin mijëra kilometra larg nesh. Kjo lidhje dhe ndërvaresi gjithnjë e më e madhe e shteteve, shoqërive dhe njerëzve në nivel botëror quhet **globalizim**.

LLOJET E GLOBALIZIMIT

„Globalizimi nuk është vetëm fenomen ekonomik; ai gjithashtu lidh politikën, kulturën dhe marrëdhëniet shoqërore, duke krijuar një botë me rreziqe dhe mundësi të përbashkëta.” – Urluh Bek

Globalizimi zhvillohet përmes lidhjeve ekonomike, politike, kulturore dhe teknologjike, të cilat kontribuojnë në zvogëlimin e rëndësisë së kufijve midis shteteve. Edhe pse ato ende ekzistojnë praktikisht dhe ligjërisht dhe shënojnë territorin e një shteti të caktuar, nën ndikimin e globalizimit këto kufij bëhen “gjithnjë e më të padukshëm” në funksionimin e përditshëm të shoqërive. Ato nuk janë pengesë për bashkëpunim.

Besohet se globalizimi fillon në sektorin ekonomik.



Globalizimi ekonomik lidh tregtinë botërore

Globalizimi ekonomik përfshin lëvizjen më të lehtë të mallrave, shërbimeve, kapitalit, punës, tregtisë dhe pagesave. Shfaqja e kompanive shumëkombëshe (Apple, Coca-Cola, Nike, Zara) ka çuar në rritjen e bashkëpunimit midis vendeve, por edhe në ndërrimin më të madhe. Interesat ekonomike kanë krijuar një treg global (botëror) në të cilin secili vend mund të gjejë atë që dëshiron ose i nevojitet. Për shembull, mund të udhëtoni në disa vende me monedha të ndryshme kombëtare, të paguani me një kartë krediti dhe prapë të gjeni produkte nga kompani shumëkombëshe në të gjitha këto vende. Nëse keni porositur ndonjëherë diçka përmes Amazonit, atëherë jeni pjesë e procesit të globalizimit ekonomik.

Globalizimi kulturor shihet si mundësi për të qenë pjesë e një bote kulturore shumëngjyrëshe. Shumëllojshmëria e gjuhëve, zakoneve dhe llojeve të ndryshme të ushqimit e bën të mundur të kalosh përtej kufijve të tu dhe të përjetosh botën e të tjerëve dhe të vendeve të largëta. Megjithatë, globalizimi kulturor ngre çështjen se bota a bëhet kulturë e madhe shumëngjyrëshe apo kulturë e madhe që ndikon në të gjitha të tjerat. A i nënshtrohet bota perëndimizimit (ndikimet e kulturave perëndimore, pranimi i stileve të jetesës perëndimore si modele jetese)? Ndikimet kulturore nga vendet perëndimore i tejkalojnë lehtësisht kufijtë kombëtarë. Për shembull, nëse shkoni në restorant lokal, do të vini re se ka pjata nga vende të ndryshme në menu (taco, pica, doner, xhiro, sushi). Ka shumë gjasa të dëgjoni muzikë botërore në vend të muzikës lokale, ndërsa emri i restorantit shpesh do të ketë origjinë ose kuptim të huaj.

Globalizimi politik është ndoshta ndikimi më i rëndësishëm në jetën tonë, por ne jemi gjithashtu më pak të vetëdijshëm për të. Përmes globalizimit politik vendet bashkëpunojnë ndërkombëtarisht, krijojnë aleanca dhe marrin vendime të rëndësishme për çështje që ndikojnë botën përtej kufijve kombëtarë. Për shembull, ndryshimet në ligjet e të drejtave të autorit në nivelin e BE-së ndikojnë në muzikën që është e disponueshme në Spotify, YouTube ose Apple Music, madje edhe në Maqedoni. Ju mund të dëgjoni këngë të caktuara ose të abonoheni, sepse kompanitë përshtaten me trendet globale.



Media sociale është fuqishëm e pranishme në jetën e përditshme

Globalizimi social përfshin migrimin, udhëtimin, komunikimin përmes mediave sociale dhe të gjitha format e ndërveprimit që mundësojnë ndjenjë përkatësie në komunitet më të gjerë global. Ai demonstroi fuqinë e komunikimit dhe ndërveprimit në botën moderne, pasi individët dhe grupet mund të lidhen me njëri-tjetrin dhe të marrin pjesë në jetën globale pa prani fizike. Globalizimi social i referohet gjithashtu mënyrës se si mësojmë, shoqërohemi, krijojmë miq dhe formësojmë ndërgjegjësimin social. Për shembull, nëse komunikoni me shokët në TikTok dhe Instagram, ndiqni sfidat, trendet dhe shkëmbeni ide rreth muzikës, veshjeve ose lajmeve, ju jeni pjesë e globalizimit social.

MEDIAT DHE GLOBALIZIMI

Mediat luajnë një rol kyç në procesin e globalizimit. Ato mundësojnë shpërndarjen e shpejtë dhe të gjerë të informacionit, veçanërisht përmes internetit, mediave sociale dhe televizionit. Ato transmetojnë lajme të modës, gastronomisë dhe kulturës dhe i bëjnë ato reale dhe lehtësisht të arritshme. Për shembull, hapja e Lojërave Olimpikë mund të ndiqet nga miliona shikues në të gjithë botën në të njëjtën kohë. Përmes medias individët mund të marrin pjesë në fushata të ndryshme, të shprehin mendimet e tyre mbi çështjet sociale dhe të përfshihen në veprime humanitare online dhe nisma të ngjashme. Përmes reklamave promovojnë produkte që janë subjekt blerjeje dhe shitjeje dhe mundësojnë blerjet nga shtëpia.

Media përshpejton dhe thëllon globalizimin sepse lidh njerëzit, kulturat dhe idetë, duke e bërë botën të funksionojë si komunitet i madh. Për shembull, sa herë që hapni telefonin tuaj inteligjent dhe aktivizoni një platformë të mediave sociale, bëheni pjesë e globalizimit. Media lidh bashkëmoshatarët në të gjithë botën, duke krijuar ndjenjën e të jetuarit në të njëjtën hapësirë (globale).

PASOJAT E GLOBALIZIMIT – ARGUMENTE PRO APO KUNDËR GLOBALIZIMIT

„Bota bëhet një vend i vetëm, por jo një vend i barabartë.”

– David Harvej

Mendimet e sociologëve mbi globalizimin janë të ndara. Disa e shohin atë si proces pozitiv, ndërsa të tjerë besojnë se shkakton pasojë më negative. Të parët (globalistët) besojnë se globalizimi rrit lidhjet midis njerëzve, përshpejton rrjedhën e informacionit dhe stimulon zhvillimin teknologjik. Në të kundërt nga ata, ai mundëson një shkëmbim më të lehtë idesh, mallrash dhe shërbimesh, ndërsa kontribuon në përparimin e shoqërisë. Të dytët (antiglobalistët) theksojnë gjithashtu anët e tij negative në nivel të brendshëm. Ata paralajmërojnë se globalizimi krijon pabarazi ekonomike, dobësimin e kulturave lokale, rritjen e fuqisë së kompanive shumëkombëshe dhe ndikim të dëmshëm në mjedis. Në të kundërt nga ata, përfitimet e globalizimit nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe krijojnë më shumë probleme sesa zgjidhje. Ata besojnë se globalizimi përbën një kërcënim për shtetet kombëtare, veçanërisht ato më të vogla. Vendet



Rrobaqepëset punojnë për tregtinë botërore

e mëdha dhe të zhvilluara ekonomikisht përdorin punën e lirë dhe burimet natyrore të vendeve të pazhvilluara dhe të varfra, ndërsa kompanitë shumëkombëshe krijojnë fitime që konsiderohen formë shfrytëzimi.

Anti-globalistët gjithashtu theksojnë se ndikimi i fortë i kulturës globale në kulturat lokale mund të çojë në shtypjen graduale dhe humbjen e identitetit kulturor dhe kombëtar. Përveç kësaj, procese të tilla zvogëlojnë rëndësinë e traditave, gjuhës dhe zakoneve lokale, të cilat përbëjnë kërcënim serioz për diversitetin kulturor në botë.

Globalizimi i lidh shtetet dhe krijon tregti dhe udhëtime më të lehta sepse kufijtë janë „më të hapur“, ndërsa transporti i njerëzve është shumë më i shpejtë dhe më i shpeshtë. Ky është përfitim i madh, por gjithashtu mbart rreziqe. Kur mallrat dhe njerëzit lëvizin më lehtë nga një vend në tjetrin, mund të jetë më e lehtë të transportohen mallra të paligjshme (drogë ose armë). Kjo gjithashtu lejon që grupet kriminale dhe organizatat terroriste të veprojnë në më shumë vende. Prandaj nevojiten masa të mira të bashkëpunimit ndërkombëtar për të ruajtur sigurinë globale.

Një nga temat mbi të cilat anti-globalizatorët e kritikojnë më ashpër procesin e globalizimit janë **sfidat dhe pasojat ekologjike**. Ndërlidhja e botës dhe funksionimi i tregut global, të cilat konsiderohen përfitime të globalizimit, për anti-globalizatorët shkaktojnë pasojë negative. Trafiku dhe transporti i dendur dhe intensiv i mallrave dhe lëndëve të para për tregun global rrisin emetimet e gazrave të dëmshëm në

atmosferë, gjë që kontribuon drejtpërdrejt në ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike.

Përveç kësaj, antiglobalistët theksojnë se kompanitë shumëkombëshe shpesh i shfrytëzojnë tepër burimet natyrore, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara, me qëllim uljen e kostove dhe gjenerimin e fitimeve më të mëdha. Në kushte të tilla standardet mjedisore shpesh injorohen, gjë që çon në ndotje të tokës, ujit dhe ajrit, si dhe në shkatërrimin e sistemeve ekologjike dhe humbjen e biodiversitetit.

Problem shtesë mjedisor është përdorimi masiv i ambalazhit në paketimin dhe transportin e produkteve. Për mbrojtjen e mallrave, por edhe për arsye marketingu, paketimi shpesh është i dyfishtë ose më shumë shtresa të panevojshme, gjë që krijon një sasi të madhe mbeturinash. Këto mbeturina janë të vështira për t'u ricikluar dhe i vënë barrë shtesë mjedisit.

Sipas antiglobalistëve, të gjitha këto fenomene tregojnë se globalizimi, nëse nuk ndiqet me rregulla të rrepta mjedisore dhe sjellje të përgjegjshme, mund të rrezikojë seriozisht mjedisin dhe cilësinë e jetës së brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.



Globalizimi ndikon në rritjen e temperaturave

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Mendoni dhe jepni nga një shembull për secilin lloj globalizimi! Merrni në konsideratë cilësitë e këtij procesi dhe cilin lloj hasni më shpesh!

AKTIVITETI 2. Mësoni me kujdes dhe hulumtoni më tej anët pozitive dhe negative të globalizimit! Diskutoni qëndrimin që do të mbani me rrethin tuaj të ngushtë (familje, miq, shokë klase, mësimdhënë). Krahasoni qëndrimin tuaj me të tyre!

AKTIVITETI 3. Analizoni rrugën e një produkti të porositur nga një dyqan global online. Sa kohë duhet që ai të arrijë te ju dhe nëse ky lloj blerjeje është i shëndoshë nga ana mjedisore?

AKTIVITETI 4. Analizoni zakonet mjedisore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe krahasojini ato me zakonet mjedisore të qytetarëve të Republikës së Sllovenisë! Si kujdesen qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të tjerët për mjedisin në vendin e tyre? Si i ndjek Maqedonia politikatat globale mjedisore?



MBANI MEND

Globalizimi është proces i lidhjes së botës në tërësi të vetme, në të cilin vendet, shoqëritë dhe njerëzit bëhen gjithnjë e më të ndërruar. Ai zhvillohet përmes lidhjeve ekonomike, kulturore, politike dhe sociale, ndërsa media dhe teknologjia luajnë një rol kyç në përhapjen dhe përshpejtimin e tij. Falë globalizimit, informacioni, mallrat, kapitali dhe idetë lëvizin shpejt dhe lehtë përtej kufijve.

Opinionet mbi globalizimin janë të ndara: globalistët e shohin atë si mundësi për përparim, zhvillim dhe lidhshmëri më të madhe, ndërsa antiglobalistët paralajmërojnë për pabarazi ekonomike, dominim kulturor, fuqi më të madhe të kompanive shumëkombëshe dhe pasoja serioze mjedisore. Kështu, globalizimi e bën botën më të bashkuar, por jo më të barabartë.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Nga vjen fjala globalizim dhe ç'do të thotë?
2. Ç'është procesi i globalizimit?
3. Ç'është karakteristikë e globalizimit ekonomik, politik, kulturor dhe social?
4. Cili është roli i medias në procesin e globalizimit?
5. Cilët njerëz dhe grupe janë globalistë dhe ç'përfaqësojnë ata?
6. Cilët njerëz dhe grupe janë antiglobalistë dhe ç'përfaqësojnë ata?
7. Çfarë sfidash mjedisore lindin si rezultat i globalizimit?

5. MIGRIMET GLOBALE

„Migrimi nuk është problem që duhet zgjidhur, por realitet që duhet menaxhuar.” – Stefan Kastles

Lidhjet midis shteteve të ndërvapura nuk ndodhin vetëm përmes internetit, medias, blerjeve online ose udhëtimeve turistike. Përkundrazi, ato perceptohen përmes pranisë fizike të njerëzve në hapësira të ndryshme të botës. Lëvizja mekanike (fizike) dhe vendosja e njerëzve nga një vend në tjetrin quhet **migrim**.

Migrimi është i lidhur ngushtë me procesin e globalizimit. Ekonomia globale krijon kërkesë për punë, mundësi arsimore dhe tregje të reja që i inkurajojnë njerëzit të lëvizin përtej kufijve. Në të njëjtën kohë teknologjitë moderne të transportit dhe komunikimit e bëjnë më të lehtë lëvizjen dhe mbajtjen e lidhjeve me atdheun. Kështu, migrimi bëhet një nga treguesit më të dukshëm të ndërlidhjes globale midis shteteve dhe shoqërive.



Migrantë

Migrimi mund të jetë i përkohshëm, pra për një periudhë të caktuar kohore, siç është studimi ose puna sezonale në qytet ose shtet tjetër. Mund të jetë gjithashtu i përhershëm – kur një individ ose familje lëviz me qëllimin për të jetuar përgjithmonë në mjedisin e ri. Migrimi mund të ndodhë brenda kornizës së një shteti të vetëm – migrimi i brendshëm (për shembull, zhvendosja nga një fshat në qytet) ose në shtet tjetër, i cili quhet migrim i jashtëm ose ndërkombëtar (për shembull, zhvendosja jashtë shtetit).

Arsyet e migrimit janë të ndryshme. Më shpesh ato janë të natyrës ekonomike, përkatësisht kërkimi i punës dhe standardit më të mirë jetese. Migrimi mund të motivohet gjithashtu nga dëshira për arsim më të mirë, kushte më të mira jetese, kujdes shëndetësor më të mirë ose mjedis më të shëndetshëm jetese. Në raste të caktuara njerëzit migrojnë për shkak të luftërave, paqëndrueshmërisë politike ose formave të tjera të pasigurisë në shtetin e tyre të lindjes.

Një nga migrimet më masive dhe të shpeshta, veçanërisht gjatë revolucionit industrial, është migrimi i njerëzve nga fshatrat në qytete, ose nga vendbanimet rurale në ato urbane. Ky proces quhet procesi i urbanizimit. **Qytetet** janë ndërtuar me një numër më të madh banorësh, dendësi të lartë popullsie dhe infrastrukturë të zhvilluar, të cilat përfaqësojnë qendër ekonomike, administrative, kulturore dhe sociale për mjedisin më të gjerë.

Këto qytete të mëdha në fakt formohen nga bashkimi i disa qyteteve dhe metropoleve në **megalopol** (nga greqishtja: *mega* – i madh, *polis* – qytet), qytet me qendra administrative, kapacitete industriale, aktivitete shërbimesh, infrastrukturë moderne, qendra arsimore dhe shëndetësore, parqe argëtimi, etj. Megalopolet janë epiqendra e migrimit dhe jo vetëm që lëvizin njerëz nëpër hapësirë, por ato shkaktojnë edhe ndryshime në strukturën dhe mënyrën e jetesës në të gjithë shoqërinë.



Tokio, Japoni

NEOKOLONIALIZMI DHE NEOLIBERALIZMI

“Ajo që quhet ‘treg i lirë’ shpesh është liri për të fuqishmit dhe kufizim për të dobët.” – Noam Çomski

Vendosja e pushtetit politik formal nga shtete më të zhvilluara mbi shtete më pak të zhvilluara quhet **kolonializëm**. Kolonizimi nënkupton dominimin politik (sundimin mbi popullsinë lokale), ekonomik (shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe punës), kulturor (imponimin e gjuhës, fesë, sistemit arsimor) dhe territorial (vendosjen e sundimit mbi një vend të huaj). Kolonizatorët më të mëdhenj ishin Portugalia, Spanja, Britania, Franca dhe Rusia. Ata themeluan kolonitë e tyre në Amerikë, Afrikë dhe Azi nga shekulli XV deri në shekullin XX.

Nëse fjalës kolonializëm i shtohet parashtesa neo- (i ri), fitohet termi **neokolonializëm**. Ai paraqet proces të varësisë bashkëkohore, në të cilin shtetet, ndonëse formalisht dhe juridikisht të pavarura, bien nën ndikimin e fortë ekonomik, politik ose kulturor të shteteve më të zhvilluara dhe më të fuqishme.

Varësia ekonomike krijohet përmes kredive, marrëveshjeve tregtare që i përshtaten palës më të fuqishme, si edhe investimeve, përmes të cilave shfrytëzohen fuqia punëtore dhe burimet natyrore për të realizuar fitime të konsiderueshme.

Ndikimi politik shfaqet përmes ndërhyrjes së shtetit më të fuqishëm në vendimet e politikës së brendshme të shtetit më të dobët, si edhe përmes formave të ndryshme të kushtëzimit politik.

Ndikimi kulturor është një nga format më të dukshme dhe vërehet përmes përvetësimit të ushqimit, zakoneve, vlerave, gjuhës dhe mënyrës së jetesës së huaj në tërësi.

Globalizimi krijon kushte në të cilat neokolonializmi zhvillohet më lehtë dhe më intensivisht. Me ndryshimet që sjell, veçanërisht në sferën ekonomike, hapet hapësirë për ndikim më të madh të shteteve më të fuqishme mbi ato më të dobëta. Pikërisht në rrethana të tilla shfaqen dhe forcohen marrëdhëniet neokoloniale.

Liberalizmi është ideologji politike dhe ekonomike, në qendër të së cilës janë liria dhe barazia e qytetarëve, si edhe tregu i lirë, me ndërhyrje minimale nga ana e shtetit. Liberalizmi kundërshton të gjitha format jodemokratike të pushtetit (absolutiste, monarkiste, militariste etj.). **Neoliberalizmi**, nga ana tjetër, është formë e re e liberalizmit dhe mbështetet në parimet e liberalizmit klasik. Ai quhet “liberalizëm i ri” sepse mbron zvogëlimin ose heqjen e të drejtave sociale të të punësuarve. Këto të drejta liberalizmi klasik i pranoi nën presionin e lëvizjeve punëtore dhe lëvizjeve të tjera shoqërore. Neoliberalizmi mbështet tregun e lirë, rolin minimal të shtetit në ekonomi, si edhe privatizimin e shërbimeve dhe të ndërmarrjeve publike. Neoliberalizmi dhe globalizimi janë të lidhura ngushtë, sepse politikat ekonomike neoliberales krijojnë kushte për lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe fuqisë punëtore në nivel global. Nga ana tjetër, globalizimi i përhap këto parime në mbarë botën, duke mundësuar investime ndërkombëtare, marrëveshje tregtare dhe tregje globale.

Me fjalë të tjera, neoliberalizmi është shtytësi ideologjik dhe ekonomik i globalizimit ekonomik. Privatizimi, derregullimi dhe zvogëlimi i kontrollit shtetëror e lehtësojnë biznesin transnacional dhe e rrisin ndërlidhjen ndërmjet vendeve. Në këtë mënyrë globalizimi jo vetëm që e zgjeron lirinë ekonomike të tregjeve, por edhe e forcon ndikimin e ekonomive më të fuqishme mbi vendet më pak të zhvilluara.

Karakteristika	Neoliberalizmi	Neokolonializmi
Dimensionimi ekonomik	Tregu i lirë, privatizimi, derregullimi	Varësia e shteteve më të dobëta përmes kredive, marrëveshjeve tregtare dhe kompanive shumëkombëshe.
Dimensionimi politik	Roli i zvogëluar i shtetit në ekonomi	Ndikimi i shteteve më të fuqishme mbi vendimet dhe politikat e shteteve më të dobëta.
Dimensionimi social/kulturor	Rritja e pabarazive shoqërore, mbrojtja e reduktuar sociale	Shtypja e identitetit lokal, përhapja e vlerave kulturore dhe e zakoneve nga shtetet më të fuqishme.
Dimensionimi/pasojat globale	Lëvizja e lirë e kapitalit dhe e bizneseve transnacionale, ndikimi i rritur i korporatave të mëdha	Ruajtja e varësisë strukturore, dominimi ekonomik dhe politik i shteteve të zhvilluara.

Neoliberalizmi dhe neokolonializmi kanë pasoja të rëndësishme globale për botën moderne. Neoliberalizmi forcon lidhjet ekonomike midis shteteve përmes tregut të lirë, privatizimit dhe lëvizjes së lirë të kapitalit, por në të njëjtën kohë kontribuon në rritjen e pabarazive sociale dhe ekonomike. Për shkak të ndërvlerësimit të fortë, krizat ekonomike transmetohen lehtësisht nga një vend në tjetrin.

Nga ana tjetër neokolonializmi krijon dhe mirëmban varësinë e shteteve më të dobëta nga ato më të fuqishme përmes ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor. Kjo çon në shfrytëzimin e burimeve, autonomi të kufizuar në vendimmarrje dhe shtypjen e identitetit lokal. Në nivel global të dy proceset kontribuojnë në thellimin e dallimeve midis vendeve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara. Në nivel global të dy proceset kontribuojnë në thellimin e dallimeve midis vendeve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Imagjinoni veten si person që emigron nga një shtet në tjetrin. Shkruani një tekst të shkurtër (10–15 fjali) në të cilin t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme: Pse emigroni? Për çfarë arsyesh (ekonomike, politike, arsimore)? Cilat janë pritjet tuaja nga vendi i ri në të cilin zhvendoseni? Cilat mendoni se janë sfidat me të cilat do të përballeni? Si do të ndikojë vendimi juaj për t'u larguar te njerëzit e juaj të afërt (familja, miqtë)?

AKTIVITETI 2. Analizoni një vend që mendoni se mund të jetë „viktimë“ e neokolonializmit!



MBANI MEND

Migrimi ka pasoja të rëndësishme sepse ndryshon mënyrën e jetesës dhe çon në urbanizim dhe krijimin e megalopoleve. Kolonializmi historikisht ka formësuar çekuilibrat ekonomike dhe politike globale, ndërsa kolonializmi përjetëson varësinë e shteteve më të dobëta nga ato më të fuqishme përmes ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor. Liberalizmi si ideologji mbështet tregjet e lira dhe liritë individuale, ndërsa neoliberalizmi forcon ndërlidhjen ekonomike globale, por në të njëjtën kohë shpesh thëllon pabarazinë. Së bashku këto procese rrisin hendekun midis vendeve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara. Ato sjellin përfitime, por edhe sfida serioze për strukturën sociale, ekonomike dhe kulturore të botës.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Ç'është emigrimi?
2. Cilat janë arsytet më të zakonshme të emigrimit?
3. Cila është lidhja ndërmjet emigrimit dhe globalizimit?
4. Ç'është qyteti, ndërsa ç'është megalopolisi?
5. Ç'është kolonializmi, ndërsa ç'është neokolonializmi?
6. Ç'është liberalizmi, ndërsa ç'është neoliberalizmi?
7. Cilat janë pasojat globale të neokolonializmit dhe neoliberalizmit?

6. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

„Problemet globale kërkojnë zgjidhje globale.” – Urlih Bek

Me globalizimin e botës ndërvarësia e ngushtë e vendeve imponon nevojën për zgjidhje të përbashkëta për sfidat globale. Veprimi i izoluar i vendeve individuale rezulton të jetë jo mjaftueshëm efektiv. Për shembull, problemi i ngrohjes globale nuk mund të zgjidhet në nivel kombëtar. Nëse vetëm një vend nga një rajon i tërë i afrohet zgjidhjes, ndërsa të tjerët nuk bëjnë asgjë, sfida nuk mund të zgjidhet.

Për shkak të nevojës që vendet të bashkëpunojnë dhe të zgjidhin bashkërisht problemet me interes global, kanë dalë organizata ndërkombëtare.

Një nga organizatat më të njohura ndërkombëtare është **Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)**, e cila u shfaq pas Luftës së Dytë Botërore. E formuar në vitin 1945, qëllimi i saj është të ruajë paqen dhe të parandalojë luftërat. OKB-ja e arrin qëllimin e saj përmes misioneve paqeruajtëse, ndihmës humanitare, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe programeve për të adresuar ndryshimet klimatike. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e OKB-së që nga viti 1993.

Banka Botërore u formua në vitin 1944 (pas Luftës së Dytë Botërore) me qëllimin për të ndihmuar vendet në periudhën e pasluftës. E bën këtë duke ofruar kredi dhe duke krijuar fonde. Mbështet projekte për zhvillimin e infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë e të ngjashme. Është e përkushtuar për uljen e varfërisë në botë. Një aspekt negativ i organizatës është se projektet e saj shpesh krijojnë varësi ekonomike nga vendet që përdorin shërbimet e saj. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare që nga viti 1993.

UNICEF është organizatë ndërkombëtare që ekziston për më shumë se 70 vjet. Qëllimi i saj kryesor është mbrojtja e fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Fushat kryesore të aktivitetit përfshijnë sigurimin e ushqimit të shëndetshëm, luftimin e urisë, arsimin, mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale. UNICEF ka zyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nga viti 1993.



Selia e OKB-së në Nju Jork



Fëmijë të ndihmuar nga UNICEF-i



Ohri



Martinka

NATO është organizatë ndërkombëtare e formuar në vitin 1949 si organizatë e vendeve anëtare për mbrojtje kolektive në rast lufte. Organizata vepron mbi tri shtylla: 1. mbrojtja kolektive (mbrojtja e territorit të secilit vend anëtar); 2. menaxhimi i krizave (misione paqeruajtëse që përfshijnë vende jo-anëtare të NATO-s); 3. siguria bashkëpunuese (shoqërimi dhe bashkëpunimi me organizata të tjera). Maqedonia është anëtare e NATO-s që nga viti 2020, si vendi i 30-të anëtar.

UNESCO është agjenci brenda OKB-së, e themeluar në vitin 1945. Ideja pas formimit të saj ishte forcimi i paqes botërore përmes bashkëpunimit në fushat e kulturës, arsimit, shkencës dhe komunikimit. Kultura është një nga fushat më të njohura të aktivitetit të UNESCO-s. Organizata mirëmban Listën e Trashëgimisë Botërore, qëllimi i së cilës është të mbrojë pronat kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme. Në fushën e arsimit UNESCO është e përkushtuar për arsim gjithëpërfshirës, argëtues, të drejtë dhe cilësor për të gjithë. Në fushën e shkencës ajo ofron mbështetje për bashkëpunimin shkencor ndërkombëtar dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Sektori i komunikimit përqendrohet në promovimin e hershëm të

pavarësisë së medias dhe lirisë së qasjes në informacion. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nën mbrojtjen e UNESCO-s, është rajoni i Ohrit, i cili ka status të dyfishtë – si trashëgimi natyrore dhe si trashëgimi kulturore.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) është organizatë ekonomike e themeluar në vitin 1944. Objektivat kryesore të FMN-së janë stabiliteti i kurseve të këmbimit të vendeve anëtare, mundësia e përdorimit të kredive, ofrimi i ndihmës këshillimore, promovimi i politikave për rritje ekonomike dhe luftimi i varfërisë. Çdo vend anëtar paguan një shumë të caktuar, e cila varet nga madhësia e ekonomisë së saj. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e FMN-së që nga viti 1992 dhe ka përdorur shërbimet e saj disa herë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), gjithashtu agjenci e OKB-së, u themelua në vitin 1948. Aktivitetet e saj në fushën e shëndetësisë dhe detyrat e saj kryesore janë: luftimi i sëmundjeve (infektive dhe jo-infektive), vaksinimi, promovimi i stileve të jetesës së shëndetshme, edukimi, zhvillimi i protokolleve dhe rekomandimeve për sigurinë dhe ofrimi i ndihmës teknike dhe ekspertize për vendet anëtare. Maqedonia është anëtare e OBSH-së që nga viti 1993, duke u bërë kështu pjesë e sistemit global shëndetësor të OKB-së.

Anëtarësimi i Maqedonisë në këto organizata ndërkombëtare i mundëson vendit të jetë pjesë e strukturave globale dhe, si shtet, të ketë qasje dhe të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve globale. Përfitimet janë: siguri më e madhe, stabilitet ekonomik, bashkëpunim ndërkombëtar, mbrojtje e trashëgimisë kulturore, mbrojtje e fëmijëve, etj.

Aktivitet i propozuar (punohet individualisht ose në grup)

AKTIVITETI 1. Gjeni simbolet e të gjitha organizatave të përmendura! Analizoni kuptimin e tyre dhe qëllimet që kanë!

AKTIVITETI 2. Hulumtoni kuptimin e martinkave. Me cilat zakone dhe tradita lidhen ato? Në cilën periudhë të vitit zhvillohet ky zakon? Në cilat vende është karakteristik si traditë? Hulumtoni këndimin vokal, për cilën pjesë të Maqedonisë është specifik? Pse është nën mbrojtjen e UNESCO-s?

AKTIVITETI 3. Hulumtoni me kujdes pjesët materiale dhe jomateriale të kulturës së cilës i përkisni dhe mendoni se cilat prej tyre do të duhej të përfshiheshin në listën e pasurive kulturore nën mbrojtjen e UNESCO-s!



MBANI MEND

Me globalizimin është shfaqur nevoja për zgjidhje të përbashkëta edhe të problemeve globale, sepse veprimi i izoluar nuk është mjaftueshëm efikas. Për këtë arsye janë krijuar organizata ndërkombëtare si OKB-ja, Banka Botërore, UNICEF-i, NATO-ja, UNESCO-ja, FMN-ja dhe OBSH-ja, të cilat veprojnë në fushat: e paqes dhe sigurisë, zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së fëmijëve, kulturës, shëndetësisë dhe stabilitetit financiar. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e këtyre organizatave dhe përmes tyre merr pjesë në zgjidhjen e problemeve globale. Anëtarësimi i sjell vendit përfitime si siguri më të madhe, mbështetje ekonomike, bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbrojtje të pasurisë kulturore dhe shoqërore.



KONTROLLONI DHE PËRDORNI NJOHURITË E FITUARA

1. Pse u formuan organizatat ndërkombëtare?
2. Çfarë sfidash zgjidhin organizatat ndërkombëtare?
3. Numëroni organizatat më të njohura ndërkombëtare dhe tregoni karakteristikat e tyre!
4. Cilat janë përfitimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare?

LITERATURA E PËRDORUR

1. BARLE Amndreja [et. al.], 1997, Sociologjia– gradivo za srednje škole.
2. Bošniak Zvonimir, Zlata Pashar i Anton Vukelić, 2020, Sociologjia – udbenik za sredne škole, Zagreb: Klett.
3. GIDDENS Anthony dhe Philip Sutton, 2022 Sociologji, Polity.
4. LABEL Jean-Paul et Adeline RICHET rédacteurs, Sciences économiques s & Socials, Paris: Hachette.
5. MARSHAL Gordon, 2004, Fjalori i Oksfordit i Sociologjisë, Shkup: MI-AN.
6. TRAJKOVA Gordana dhe MIRCHEV Dimitar, 2020, Sociologjia për II të arsimit të mesëm (Botim i shtuar), Shkup: Makedonska iskra.
7. TRAJKOVSKI Ilo, 2019, Sociologjia Politike1/2 Shkup: Fakulteti i Filozofisë.
8. TRAJKOVSKI, Ilo, 2000, Sociologjia – si është dhe si praktikohet, Shkup: Matica.
9. TRAJKOVSKI, I. KRSTEVSKI, T. PETRUSHEVSKI Zoran, 2009, Sociologjia, Shkup: Gotsmar.
10. Anthony Giddens; Philip W. Sutton, 2017, Sociologji. Kembrixh: Polity Press.
11. Anthony Giddens. Modernity and Self-Identity. Stanford: Stanford University Press.
12. John J. Macionis. Sociology. Boston: Pearson Education, 2019.
13. George Ritzer. Introduction to Sociology. Thousand Oaks: SAGE Publications, 2015.
14. John J. Macionis; Ken Plummer. Sociology: A Global Introduction. Harlow: Pearson Education, 2012.
15. Émile Durkheim, The Division of Labor in Society. New York: Free Press.
16. George Ritze, The McDonaldization of Society. Thousand Oaks: SAGE Publications.
17. Marija Tasheva, 2003, Sociologjia, Shkup: Fakulteti i Filozofisë.
18. Antoanela Petkovska, 2009, Ese mbi Sociologjinë e Kulturës, Shkup: Az-Buki.
19. Çarls Rajt Mils, 2019, Imagjinata sociologjike, Shoqata e sociologëve, Shkup: Studentski servis.
20. Çarls Rajt Mils, 2020, Elita e fuqisë, Shoqata e sociologëve, Shkup: Studentski servis.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316(075.3)=163.3

TRAJKOVSKI, Ilo

Sociologjia : tekst shkollor për vitin e dytë të arsimit gjimnazor / Ilo Trajkovski, Nadica Tanevska Janeva ; [përkthyer nga maqedonishtja, Solidar Sulejmani]. - Shkup : Eduka mak, 2026. - 224 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Социологија : учебник за втора година гимназиско образование. - Библиографија: стр. 222

ISBN 978-608-4951-86-5

1. Tanevska Janeva, Nadica [автор]

COBISS.MK-ID 69379589

© Copyright, EDUKA MAK SH.P.K. – Shkup 2026

Ndalohet rreptësisht shumëzimi i plotë ose i pjesshëm i këtij libri, si dhe vendosja e tij në rrjete informatike, transmetimi në çfarëdo forme dhe nëpërmjet çfarëdo mjeti elektronik ose mekanik, përmes fotokopjimit, regjistrimit ose metodave të tjera, pa lejen me shkrim të mbajtësve të të drejtave.

УЧЕБНИК ЗА ВТОРА ГОДИНА ГИМНАЗИСКО ОБРАЗОВАНИЕ

СОЦИОЛОГИЈА

Учебникот по социологија е наменет за учениците од втора година гимназиско образование и е изработен според наставната програма на Министерството за образование и наука на Република Северна Македонија.

Содржините во учебникот ги обработуваат основните социолошки поими и процеси: општеството и културата, социјализацијата, општествените групи и институции, како и современите општествени промени. Преку објаснувања, примери, прашања и активности учениците се поттикнуваат да го разберат функционирањето на општеството и да развиваат критичко размислување.

Учебникот има цел да им помогне на учениците подобро да ги разберат односите меѓу поединецот и општеството и да ја согледаат улогата на социологијата во современиот свет.

